

DHPGJS-PJ

PËRMBLEDHJE E JURISPRUDENCËS

së

DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME
AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

e publikuar nga

ANËTARËT E KOLEGJIT TË APELIT

Kryeredaktor: Ondrej Pridal

Redaktimi në shqip dhe serbisht: Agnesa Vezgishi

Konceptualizimi dhe redaktimi në anglisht: Timo Knäbe

Vëllimi I



Vëllimi I

2016

2016

PËRMBLEDHJE E JURISPRUDENCËS

së

DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHITJET NË LIDHJE ME AGJENCINË
KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

e publikuar nga

ANËTARËT E KOLEGJIT TË APELIT

Kryeredaktor: Ondrej Pridal

Redaktimi në shqip dhe serbisht: Agnesa Vezgishi

Konceptualizimi dhe redaktimi në anglisht: Timo Knäbe

Vëllimi I

2016

Përmbajtja është e redaktuar nga ekipi redaktues:

Ondrej Pridal, Agnesa Vezgishi, Timo Knäbe

Të gjitha të drejtat e rezervuara

CITIMI

DHPGJS-PJ I, A[numri i Aktvendimit/Aktgjykimit të kësaj Përmbledhje], p.sh. Citimi i Aktvendimit të tretë të kësaj Përmbledhje, Aktvendimi i datës 14 maj 2013 – AC-II.-12-0075, është: ***DHPGJS-PJ I, A3***

PARATHËNIE

Në Republikën e Kosovës është në rrjedhë e sipër një proces i rëndësishëm shoqëror, procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe asetëve të tyre të evidentuara si pronë shoqërore. Ky proces siç dihet filloi në vitin 2002 me ish AKM-në dhe vazhdoi nga viti 2008 me AKP-në.

Nga procesi i deritanishëm i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, rrodhën disa mijëra konteste gjyqësore, me të cilat është marrë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme). Ky mekanizëm i veçantë gjyqësor i sistemit gjyqësor të Kosovës u mandatua me ligj të merret me këto konteste dhe ta mbikëqyrë ligjshmërinë e këtij procesi.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme u bë operacionale dhe filloi punën në Qershor të vitit 2003. Nga atëherë e deri me 31 mars 2016, përafërsisht 13 vite, ky institucion pranoi 42593 lëndë dhe ka zgjidhur 20644 lëndë. Aktualisht në Dhomën e Posaçme janë pritje 21949 lëndë, dhe këto shifra flasin se procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe i asetëve të tyre po prodhon konteste të shumta në mes palëve të kyçura në këtë proces.

Kolegjet gjyqësore të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke i zgjidhur rastet e cekura, kanë krijuar një jurisprudencë të begatshme në praktikën gjyqësore, duke përcaktuar linjat ligjore për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme të paraqitura ligjore.

Andaj në funksion të krijimit të një Buletini të praktikës gjyqësore, anëtarët e Kolegji i Apelit kanë përzgjedhur vendime të caktuara gjyqësore, për çështje të caktuara ligjore nga praktika e deritanishme gjyqësore.

Kolegji i Apelit vlerëson se kjo përmbledhje e këtyre vendimeve gjyqësore, do të jetë e dobishme dhe mund të forcon koherencën dhe stabilitetin e mendimit ligjor për zgjidhjen e çështjeve të caktuara që paraqitën në të ardhmen gjatë ndërtimit të praktikës gjyqësore.

Pikëpamjet ligjore të cilat i ofrojnë vendimet e përmbledhura në këtë Buletin të praktikës gjyqësore me gjasë do të mund të ju hynë në punë akterëve të ndryshëm që në forma dhe në cilësi të ndryshme, merren me lëndët e përfshira në jurisdiksionin e Dhomës së Posaçme.

Andaj nga këto arsye ky Buletin do të mund të jetë i dobishëm për gjyqtar, avokatë, avokat praktikant, juristë dhe profesionistët e tjerë ligjor të kësaj fushe të veçantë civile.

Kolegji i Apelit vëren se kjo është përpjekja e parë e këtij lloji për të bërë një Buletin të tillë nga kjo fushë, dhe që ka nevojë të vazhdohet puna me publikime të reja.

Besohet se kjo vepër modeste e anëtarëve të Kolegjit të Apelit të jetë e dobishme dhe ti ndihmoj në punë, gjithë audiencës profesionale që merret me këtë fushë ligjore.

Me respekt,

Mr.sc. Sahit Sylejmani

Kryetar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

LIDHUR ME PËRMBLEDHJEN DHE ATË SE SI KEMI PUNUAR

Qëllimi i kësaj Përmbledhjeje është që t`i përçojmë njohuritë e jurisprudencës së Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si instanca më e lartë gjyqësore për këtë çështje-lëndë të specializuar, për të stabilizuar edhe më tutje vazhdimësinë dhe koherencën e vendimeve të saj. Ne kemi përzgjedhur dhe përmbledhur “lëndët kryesore”, e që janë lëndët të cilat janë tejet të përsëritura në Gjykatën tonë dhe lëndët e rëndësisë së lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore. Lëndët janë përzgjedhur për të treguar se si do t`i gjykojë Kolegji i Ankesave lëndët e ngjashme.

Lëndët janë përmbledhur me anë një procedurë formale nga ana e Kolegjit të Apelit. Me qëllim të reflektimit të stabilitet dhe koherencës, ne kemi mundësuar që të përfshijmë vetëm vendimet të cilat nuk janë parë të jenë të kundërshtueshme nga anëtarët e Kolegjit të Apelit. Ne kemi frymëzuar nga procedurat e ngjashme e që janë të zakonshme në nivel të gjykatës supreme në të gjitha vendet pavarësisht sistemeve të tyre ligjore. Gjatë shtjellimit të projektit, ne kemi vazhduar të nxisim edhe më tej bashkëpunimin ekzistues të frytshëm në mes gjyqtarëve të Kosovës dhe të EULEX-it.

Ne besojmë se nëpërmjet këtij projekti, një audience më të gjerë, do t`i ofrohet të ketë një pasqyrë për jurisprudencën e Gjykatës Supreme, duke mundësuar një parashikueshmëri më të madhe të vendimeve dhe përfundim më të shpejtë të lëndëve në të mirë të të gjitha palëve të Gjykatës sonë: të popullit të Kosovës, të cilët do të vëhen në dijeni për rezultatet e pritshme të padive të tyre, si dhe gjyqtarëve, juristëve dhe studiuesve ligjor, të cilët do të mund të shfrytëzojnë këtë Përmbledhje si një udhëzues për punën e tyre.

Në fund, ky projekt do t`i dorëzohet gjyqtarëve Kosovarë, të cilët do të vazhdojnë me projektin dhe të ofrojnë “vëllime” të tjera, meqë jurisprudenca e Gjykatës do të zhvillohet edhe më tutje.

Dr. Ondrej Pridal, Ph.D.

Gjyqtar i EULEX-it, Kolegji i Apelit

Menaxher i Projektit

SHKURTESAT

Agjencia	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KBI	Kombinati Bujqësor Industrial
KEDHJ P[...]	Protokoli Shtesë i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
LDHP	Ligji nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit
Ligji për AKP-në2008	Ligji nr.03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit
Ligji për AKP-në2011	Ligji nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit
LGJ	Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat
Ligji për NP	Ligji nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
LMTHPJ	Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësoro Juridike
LN	Ligji mbi Ndërmarrjet
LPK	Ligji nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore
Neni	Neni
NP	Ndërmarrje Publike
nr.	Numër
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
Rreg.	Rregullorja
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

SHA	Shoqëri Aksionare
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
Shtojca e LDHP	Shtojca e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit
UA	Urdhëresa Administrative
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

INDEKS

(numrat i referohen numrit të faqes)

A. INDEKSI SIPAS OBJEKTIT TË SHQYRTIMIT

A

Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit	46, 49
Aktgjykim i formës së prerë	68
Aktvendim i Gjykatës së rregullt	68
Aktvendim i formës së prerë	34, 68
Aktvendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së	76
Aktvendimi i Kolegjit të Apelit	32, 46, 49
Anulimi i procedurës së tenderit nga AKP-ja	140
Ankesa	34
Ankesa e papranueshme	34
Ankesa e ushtruar pas afatit ligjor	19

B

Barra e provës	81
----------------	----

Ç

Çështje e gjykuar (res judicata)	34
----------------------------------	----

D

Obligimi i AKP-së për të informuar në mënyr të duhur ofertuesin përkatës lidhur me anulimin e procedurës së tenderit	140
Dërgimi në rigjykim	40, 43, 133
Dëshmi	145
Dëshmitarë	145
Diskriminimi	81
Diskriminimi etnik në shkarkimin dhe emërimin e bordit menaxherial	120

E	
Entitet	81
F	
Faktet e kontestuara dhe të pakontestuara	28
Fazë e avancuar procedurale	19
Forma me shkrim	145
fumus boni iuris	1
H	
Heqja dorë nga e drejta e ankesës	34
I	
I paditur	10, 43
J	
Juridiksioni	7, 25, 43, 72, 133
Juridiksioni i Gjykatës Komonale (tani Gjykatës Themelore)	40
K	
KEDNJ P1 neni 1	14
KEDNJ neni 6	28
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë	32, 46
Kërkesë për revizion	49
Kompetencë	25
Komuna	25
Kontrata mbi shitjen dhe transferimin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme	145
Kriteret për masë të përkohshme/ urdhër paraprak gjyqësor	1
Kundërshtimi i Aktvendimit të Komisionit të Likuidimit	37
L	
Legjitimitet procedural	10
Letra informuese	76

Lëndë e referuar	7, 40
Ligj Special (lex specialis)	76
Ligji i aplikueshëm	19, 37, 76, 145
Likuidimi	14
Lista e përkohshme	81
Lista e punëtorëve	81
Lista përfundimtare	81

M

Masat e dhunshme	81
Masë e përkohshme/urdhër paraprak gjyqësor	1, 140
Mbledhja e provave	152
Mbrojtje e Ligjshmërisë	32, 46
Minoritet	81
Mjet i Jashtëzakonshëm juridik	32, 46, 49, 68
Dështimi për të kundërshtuar listën e përkohshme	81
Mos referimi	7, 133
Mos zhdëmtimi i dëmeve	1

N

Neni 5.2 i LDHP	25
Neni 10.14 i LDHP	32, 46, 49
Nënshkrimet	145
NP	10

NJ

Njoftimi për qëllimin e parashtrimit të padisë	28
--	----

O

Oferta	145
Oferta e shkruar me dorë	145

P	
Padi Pronësore	14, 157
Paditë monetare	1
Paga e papaguar	76
Palët	10
Papranueshmëria	10, 14, 19, 28, 32, 68, 81
Parashkrim	76
Pasuri e paluajjtshme	145
periculum in mora	1
Pezullim	14
Posedimi	157
Pozita e ofertuesit më të lartë	140
Pranueshmëria e ankesës	68
Privatizim	157
Probabiliteti i të drejtës	1
probatio plena	1
probatio semiplena	1
Procedura e Likuidimit	14, 76, 157
Procedura e Përmbarimit	72
Punëtorët serb	81
Punëtorët shqiptarë	81
Q	
Qasja në gjykatë	28
R	
Rikonfigurimi i Bordit menaxherial	120
S	
SCEL	81
Seancë dëgjimore	152

SH	
SHA	43
Shënime kadastrale	157
Shkëmbim i tokës	145
T	
Tenderim	157
Toka e konfiskuar	157
Trajtim i barabartë	81
Transformimi i kapitalit të NSH-së në pronësi shoqërore në SHA	52 120
TH	
Themelimi i SHA/SHPK	52
V	
Veprime shteruese	37
Vërtetim nga Gjykata	145
Z	
Zbatueshmëria e ligjeve të aprovuara pas 22 marsit 1989	52, 120

B. INDEKSI I LIGJEVE

(Numrat në kolonën e djathtë i referohen numrave të faqes)

I. Ligjet Kryesore

LDHP

1.3	46, 49
4	7, 10, 25
4.1	72
4.1.1.4	43
4.4	7, 133
4.4(i)	40
4.6	72
5	10, 43
5.1	133
5.2	10
5.2.2.2	25
5.2.2.5	25
10.4.1	76
10.9	7, 25, 40
10.10	25, 52
10.14	32, 46, 49
14.1	1

Ligji për AKP-në2008

3	43
5.1(a)(i)	43

Ligji për AKP-në2011

Përgjithshëm	76
--------------	----

LPK

2.4	133
2.4(e)	133
14	133
17	10, 68
18	68
19	68
114	133
137.2	133
137.3	133
176	34
181.1(b)	145
182	145
182.2	133, 145
182.2(f)	68
182.2(k)	133
183	133, 145
186	34
194	68, 133
214.4	68
232	68
245	46, 68
247	46
297.1(a)	1
354.2	10, 133
357.2	133
362	133

Rreg. e UNMIK-ut 1999/24

Përgjithshëm	52, 81
1	76
1.1	120
1.2	120

	Rreg. e UNMIK-ut 2000/47	
2.3		10
4.4		20
	Rreg. e UNMIK-ut 2001/6	
44		14
	Rreg. e UNMIK-ut 2002/12	
5.4		120
29.1		28
29.3		28
	Rreg. e UNMIK-ut 2002/13	
4.1(c)		19
4.3		72
	Rreg. e UNMIK-ut 2003/13	
10.4		81
	Rreg. e UNMIK-ut 2005/18	
9.3		14
	Rreg. e UNMIK-ut 2005/48	
30		14
35		14
44.1(c)		14

Rreg. e UNMIK-ut 2008/4

Përgjithshëm	25
4	68
4.3	72
9.5	19
10.5	14
10.10	32

Shtojca e LDHP

10.6	34
10.7	34
28.2	133
28.2.2	133
28.2.2.1	10, 25
28.2.2.3	10, 25
34	152
34.3	152
42	133
43.1	152
46	152
55	1, 140
60.2	7, 19, 40
70.2	37
70.4	37

UA e UNMIK-ut 2008/6

Përgjithshëm	25, 32
28.2	28
28.2(d)	19
28.2(e)	28
28.3	28
55	1
58.2	19
63.2	19
67.1	19
67.2	81

II. Statutet plotësuese

LGJ

18	72
21	46, 49
22.1.2	46
22.1.3	49

Ligji Kundër Diskriminimit nr. 2004/3

8	81
8.1	81

Ligji mbi Kapitalin Shoqëror

1b	52
1b.2	52
2 a	52
4	52

Ligji mbi Konfiskimin e Pasurisë

10	157
----	-----

Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore

31.1	145
32.1	145
32.2	145
73	145

Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës në Rrethana të Jashtëzakonshme

Përgjithshëm 81

Ligji mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore

Përgjithshëm 81

Ligji mbi NP

3.1 10
5 10

Ligji mbi Punën e Bashkuar

608 37, 76

Ligji mbi Qarkullimin dhe Disponimin me Kapitalin Shoqërorë

2 120
2.1 120
2a 52
2.b 120
4 52, 120

Ligji mbi Qarkullimin e Tokës dhe Ndërtesave

9 145
9.12 145
12 145
47 145

XIII

Ligji mbi Reformën Agrare

29	157
----	-----

Ligji mbi Sigurimin e Komunikacionit Hekurudhor

68	10
----	----

94	10
----	----

Ligji mbi Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore

53	145
----	-----

54	145
----	-----

55	145
----	-----

56	145
----	-----

57	145
----	-----

58	145
----	-----

59	145
----	-----

60	145
----	-----

61	145
----	-----

62	145
----	-----

63	145
----	-----

64	145
----	-----

65	145
----	-----

66	145
----	-----

67	145
----	-----

LMTHPJ

28.4	157
------	-----

29	133
----	-----

LN

36.1	52
47.1	52
50	52
94	52
100	52

Rregullat e Përgjithshme të Tenderit të AKP-së

10.4	140
11	140
17	140
17.1	140
17.2.(c)	140

C. FJALITË LIGJORE

Nr.	Faqe
1. <i>Aktvendimi i datës 1 dhjetor 2010 – ASC-10-0081</i>	1
1. Paditësi/Parashtruesi që kërkon masë të përkohshme duhet të provojë të besueshme se 1. e drejta e pretenduar të jetë në rrezik ekziston dhe 2. se kjo e drejtë, nëse nuk aprovohet masa e përkohshme, është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes apo dëmtimit të riparueshëm.	
2. Dëshmia/prova e kërkuar që të ofrohet nga paditësi/parashtruesi nuk duhet të kuptohet si dëshmi e plotë (probatio plena) në kuptim të asaj të cilën ai duhet ta paraqet që të jetë i suksesshëm në padinë e tij/saj kryesore. Por për ta lëshuar një masë të përkohshme mjafton nëse paditësi vetëm dëshmon në kuptimin e probatio semiplena probabilitetit të lartë që padia e tij/saj është e bazuar, respektivisht, se e drejta e pretenduar ekziston.	
3. Paditë monetare, si rregull i përgjithshëm, nuk mund të konsiderohen që të jenë objekt i humbjes apo dëmtimit të riparueshëm.	
2. <i>Aktvendimi i datës 13 dhjetor 2012 – AC-II.13-0007</i>	7
1. Që prej hyrjes në fuqi të LDHP më 1 janar 2012, DHP-GJS nuk është e autorizuar të referojë ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë, apo ndonjë rast specifik tek gjykatat tjera të Kosovës, për të cilat ajo ka juridiksionin ekskluziv.	
2. Gjykata duhet të sigurojë që palët të kenë në dispozicion dyshkallshmërinë.	

3. *Aktvendimi i datës 14 maj 2013 – AC-II.-12-0075* 10
- Nëse i paditur i vetëm është një NP, DHPGJS nuk ka juridiksion dhe lënda duhet të hedhet poshtë.
4. *Aktvendimi i datës 23 maj 2013 – ASC-11-0116* 14
- Padia pronësore nuk mund të pezullohet apo të hedhet poshtë për shkak se ka filluar procedura e likuidimit të NSH-së.
5. *Aktvendimi i datës 20 qershor 2013 – AC-II.-12-0120* 19
- Lënda ka arritur në një fazë më të avancuar procedurale në kuptim të nenit 14.1 të LDHP nëse nuk ka arritur në nivel të Apelit para hyrjes në fuqi të LDHP me datën 1 janar 2012 dhe në këtë mënyrë legjislacioni paraardhës i aplikueshëm në kohën e parashtrimit duhet të aplikohet për gjykim.
6. *Aktvendimi i datës 19 shtator 2013 – AC-I.-12-0040* 25
1. Nëse komuna është e vetmja e paditur në lëndën në fjalë, atëherë DHPGJS-ja nuk ka juridiksion.
 2. Komuna vetëm mund të shtohet si e paditur, nëse tashmë ka të tillë, në lëndën në pritje pranë DHPGJS-së, të paditur që bie në nenin 5.2 të LDHP-së.
7. *Aktvendimi i datës 31 tetor 2013 – ASC-10-0064* 28
1. Nëse paditësi pohon se ai e ka njoftuar AKP-në lidhur me qëllimin për të parashtruar padi dhe AKP-ja nuk e ka kundërshtuar atë, atëherë padia nuk mund të hedhet poshtë si e papranueshme.
 2. Detyra e ankuesit për ta njoftuar AKP-në paraprakisht shton një barrë shtesë për të për sa i përket qasjes së tij

në gjykatë dhe një dispozitë e tillë duhet të interpretohet në një mënyrë të kufizuar.

8. *Aktvendimi i datës 31 tetor 2013 – AC-I.-13-0094* 32

As mjete i jashtëzakonshëm as ankesa nuk mund të parash-trohen ndaj një Aktvendimi të Kolegjit të Apelit të DHP-GJS-së.

9. *Aktvendimi i datës 19 dhjetor 2013 – AC-II.-12-0053* 34

“Ankesat” e ushtruara kundër Aktvendimeve të plotfuqishme janë të papranueshme.

10. *Aktvendimi i datës 20 shkurt 2014 – AC-I.-13-0233* 37

1. Në procedura kundër ankesave të vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, neni 70.4 të Shtojcës së LDHP përmban listë shteruese të veprimeve – për të ‘vërtetuar’, ‘revokuar’, apo ‘ndryshuar’ – Aktvendimin e kundërshtuar – për t’u ndërmarrë nga ana e gjykatës.

2. Neni 70.4 i Shtojcës së LDHP nuk e autorizon gjykatën për t’a referuar lëndën prapa tek Autoriteti i Likuidimit për të ri-ushtruar zgjedhjen administrative. Gjykata duhet të vendosë vet mbi meritat e ankesës dhe të vendosë lidhur me padinë në fjalë.

11. *Aktvendimi i datës 27 shkurt 2014 – AC-II.-12-0169* 40

Nëse gjykata të cilës iu është referuar lënda pas hyrjes në fuqi të LDHP, nuk ka ndërmarrë kurrfarë vendimi substantiv (me vendim substantiv do të kuptohet caktimi i seancës kryesore) lidhur me çështjen, një gjykatë e tillë nuk ka më tutje juridiksion dhe se lëndën duhet t’ia bartë DHPGJS-së.

12. *Aktvendimi i datës 16 prill 2014 – AC-II.-13-0030* 43

Nëse i paditur i vetëm është një SHA, DHPGJS nuk ka juridiksion dhe lënda duhet të hudhet poshtë.

13. *Aktvendimi i datës 12 shtator 2014 – AC-I.-14-0077* 46

1. Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë përbëjnë shqyrtim të Gjykatës Supreme të vendimit përfundimtar të cilësdo gjykate më të ulët (në shkallë të parë apo të dytë) në mënyrë që të korrigjohen shkeljet thelbësore të rregullave procedurale apo zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
2. Aktvendimet e nxjerra nga kolegjet e DHPGJS-së në shkallë të parë, të cilat janë bërë të plotfuqishme ngase ndaj tyre nuk është parashtruar ankesë sipas rregullit, mund të konsiderohen se janë nxjerrë nga një gjykatë më e ulët dhe si pasojë të përfshihen në sferën e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë.
3. DHPGJS është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës. Prandaj, Aktvendimet dhe Aktgjykimet e lëshuara nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk janë nxjerrë nga një gjykatë më e ulët por nga vet Gjykata Supreme.

14. *Aktvendimi i datës 12 shtator 2014 – AC-I.-14-0078* 49

1. Revizioni parasheh vlerësimin nga Gjykata Supreme të një Aktgjykimi të lëshuar nga një gjykatë e shkallës së dytë i cili nuk i nënshtrohet ndonjë apeli tjetër, në mënyrë që të korrigjojë shkeljen thelbësore të rregullave procedurale apo zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
2. Aktvendimet dhe Aktgjykimet e lëshuara nga Kolegji i Apelit nuk mund të jenë objekt i revizionit sepse nuk

janë lëshuar nga një gjykatë e shkallës së dytë por nga vet Gjykata Supreme.

1. Nëse një ligj i miratuar pas 22 marsit 1989 nuk përmban elemente diskriminuese – siç është Ligji për Kapitalin Shoqëror, i 20 gushtit 1990 -, mund të përcaktohet të jetë i zbatueshëm në përputhje me Rreg. e UNMIK-ut 1999/24, e cila ishte e nevojshme nga natyra diskriminuese e disa prej legjislacioneve të mëvonshme të RSFJ.
2. Këshilli i Punëtorëve të NSH ka autoritet ekskluziv për të vendosur për fillimin e procesit të privatizimit përmes transformimit. Megjithatë, si palë në privatizim, këshilli e punëtorëve nuk ka autoritet për të vendosur mbi vlerën e kapitalit që do të gjenerohet përmes shpërndarjes së aksioneve.
3. Bilanci nuk është një zëvendësim për një vlerësim të duhur të asetëve të NSH-së.
4. Edhe në qoftë se një agjenci e akredituar vlerësimi nuk ekziston ose nuk ka qenë në dispozicion në kohën kur këshilli i punëtorëve ka miratuar vendimin për transformim, diçka e tillë nuk do t'i shtojë vlerën ligjore vendimit të këshilli që të zëvendësojë vlerësimin zyrtar me çfarëdo lloj raporti.
5. Një vlerësim i miratuar nga agjencia e akredituar e vlerësimit përbën një lloj akti administrativ. Si një parim i përgjithshëm, asnjë person - fizik ose juridik – nuk është i lejuar për të zëvendësuar ndonjë akt administrativ me vullnetin e tyre.
6. Transformimi është një proces shumë fazësh ku vlefshmëria e çdo hapi është e përcaktuar edhe me vlefshmërinë e hapave të mëparshëm. Një dështim i theksuar në një fazë, e bën tërë procesin të pavlefshëm edhe nëse nuk ka pasur dështime të tjera.

16. *Aktvendimi i datës 4 dhjetor 2014 – AC-II.-14-0015* 68
1. Ankesa kundër Aktgjykimit apo Aktvendimit të plotfuqishëm të gjykatës së rregullt është e papranueshme.
 2. Aktgjykimet apo Aktvendimet e plotfuqishme të gjykatave të rregullta mund të kundërshtohen vetëm përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike.
17. *Aktvendimi i datës 5 shkurt 2015 – AC-II.-14-0047* 72
1. Nëse një lëndë bie në juridiksionin e DHPGJS-së ose jo, për këtë vendos ekskluzivisht DHPGJS-ja në bazë të nenit 4.6 të LDHP-së.
 2. DHPGJS-ja nuk është kompetente të vendos lidhur me çështjet në procedurën përmbartimore.
18. *Aktvendimi i datës 4 mars 2015 – AC-I.-14-0323* 76
1. Për ankesat kundër vendimeve të autoritetit të likuidimit në lidhje me kërkesat për rrogat e papaguara, Ligji për AKP-në 2011, i cili rregullon procedurën e likuidimit dhe përmbushjen e kërkesave kreditore, është ligj special (*lex specialis*) dhe dominon ndaj dispozitave të parashkrimit të Ligjit të Punës së Bashkuar që është ligj i përgjithshëm (*lex generalis*).
 2. Shkresa përmes së cilës APK-ja i njofton punëtorët për ndërprerjen e punësimit dhe se rrogat e papaguara mbesin përgjegjësi e punëdhënësit, pezullon parashkrimin.
19. *Aktgjykimi i datës 12 mars 2015 – AC-I.-14-0023* 81
1. Një ankues, për të pohuar diskriminimin ndaj mos përfshirjes në listën përfundimtare të punëtorëve të një

NSH-je, duhet vetëm të përcaktojë faktet e veçanta nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim – të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

2. E kundërta e barrës së provës kërkon nga i padituri që të provojë të kundërtën, d.m.th. se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
3. Personat që supozohet se i janë nënshtruar diskriminimit janë punëtorët të cilët nuk janë përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta për të përfituar një pjesë nga 20% e të ardhurave për shkak të përkatësisë së tyre etnike, besimeve politike dhe fetare. Varësisht nga periudha, ata ishin në veçanti:
 - a) punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, ashkali, romë, egjiptian, goran dhe turq, të cilët ishin pushuar për shkaqe diskriminuuese në periudhën prej vitit 1989 dhe 1999 dhe
 - b) punëtorët e përkatësisë etnike serbe, të cilët nuk janë paraqitur në punë pas qershorit të vitit 1999.
4. Dështimi për të kundërshtuar listën e përkohshme nuk e bën një ankesë kundër listës përfundimtare të papranueshme.

20. *Aktgjykimi i datës 2 prill 2015 – AC-I-14-0169*

120

1. Kapitali në pronësi shoqërore i një NSH-je mund të shpërndahet vetëm përmes një kontrate që mbartë obligime dhe të drejta reciproke por jo përmes dhurimit.
2. Vetëm këshilli i punëtorëve të NSH-së është i autorizuar që të marr vendim për shitjen e kapitalit shoqëror.
3. Edhe në qoftë se një numër i madh i punëtorëve të nacionalitetit shqiptar ka vazhduar punën, e edhe nëse madje atyre iu janë shpërndarë të aksionet, kjo nuk mund të

çojë në përfundimin se nuk ka ekzistuar një paragjykim etnik atëherë kur bordi drejtues është rikonfiguruar në atë mënyrë që asnjë menaxher shqiptar nuk ka mbetur tek organi i përkohshëm i ndërmarrjes.

21. *Aktvendimi i datës 14 maj 2015 – AC-II-12-0029* 133

1. Është detyrë e gjykatës që të vërtetojë interesin juridik të paditësit.
2. Interesi ligjorë është një kusht absolut për pranueshmërinë e padisë.
3. Vetëm mbajtësi i një të drejte subjektive apo pasardhësi ligjorë me të drejtë subjektive e cila është mohuar apo shkelur nga personi i tretë mund të iniciojë procedurat për njohjen apo rivendosjen e një të drejte.

22. *Aktvendimi i datës 10 shtator 2015 – AC-I-14-0257* 140

1. Pozita e ofertuesit më të lartë si edhe pozita e fituesit të përkohshëm përkon me interesin e arsyeshëm dhe të paanshëm për të garantuar mbrojtjen.
2. AKP-ja nuk ka të drejtë që të anulojë tenderin bazuar në zgjedhjen që iu është dhënë Bordit të Drejtorëve të AKP-së, përmes dispozitave të nenit 17 të Rregullave të Përgjithshme të Tenderit për të shtyrë apo anuluar tenderin në çfarëdo kohe ose për çfarëdo arsye. Kjo zgjedhje nuk është pa kufizime.
3. Vendimi i AKP-së për të shtyrë ose anuluar tenderin duhet të jetë eksplicit, të jetë i arsyetuar dhe t'i dorëzohet ofertuesit përkatës. Përndryshe kjo mund të shkaktojë që një vendim i tillë të konsiderohet i pavlefshëm.

23. *Aktgjykimi i datës 10 dhjetor 2015 – AC-II-12-0203* 145

1. Kontrata mbi shitjen dhe transferimin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme duhet të lidhet me shkrim dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen nga Gjykata e kompetencës teritorriale.
2. Ofertat e shkruara me dorë/propozimet për lidhjen e një kontrate i pranuar nga komisioni i NSH-së për shkëmbimin e tokës nuk përbën kontratë me shkrim nëse nuk është pranuar nga Drejtori i NSH-së në formë të shkruar.
3. Kur kontrata me shkrim nuk është lidhur fare atëherë dëshmia e dëshmitarëve rreth shitjes dhe transferimit të pronësisë mbi pronën e paluajtshme është irelevante.

24. *Aktvendimi i datës 10 shkurt 2016 – AC-I-15-0233* 152

1. E vetmja mundësi për shkallën e parë që të mbyllë rastin me Aktgjykim pa mbajtur seancë dëgjimore është e paraparë me nenin 34 të Shtojcës së LDHP.
2. Mos lëshimi i urdhrit dhe mos kompletimi i procedurës siç është e paraparë me nenin 34 të Shtojcës së LDHP, shkalla e parë shkel të drejtën e palëve për t'u dëgjuar para gjykatës që përbën shkelje thelbësore të procedurës së përcaktuar.

25. *Aktgjykimi i datës 10 shkurt 2016 – AC-I.15-0249* 157

Pa Aktvendim të formës së prerë të lëshuar nga autoriteti publik kompetent që anulon aktin e konfiskimit, paditësi nuk mundet me sukses ta kërkojë pronësinë mbi pronën e konfiskuar

JURISPRUDENCA

1.

Parakushtet për propozimin për masë të përkohshme/urdhër paraprak gjyqësor, përgjithësisht nuk ekzistojnë dëme të pariparueshme tek paditë/kërkesat monetare

Masë e përkohshme/urdhër paraprak gjyqësor; Kriteret për masë të përkohshme/urdhër paraprak gjyqësor; Barra e provave; fumus boni iuris; periculum in mora; probatio plena; probatio semiplena; Probabiliteti i së drejtës; Mos zhdëmtimi i dëmeve; Padia monetare

UA e UNMIK-ut 2008/6 neni 55 (prej 1 janarit 2012: Shtojca e LDHP neni 55); LDHP neni 14.1; LPK neni 297.1(a)

1. Paditësi/Parashtruesi që kërkon masë të përkohshme duhet të provojë të besueshme se 1. e drejta e pretenduar të jetë në rrezik ekziston dhe 2. se kjo e drejtë, nëse nuk aprovohet masa e përkohshme, është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes apo dëmtimit të pariparueshëm.
2. Dëshmia/prova e kërkuar që të ofrohet nga paditësi/parashtruesi nuk duhet të kuptohet si dëshmi e plotë (probatio plena) në kuptim të asaj të cilën ai duhet ta paraqet që të jetë i suksesshëm në padinë e tij/saj kryesore. Por për ta lëshuar një masë të përkohshme mjafton nëse paditësi vetëm dëshmon në kuptimin e probatio semiplena probabilitetit të lartë që padia e tij/saj është e bazuar, respektivisht, se e drejta e pretenduar ekziston.
3. Paditë monetare, si rregull i përgjithshëm, nuk mund të konsiderohen që të jenë objekt i humbjes apo dëmtimit të pariparueshëm.

Aktvendimi i datës 1 dhjetor 2010 – ASC-10-0081 (Shkalla e parë: Aktvendimi i datës 4 tetor 2010 – SCC-10-0062)

- 1 **Rrethanat faktike dhe procedurale:** Më 2 prill 2010, paditësi e parashtrroi një padi pranë DHPGJS-së duke kërkuar njohjen e të drejtës pronësore të tij lidhur me pronat e paluajtshme të regjistruara si ngastra kadastrale ... me një sipërfaqe prej ... ha dhe ngastra kadastrale ... (tani ...) me një sipërfaqe prej ... ha në fshatin R. në zonën kadastrale të D., Komuna e K., fleta poseduese nr. Ai gjithashtu ka kërkuar nga DHPGJS-ja që e njëjta të regjistrohet në regjistrat kadastral.
- 2 Përveç kësaj, paditësi i kërkoi DHPGJS-së që ta lëshojë një masë të përkohshme për t'i ndaluar të paditurit ta tjetërsojnë ose të marrin çfarëdo veprimi tjetër lidhur me objektin e këtij kundërshtimi derisa DHPGJS-ja ta lëshon Aktvendimin përfundimtar.
- 3 Si dëshmi të pretendimeve të tij, paditësi e paraqiti një certifikatë për të drejtat [e] pronës së paluajtshme si dhe Aktvendimin e Komisionit Komunal të K. të datës 26 shkurt 1970.
- 4 Më 13 prill 2010, DHPGJS-ja kërkoi nga paditësi t'i dorëzojë përkthimet e dokumenteve shtesë, dëshmi se ai e ka bërë njoftimin për qëllimin e tij për ta parashtruar një padi ndaj Agjencisë dhe dëshminë e trashëgimisë.
- 5 Më 26 prill 2010, paditësi e paraqiti një certifikatë të vdekjes lidhur me paraardhësin e pretenduar të tij.
- 6 Më 22 qershor 2010, DHPGJS-ja vazhdimisht ka kërkuar sqarime nga paditësi gjithashtu duke synuar atë nëse ai dëshiron të paraqesë dokumente shtesë për ta mbështetur kërkesën e tij për lëshimin e masës së përkohshme.
- 7 Më 8 korrik 2010, paditësi u përgjigj por nuk parashtrroi asnjë dëshmi shtesë.
- 8 Më 19 korrik 2010, DHPGJS-ja e dorëzoi kërkesën për masën e përkohshme tek të paditurit.
- 9 Më 29 korrik 2010, i padituri i 1-rë i kërkoi DHPGJS-së ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Më 4 tetor 2010, DHPGJS-ja e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme si të pabazuar. Trupi Gjykses pohoi se paditësi nuk arriti të paraqesë dëshmi të besueshme se do të shkaktohej dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm nëse nuk lëshohej masa e përkohshme. 10

Më 27 tetor 2010, paditësi ushtroi një ankesë duke kërkuar nga Kolegji i Ankesave që ta anulojë Aktvendimin e Trupit Gjykses dhe ta miratojë kërkesën për masën e përkohshme. Në ankesën e tij, ankuesi pohoi se ai di për disa raste ku Agjencia e ka shitur tokën nën pronësinë private, dhe edhe pse nuk ka rrezik të menjëhershëm që kjo të ndodhë, megjithatë ai dëshiron që të drejtat e tij të mbrohen. 11

Më 4 nëntor 2010, DHPGJS-ja i kërkoi ankuesit ta sqarojë ankesën e tij lidhur me argumentet ligjore mbi të cilat ai e mbështetë ankesën e tij, duke e cituar nenin 60.1(c) UA e UNMIK-ut 2008/6 dhe në vazhdim, nenet 353-356 të LPK-së. 12

Ankuesi më 17 nëntor 2010 paraqiti një parashtrësë ku ai pohon se Gjykata duhet ta dijë se LPK-ja nuk është më në fuqi. Ai nuk jep asnjë shpjegim tjetër se cilat janë argumentet ligjore të cilat ai i ngrit për ta kundërshtuar Aktvendimin e ankimuar. 13

Arsyetimi ligjor: Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave vendosi që ta refuzojë pjesën gjore të procedurës. 14

Kriteret se kur duhet të jepet një masë e përkohshme janë të përcaktuara në nenin 55.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, siç ceket më lartë: Pala duhet të paraqesë dëshmi të besueshme se do të shkaktohej humbje apo dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm nëse nuk lëshohet kërkesa. Këto kritere janë të përcaktuara në atë mënyrë që nëse mungon ndonjëra nga të mësipërmet atëherë kërkesa mohohet. 15

Kërkesa e dëshmimeve të besueshme përfshinë të dyja, *fumus boni iuris* (mundësia që e drejta e pretenduar ekziston) dhe *periculum in mora* (rreziku i menjëhershëm për këtë të drejtë), pasi që humbja ose dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse në të vërtetë e drejta e pretenduar ekziston. 16

- 17 Me fjalë të tjera: paditësi/kërkuesi i cili e kërkon masën e përkohshme duhet ta vërtetojë [e saktë : duhet ta provojë] se është e mundshme, se 1. e drejta për të cilën ai pohon se është rrezikuar ekziston dhe 2. se kjo e drejtë është në rrezik të menjëhershëm për humbje ose dëmtim të pariparueshëm, nëse nuk lëshohet masa e përkohshme e kërkuar.
- 18 Kjo dëshmi e cila kërkohet që të paraqitet nga paditësi/kërkuesi nuk duhet të kuptohet si një dëshmi e plotë (probatio plena) në kuptim të asaj të cilën ai duhet ta paraqet që të jetë i suksesshëm me padinë e tij kryesore. Nëse ai do, dhe nëse ai është në gjendje që ta sjellë këtë dëshmi të plotë, kjo patjetër se do të rekomandohej shumë. Por për ta lëshuar një masë të përkohshme mjafton nëse paditësi vetëm dëshmon në kuptim të probatio semiplena një mundësi të lartë se padia e tij është e bazuar, përkatësisht, se e drejta e pretenduar ekziston. Për ta vërtetuar këtë gjendje të mundësisë së lartë mjafton për shembull referimi tek dokumentet, origjinaliteti i tyre i parashikuar në këtë fazë të procedurës, nga të cilat mund të ngritet e drejta e pretenduar. Në ato raste, gjithashtu edhe barra e dëshmisë duhet që të merret parasysh. Nëse paditësi është në gjendje që t'i sjellë dokumentet e kërkuara të cilat e vërtetojnë të drejtën e pretenduar në një pikë të caktuar kohore (ose nëse madje është e pakontestueshme), barra e dëshmisë për një ndryshim të mëvonshëm në këtë të drejtë mund të jetë me të paditurin. Sidoqoftë, vërtetimi apriori i atyre fakteve nga pikëpamja e mundësisë së lartë nuk e ndalon gjykatën që më vonë të vijë tek një përfundim tjetër gjatë shqyrtimit kryesor. Gjykata, me vërtetimin e fakteve të caktuara për qëllimin e procedurës gjyqësore lidhur me masën e përkohshme, në asnjë mënyrë nuk është e lidhur nga ky vërtetim nga procedura gjyqësore vijuese, pasi që shumë lehtë mund të përcjellet nga natyra paraprake e një mase të tillë. Nëse nuk ka arsye të veçanta të tjera që i shtohen këtij vërtetimi të pastër procedural, një anim i gjykatës drejt njëres nga palët nuk mund të hiqet nga Aktvendimi për masën e përkohshme.
- 19 Lidhur me *periculum in mora* duhet të theksohet në parim se asnjë dëm “i riparueshëm” nuk mund të del për palën – per definitionem – si pasojë e dështimit të palës tjetër për ta paguar borxhin, i cili gjithnjë mund të kompensohet per equivalentem (p.sh., me pagesën e shumës së njëjtë të parave, plus intereset, pas Aktgjykimit përfundimtar), sepse vetë dëmi është “i riparueshëm” me kompensim, përveç - në raste të jashtëzakonshme, të vërtetohet në mënyrë strikte nga paditësi - i përmbuaruari nuk ka mjete të

mjaftueshme financiare për ta kryer obligimin e tij (kjo mund të ndodhë, për shembull, për një kompani e cila ka falimentuar, për një person të pa punë etj.). Tani duhet të theksohet qartë se institucioni ligjor i masës së përkohshme nuk e ka për qëllim ta sigurojë zbatueshmërinë e një Aktvendimi të mundshëm në të ardhmen nga ana e gjykatës për dhënien e dëmeve, por vetëm për ta shmangur një ndryshim të pakthyeshëm në statusin ligjor ose faktik të së drejtës ose posedimin që është objekt i padisë kryesore me të cilën duhet të merret gjykata. Prandaj, pretendimet monetare nga natyra e tyre e veçantë, si rregull i përgjithshëm, nuk mund të konsiderohen që të jenë objekt i humbjes ose dëmit të pariparueshëm (ASC-09-0035). Kur është fjala për përjashtimet e mësipërme nga kjo rregull e përgjithshme, nuk mund të lëshohet një masë e përkohshme e cila e jep “kënaqësinë paraprake” të kërkuarit, por mund të urdhërohet vetëm ngrirja e asetëve të caktuara të veçanta, natyrisht vetëm nëse nga kërkuari bëhet një depozitë e mjaftueshme në pajtim me nenin 55.4 e UA-së së UNMIK-ut 2008/6 (ASC-10-0017).

Paditësi nuk ka dhënë asnjë dëshmi në mbështetje të kërkesës së tij. **20**
Ai fare nuk ka treguar në këtë moment të caktuar se posedimi i tij do të rrezikohet nga veprimet e të paditurve. Ai nuk ka paraqitur – dhe madje ai as nuk ka pohuar - asnjë tregues, për shembull likuidimin ose privatizimin e planifikuar të NSH-së, i cili mund të kuptohet si një ndryshim i rëndësishëm që do të mund të çonte në nevojën e lëshimit të një mase të përkohshme të tillë.

Përveç konsideratave të mësipërme, humbja ose dëmi i mundshëm do të duhej të ishte i pariparueshëm, që nuk duket të jetë fakti në rastin në fjalë. Humbja (e mundshme) e posedimit nuk duhet të konsiderohet si e pariparueshme. **21**

Duke pasur parasysh fumus boni juris, paditësi vetëm pohon se ai e ka posedimin e pashqetësuar të tokës por ai nuk jep asnjë dëshmi (në kuptim të përshkrimit të mësipërm) lidhur me titullin e pronësisë së tij. **22**

Duke i përmbyllur argumentet e cekura më lartë, pasi që asnjë nga kriteret e nevojshme për ta lëshuar një masë të përkohshme të përcaktuar nga dispozita e cituar e ligjit nuk është përmbushur, Aktvendimi i Trupit Gjykes për refuzimin e masës së përkohshme të kërkuar vërtetohet. **23**

Shënim i Redaktorit: Ky Aktvendim më tej e zhvillon jurisprudencën lidhur me kërkesat monetare, ASC-09-0035 dhe lidhur me sigurinë monetare (Prej datës 1 janar 2012: neni 55.4, Shtojca e LDHP), ASC-10-0017.



2.

Mos-Referimi i Lëndëve me Juridiksion Primar tek Gjykatat Tjera

Juridiksioni; Mos-Referimi; Lëndë e Referuar

LDHP neni 10.9, 4, 4.4; Shtojca e LDHP neni 60.2

1. Që prej hyrjes në fuqi të LDHP më 1 janar 2012, DHPGJS nuk është e autorizuar të referojë ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë, apo ndonjë rast specifik tek gjykatat tjera të Kosovës, për të cilat ajo ka juridiksionin ekskluziv.
2. Gjykata duhet të sigurojë që palët të kenë në dispozicion dyshkallshmërinë.

Aktvendimi i datës 13 dhjetor 2012 – AC-II.13-0007 (Shkalla e parë: Aktvendimi i datës 15 shkurt 2012 i Gjykatës Komunale në L. – C.nr.328/09)

Rrethanat faktike dhe procedurale: Më 1 mars 2012, të paditurit 2 dhe 3, përmes avokatit të tyre kanë parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në L., C.nr.328/09, të datës 15 shkurt 2012 për shkak të siç thuhej, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të të drejtës materiale. Gjykata Komunale në L., me Aktvendimin e kundërshtuar e kishte shpallur këtë gjykatë inkompetente për të vendosur lidhur me këtë çështje juridike. Përkundër kësaj, ankuesit konsiderojnë si DHPGJS nuk ka kompetencë lidhur me këtë çështje, sepse kontesti është në zhvillim e sipër një kohë të gjatë, që nga viti 1994, dhe se kompetente për të gjykuar në këtë rast është Gjykata Komunale në L. Ky kontest kishte filluar me kërkesën e Prokurorit Publik Komunal, për anulimin e kontratës së vërtetuar në Gjykatën Komunale të L. Vr.nr. ..., të datës 16 dhjetor 1960, të lidhur ndërmjet tani të ndjerit *J K* dhe të paditurës së parë, dhe t'ia kthej të paditurit të dytë dhe të tretë në posedim ngastrën kadastrale nr. ..., në sipërfaqe prej ... ha.

1

- 2 Lënda fillimisht ishte regjistruar për Kolegjin e Specializuar të DHP-GJS-së me nr. C-III-12-0775, por me një urdhër të brendshëm, kjo lëndë ishte regjistruar për Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.
- 3 Më 13 dhjetor 2012, përmes të autorizuarit të tyre, avokatit *I D*, ankuesit kanë parashtruar edhe një propozim, për lëshimin e masës së përkohshme, me të cilën i ndalohet AKP-së shitja apo tjetërsimi i ngastrave kontestuese.
- 4 **Arsyetimi Ligjor:** Ankesa është pabazuar.
- 5 Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Ankesave ka vendosur që të mos vazhdojë me pjesën gojore të procedurës gjyqësore.
- 6 Në bazë të nenit 10.9 të LDHP-së dhe nenit 60.2 të Shtojcës së LDHP, ankesa nuk i dërgohet të paditurës së parë për përgjigje.
- 7 Ankesa e të paditurve është e pabazuar, sepse kompetente ekskluzive për gjykimin e kësaj çështje është DHPGJS, konform nenit 4 të LDHP-së.
- 8 Në bazë të nenit 4.4 i [të] LDHP, që prej hyrjes në fuqi të këtij ligji DHPGJS nuk ka asnjë autoritet për të referuar ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë, apo rast specifik që është në kompetencën primare të DHPGJS, tek gjykatat tjera të Kosovës, andaj në rastin konkret duhet të vendos në rigjykim Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së .
- 9 Procedura kontestimore lidhur me këtë çështje kishte filluar në vitin 1994, por asnjëherë nuk dihet të ketë përfunduar me një vendim të formës së prerë. Madje, Gjykata e Qarkut e P., me Aktvendimin Ac.nr. ..., të datës 6 tetor 2009, e kishte anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të L., C.nr. ..., të datës 26 shkurt 1999, dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim në Gjykatë Komunale të L.
- 10 Pasi që lidhur me këtë çështje, kjo Gjykatë nuk ka vendosur në merito të çështjes, për shkak të inkompetencës lëndore, por edhe për shkak se ankuesit ndërkohë kanë parashtruar propozim për caktimin e masës së përkohshme, për hir të respektimit të dyshkallëshmërisë të dëgjimit

të kërkesës në procedurën kontestimore, kjo lëndë duhet të dërgohet në Kolegjin respektiv të Specializuar të DHPGJS-së për gjykim.

Prandaj, për gjitha arsyet e mësipërme, dhe konform nenit 10.10 të LDHP, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi. **11**

⌚⌚⌚

3.

Nuk ka Juridiksion mbi Ndërmarrjet Publike

Papranueshmëria; Palët; I paditur; NP; Legjitimitet procedural

LPK neni 354.2, 17; Rreg. e UNMIK-ut 2000/47 neni 2.3 4.4; Ligji mbi Sigurimin e Komunikacionit Hekurudhor neni 68, 94; LDHP neni 4, 4.1.1.2, 5, 5.2; Shtojca e LDHP neni 28.2.2.1, 28.2.2.3; Ligji për AKP-në 2008 neni 5.1(a)(i), 3; Ligji mbi NP neni 5, 3.1

Nëse i paditur i vetëm është një NP DHPGJS nuk ka juridiksion dhe lënda duhet të hudhet poshtë.

Aktvendimi i datës 14 maj 2013 – AC-II.12-0075 (Shkalla e parë: Aktvendimi i datës 4 nëntor 2008 i Gjykatës Komunale në K. – C.nr. 19/2004)

- 1 **Rrethanat faktike dhe procedurale:** Më 30 janar 2007, paditësit kishin parashtruar padi në Gjykatën Komunale në K., me të cilën kërkuan nga Gjykata që ta obligoj të paditurën që t’ia paguaj shumën prej ... € në emër të kompensimit të dëmit. Në padi paditësit kanë theksuar se më datë 30 shtator 2002 në aksin rrugor K.-G., konkretisht në vendkalimin hekurudhor në K., ka ndodhur aksident komunikacioni në mes të veturës e tipit “Sead T”, me targë ... KS ..., të cilin e drejtonte tani i ndjeri L C, nga K. e V. I ndjeri, pasi që ka arritur në binarë ku është vendkalimi hekurudhor, është goditur nga treni transportues që vinte nga P. Automjetin e ka goditur në derën e parë të anës së majtë dhe e kishte bartur në largësi prej 60.50 metra, ku nga lëndimet e marra drejtuesi i automjetit vdes.
- 2 Më 4 nëntor 2008, Gjykata Komunale në K., me Aktgjykimin C.nr. 19/2004, aprovon kërkesëpadinë e paditësve, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të dëmit t’ia paguaj për L C shumën prej ... €, paditësve të tjerë P, D, V, Sh dhe I C veç e veç nga ... €, në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit dhe babait më kamatë prej 3,5 për qind, prej 30 janar 2004 e deri në pagesën de-

finitive, shumën prej ...€ në emër të shpenzimit të varrimit më kamatë prej 3,5 për qind, prej 30 janar 2004 e deri në pagesën definitive, në emër të kompensimit të automjetit shumën prej ...€, më kamatë prej 3,5 për qind, prej 30 shtator 2002, në emër të mbajtës së humbur-rentës, shumën prej ...euro, më kamatë prej 3,5 për qind, prej 30 shtator 2002 deri në pagesën definitive, paditësve, *D, V, I* dhe *L C*, në emër të mbajtës së humbur, shumën prej ... euro për periudhën e ardhshme, duke filluar prej 7 janar 2008 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për çdo muaj si dhe e paditura t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej ... euro, më kërcënimin e përmbarrimit më dhunë.

Më 6 maj 2009, e paditura (tash e tutje ankuesja) kishte parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në K. C.nr. 19/2004 të datës 4 nëntor 2008, në Gjykatën e Qarkut në P., për shkak se, siç thuhet; shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimin jo të drejtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Ankuesja pohon se shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore konsiston në faktin se Aktgjykimi i atakuar është në kundërshtim me nenin 354.2 të LPK-së, e lidhur më nenin 2.3 dhe nenit 4 të Rreg. së UNMIK-ut 2000/47, sepse në kohën kur ka ndodhur aksidenti më datë 30 shtator 2002, kanë qenë Hekurudhat e UNMIK-ut. Si provë është ofruar Certifikata mbi Regjistrimin e subjektit afarist me emrin N.P.T.SH Hekurudhat e UNMIK-ut,[saktë: Hekurudhat e administruara nga UNMIK-u] me numër të regjistrimit të përkohshëm ... i datës ...2002. E paditura në këtë rast e konstaton se i mungon legjitimiteti aktiv [saktë: pasiv] për të qenë palë, sepse në momentin kur ka ndodhur aksidenti më të paditurën ka menaxhuar, udhëhequr UNMIK-u. Sipas të paditurës Hekurudhat e UNMIK-ut, janë transferuar në Hekurudhat e Kosovës më datë 21 dhjetor 2005, me numër të biznesit

Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që ka pranuar ekspertizën nga eksperti ing. i diplomuar i komunikacionit rrugor, e ka qenë e domosdoshme që ekspertiza të bëhej nga eksperti profesional i cili posedon përgatitje profesionale, të jetë ing i diplomuar i komunikacionit Hekurudhor me provim të dhënë profesional.

Sipas ankueses në Aktgjykimin e ankimuar është aplikuar gabimisht 5 drejta materiale. Sipas nenit 68 të Ligjit mbi Sigurimin e Komunika-

cionit Hekurudhor, vozitësi i cili i ofrohet vendkalimit mbi hekurudhë është i obliguar që të vozitë më atë shpejtësi në mënyre që të ndalet para vendkalimit mbi hekurudhë, po ashtu neni 94 i të njëjtit Ligj parasheh që kryqëzimi i rrugës hekurudhore me atë rrugore, citon që trenat në komunikacionin hekurudhor kanë përparësi kalimi ndaj mjeteve motorike, apo pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion.

6 Andaj i propozon Gjykatës së shkallës së dytë që të prish Aktgjykimin e ankimuar si të pa bazuar dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

7 Më 19 maj 2009 paditësit kanë paraqitur përgjigje në ankesë duke i propozuar Gjykatës që ankesën e ankueses ta refuzojë si të pa bazuar, ta vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar, duke pohuar se Gjykata Komunale në K. nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale siç ka pretenduar e paditura, e njëjta ka vërtetuar në mënyre të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike.

8 Më 21 tetor 2010 Gjykata e Qarkut në P. ka dorëzuar në DHPGJS shkresat e lëndës C.nr.19/2004 në kompetencë për të vendosur sipas ankesës të ushtruar nga ana e të paditurës. Lënda në DHPGJS është regjistruar më numër ..., pas kësaj më një urdhër të brendshëm në DHPGJS lënda është regjistruar në Kolegjin e Apelit me numër AC-II-12-0075.

9 **Arsyetimi Ligjor:** Kolegji i Ankesave nuk ka kompetencë për shqyrtimin e ankesës.

10 Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Ankesave ka vendosur që të mos vazhdojë me pjesën gojore të procedurës gjyqësore.

11 Konform ligjit për AKP-në2008 neni 3, “ndërmarrje” në kuptimin e këtij ligji është “ndërmarrja mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin në përputhje me nenin 5.1(a)(i) të Ligjit për AKP-në 2008, që do të thotë se *agjencia është e autorizuar që të administroj ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo.*

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë ku paditësit janë persona fizik, ndaj një NP, që bie nën juridiksionin e gjykatave të rregullta të Kosovës.

NP janë të rregulluara në bazë të Ligji për NP, i cili ka hyrë në fuqi më 13 Qershor 2008. Në këtë rast e paditur është Hekurudhat e Kosovës – SH.A, konkretisht, është përcaktuar si NP sipas nenit 3.1 të Ligjit për NP, ku thuhet se “të gjitha ndërmarrjet publike të radhitura në Listën 1, e cila i është bashkangjitur këtij ligji, janë NP Qendrore...”, e që janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Si palë e paditur është një NP dhe për këtë arsye nuk është një Ndërmarrje apo Korporatë, siç kërkohet në nenin 4.1.1.4 i LDHP, as një i paditur, siç kërkohet në nenin 5.2 i [të] LDHP, andaj DHPGJS nuk ka juridiksion në këtë rast. 12

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për NP:
Qeveria do të ketë kompetencë të veçantë në ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore (...) 13

Andaj, duke u bazuar në argumentet ligjore të cituara më lartë, gjegjësisht në Ligjin e ri të Dhomës së Posaçme, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se DHPGJS, nuk ka kompetencë që të vazhdoj me gjykimin e kësaj çështje, sipas ankesës dhe se kjo lëndë duhet të dërgohet në Gjykatën e Apelit në P. 14

Në bazë të këtyre arsyeve, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi. 15

Shënim i Redaktorit: Shiko gjithashtu Aktvendimin e datës 5 nëntor 2013 – AC-II.-12-0094 në të cilin Gjykata ka përcaktuar forumin e duhur bazuar në LGJ.



4.

Mos-Pezullimi i padive pronësore

Papranueshmëria; Likuidimi; Paditë pronësore; Pezullimi; KEDNJ P1 neni 1; GJEDNJ; Procedura e Likuidimit

Rreg. e UNMIK-ut 2005/18 neni 9.3; Rreg. e UNMIK-ut 2005/48 neni 30, 35, 44.1(e); Rreg. e UNMIK-ut 2001/6 neni 44; Rreg. e UNMIK-ut 2008/4 neni 10.5 (nga 21 shtatori 2011: Ligji për AKP-në2011)

Padia pronësore nuk mund të pezullohet apo të hedhet poshtë për shkak se ka filluar procedura e likuidimit të NSH-së.

Aktvendimi i datës 23 maj 2013 – ASC-11-0116 (Shkalla e Parë: Aktvendimi i datës 18 tetor 2011 – SCC-10-0207)

- 1 **Rrethanat faktike dhe procedurale:** Më 17 gusht 2010, paditësi parash-troi padi në DHPGJS, për njohjen e të drejtës së pronësisë dhe lëshimin e masës së përkohshme me të cilën është kërkuar të ndalohej shitja e dyqanit „K“ Shitorja nr. ..., që ndodhët në ngastrën kadastrale nr. ..., në Komunën e G. Për më tepër paditësi ka pohuar se ka punuar në NSH-në „K“ si menaxher i dyqanit prej vitit 1983 e deri më 1990, kur i njëjti është privatizuar nga Serbia. Pas vitit 1997 paditësi ka theksuar se e ka marrë me qira lokalin në fjalë dhe thekson se lokali është në pronën e Komunës së G. Paditësi ka pohuar se pas luftës ka ndërtuar objekt të ri në këtë pronë, me pëlqimin e UNMIK-ut dhe Komunës së G. me një kosto financiare prej ... €, duke e vazhduar biznesin e tij personal me emër „D“.
- 2 Më datë 17 shtator 2010, Trupi Gjykses i DHPGJS-së ka marr Aktvendim me të cilin e ka refuzuar kërkesën e paditësit për caktimin e masës së përkohshme duke arsyetuar që paditësi ka dështuar të ofrojë argumente bindëse në mbështetje të kërkesës së tij.
- 3 Trupi Gjykses i DHPGJS, me Aktvendimin e datës 18 tetor 2011, e ka hedhur poshtë padinë si të papranueshme, me arsyetimin se e paditu-

ra prej datës 15 maj 2006, me vendimin e Bordit të AKM-së i është nënshtruar procesit të Likuidimit vullnetar. AKP-ja në përgjigjen në padi ka kërkuar pezullimin e të gjitha procedurave në lidhje më të paditurën bazuar në nenin 9.3 të Ligjit për AKP-në2011.

Më datë 21 nëntor 2010, kundër Aktvendimit të ankimuar SCC-10-0207 të datës 18 tetor 2011 paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) ka ushtruar ankesë në DHPGJS, me propozimin që Kolegji i Apelit ta anuloj Aktvendimin e ankimuar dhe ta urdhëroj Kolegjin e Specializuar për të vazhduar procedurën, si alternativë ta pezullojë padinë e paditësit. 4

Ankuesi pretendon se Trupi Gjykes i DHPGJS gabimisht e ka hedhur poshtë padinë e paditësit pasi që sipas arsytimit të Aktvendimit të ankimuar Trupi Gjykes ka pohuar se NSH „K“ ishte në proces të likuidimit vullnetar, andaj do të duhej të hidhej poshtë si e pa pranueshme, dhe ky konstatim i Trupit Gjykes sipas ankuesit ishte i gabuar. 5

Më datë 6 korrik 2012, në përgjigje në ankesë e paditura e ka kundërshtuar në tërësi ankesën si të pa bazuar në ligj, pasi që ankuesi nuk ka arritur që të paraqes ndonjë bazë juridike të besueshme me të cilën ka mundur të konstatoj një gjendje tjetër faktike, prej asaj që ka vlerësuar Trupi Gjykes i DHPGJS dhe ka propozuar që të refuzohet ankesa e ankuesit si e pa bazuar dhe të vërtetoj Aktvendimin e ankimuar të Trupit Gjykes. 6

Me datë 21 gusht 2012, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përgjigjen në ankesë të paraqitur nga e paditura ia ka dorëzuar ankuesit për të dhënë përgjigje ndaj përgjigjes në ankesë. Urdhri ankuesi e ka pranuar më datë 22 gusht 2012, ndërsa nuk ka dhënë ndonjë kundërpërgjigje të më tejme. 7

Arsyetimi ligjor: Ankesa është e pranueshme dhe e bazuar. Bazuar në nenin 64.1 të Shtojcës LDHP, Kolegji i Apelit vendosi të përjashtoj pjesën gojore të procedurës. 8

Çështja kryesore në këtë lëndë është nëse gjykata duhej të pezullojë apo të hedhë poshtë edhe paditë pronësore – sipas nenit 9.3 të Rreg. së UNMIK-ut 2005/18 – kundër një NSH-je për shkak të nisjes së procedurës së likuidimit të NSH-së. Ankuesi ka pretenduar se Trupi Gjykes i DHPGJS-së në 9

mënyrë të gabuar e ka hedhur poshtë padinë e tij pronësore me arsyetimin se ndaj të paditurit ka filluar procedura e likuidimit.

10 Nuk kontestohet se AKP-ja më 23 gusht 2010 në parashtrësën me të cilën përgjigjet në kërkesën për masë të përkohshme, e njoftoi DHPGJS-në për procedurën e likuidimit të NSH “K” në G. me vendimin e Bordit të AKM-së, që nga data 15 maj 2006 ka shkuar në proces të likuidimit dhe bashkëngjiti dëshmi në bazë të nenit 9.3 të Rreg. UNMIK-ut 2005/18.

11 Neni 9.3 i Rreg. UNMIK-ut 2005/18 thotë:

Çfarëdo padie gjyqësore kundër ndërmarrjes, që i nënshtrohet likuidimit sipas këtij neni, pezullohet me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në gjykatën e vendit ku është paraqitur padia. Kërkesës së tillë i duhet bashkëngjitur:

(a) Çfarëdo padie gjyqësore kundër ndërmarrjes, që i nënshtrohet likuidimit sipas këtij neni, pezullohet me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në gjykatën e vendit ku është paraqitur padia. Kërkesës së tillë i duhet bashkëngjitur; [e saktë: Dëshmia për dorëzimin e njoftimit të përsërkruar në nenin 39.3 të Rregullores mbioraganizatat e biznesit (kur objekt i procedimit të likuidimit është korporata)];

(b) Dëshmia për publikimin e informatave të përfshira në atë njoftim, në një publikim kryesor në gjuhën shqipe, që ka tirazh të gjerë në Kosovë, një herë në javë për dy javë rresht dhe në një publikim kryesor në gjuhën serbe, në pajtim me kriteret që i cakton Bordi;

(c) Dëshmia për paraqitjen e Agjencisë në faqen e internetit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, nëse ekziston faqja e internetit në kohën e likuidimit dhe

d) Dëshmia për njoftimin e subjekteve për të cilat Agjencia beson ose ka arsye për të besuar se kanë pretendim ndaj ndërmarrjes përkatëse.

12 Sipas formulimit të nenit 9.3 të përmendur më lartë, likuidimi vullnetar i ndërmarrjes e parandalon parimisht çdo procedurë gjyqësore nga shkuarja më tej kur procedura e likuidimit është iniciuar. Qëllimi i likuidimit është që të sigurojë trajtim të barabartë (ligjor) të kreditorëve, të cilët nuk do të jenë në gjendje që ti ndjekin interesat e tyre individuale pa marrë parasysh më kreditorët e tjerë, në procedurë të rregullt civile. Në vend të procedurës para gjykatës kreditorët duhet të parashtrojnë paditë e tyre sipas nenit 30 të Rreg. UNMIK-ut 2005/48 në procedurën e likuidimit. Në bazë të nenit 35 të Rreg. UNMIK-ut 2005/48 Adminis-

tratori i NSH-së në likuidim konfirmon listën përfundimtare të padive dhe ia dorëzon atë gjykatës dhe Agjencisë.

Sipas dispozitave që kanë të bëjnë me procedurën e likuidimit (Rreg. UNMIK-ut 2001/6) komisioni për likuidimin e ndërmarrjes duket të ketë të drejtën që të shesë të gjitha asetet në emër të ndërmarrjes pa sqarim paraprak nëse ndërmarrja është pronare ligjore e aseteve specifike apo jo. Në fund të procedurës së likuidimit kreditori do të pranonte, në bazë të nenit 44 të Rreg. UNMIK-ut 2001/6 kuotën e shpërndarjes e cila do të përcaktohet sipas prioritetit të padive. Sipas nenit 44.1 (e) të Rreg. UNMIK-ut 2005/48 paditë pronësore radhiten shumë më prapa se sa shumica e padive tjera. Në bazë të nenit 10.5 të Rreg. UNMIK-ut 2008/4 pronari i ligjshëm i pronës e cila është shitur në procedurën e likuidimit nuk e ka të drejtën e ndonjë mjeti që do të kërkonte shfuqizimin e transaksionit të kryer apo anulimin e kontratës të lidhur në mënyrë valide me palën e tretë nga Agjencia në procedurën e likuidimit. **13**

Duke i zbatuar thjeshtë formulimet e dispozitave të cituara më lart, pronari i ligjshëm i çfarëdo prone që ende është e regjistruar në emër të NSH-së në likuidim dhe që do të shitet në procedurën e likuidimit të NSH-së, për shkak të pezullimit të padisë së tij pronësore apo hedhjes poshtë si të pa pranueshme, në fakt do të mund të humbte pasurinë dhe do të fitonte të drejtën vetëm të kompensimit që, me shumë gjasë, nuk do të përkonte me vlerën reale të pronës së tij apo në rastin më të keq, mund të mos merr kompensim fare, për shkak të prioritetit të ultë të padisë së tij. **14**

Në këtë kontekst lind pyetja përkatëse: a duhet të pezullohet apo të hedhet si e pa pranueshme edhe padia pronësore në të njëjtën mënyrë si paditë kreditore, apo një pezullim apo hedhje poshtë i tillë i padisë pronësore do të shkelte të drejtat themelore pronësore të pronarit të garantuara edhe me KEDNJ dhe Protokollin 1 të saj. Sido që të jetë, formulimi i nenit 9.3 të Rreg. UNMIK-ut 2005/18 është mjaft i përgjithshëm dhe, në parim, përmban të gjitha llojet e padisë. **15**

KEDNJ-ja [e saktë: GJEDNJ], në jurisprudencën e saj të pafund (d.m.th. Appl. 28342/95; *Brumărescu v. Rumania*, Appl. 33800/06 *Maria Atanasiu dhe të Tjerë v. Romania*, Appl. 27480/02 *Tarnawczyk v. Polonia*, Appl. 1355/04 *Dichev v. Bullgaria*, Appl. 16651/05 *Czajkowska të Tjerë v. Polonia*), ka përcaktuar më saktësisht përmbajtjen e të drejtave pronësore dhe **16**

kushtet për ndërhyrjen ligjore me ato të drejta. Kërkesat themelore për ligjshmërinë e çfarëdo privimi të posedimit apo pronësisë është se ndërhyrja të bazohet në ligj dhe të lejohet vetëm në interes të publikut apo për interes të përgjithshëm. Sipas jurisprudencës së KEDNJ-së [e saktë: GJEDNJ], kjo duhet të interpretohet në esencë dhe në tërësi nëse një shkelje e të drejtave në pronë është cenuar dhe paraqet një shpronësim de facto. Nëse çfarëdo mjete në esencë që është i barabartë me shpronësimin do të plotësonin kriteret e interesit publik apo të përgjithshëm, kompensimi i dhënë pronarit duhet të reflektojë vlerën e plotë të tregut të pronës, përveç në rrethana shumë të jashtëzakonshme. Sipas jurisprudencës së KEDNJ-së [e saktë: GJEDNJ], kriteret e ligjshmërisë e presupozojnë edhe se dispozitat e zbatueshme të ligjit vendor lidhur me shpronësimin janë mjaft të arritshme, precize dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre. Gjithashtu, kompensimi duhet të paguhet brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe pasiguria se kur do të paguhet pagesa paraqet gjithashtu shkelje të të drejtave pronësore.

- 17 Përfundimisht, dhe duke iu referuar precedentëve të DHPGJS-së [e saktë: Trupi Gjyqësor] dhe të Kolegjit të Ankesave (SCC-06-0010, ASC-10-0021 dhe ASC-[jo e plotë]0002) Kolegji i Ankesave konstaton se pezullimi apo hedhja poshtë e një padie pronësore kundër një NSH-je në likuidim në bazë të nenit 9.3 të Rreg. UNMIK-ut 2005/18 nuk do të përputhet me mbrojtjen e të drejtave pronësore sipas nenit 1, Protokollit 1, të KEDNJ dhe me jurisprudencën e themeluar të GJEDNJ, pasi që do të privonte paditësit të drejtat e tyre që të drejtat e tyre pronësore të gjykohen nga një gjykatë e pavarur. Që të pezullohet të shqyrtuarit e padisë pronësore të paditësit do të përbënte shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Në këtë aspekt nuk ka ndonjë dallim nëse padia ishte ushtruar para ose pas nisjes së procedurës së likuidimit. Për këtë arsye, Aktvendimi i Trupit Gjyqësor për të hedhur poshtë padinë si të papranueshme, duhet të anulohet dhe padia duhet të kthehet tek Kolegji përkatës i Specializuar për rigjykim. Kolegji përkatës i Specializuar do të vazhdojë procedurën dhe do të marrë çfarëdo mase të nevojshme për të sqaruar të drejtat pronësore të pretenduara.

Në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Shënim i Redaktorit: Ky Aktvendim zhvillon më tej jurisprudencën në lidhje me pezullimin e padive pronësore në ASC-10-0021.



5.

Mbi Ligjin e aplikueshëm dhe faza e avancuar procedurale

Ankesa e ushtruar pas afatit ligjor; Ligji i aplikueshëm; Fazë të avancuar procedurale; Papranueshmëri

Rreg. e UNMIK-ut 2008/4 neni 9.5; UA e UNMIK-ut 2008/6 neni 63.2, 28.2(d), 58.2, 67.1; Rreg. e UNMIK-ut 2002/13 neni 4.1(c)

Lënda ka arritur në një fazë më të avancuar procedurale në kuptim të nenit 14.1 të LDHP nëse nuk ka arritur në nivel të Apelit para hyrjes në fuqi të LDHP me datën 1 janar 2012 dhe në këtë mënyrë legjislacioni paraardhës i aplikueshëm në kohën e parashtrimit duhet të aplikohet për gjykim.

Aktvendimi i datës 20 qershor 2013 – AC-II.-12-0120, (shkalla e parë: Aktvendimi i datës 4 dhjetor 2008 i Gjykatës Komunale në M. – C.nr.149/07.

Rrethanat faktike dhe procedurale: Më 14 janar 2005, paditësi kishte parashtruar padi në DHPGJS, duke kërkuar që të vërtetohet se paditësi është pronar i parcelave kadastrale nr. ... dhe ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha sipas fletës poseduese nr. ... ZK L.. Paditësi pretendon se këtë paluajtshmëri e ka trashëguar nga paraardhësi i tij, derisa në vitin 1963 Komuna e M., me Aktvendimin nr. ... ia kishte marrë të drejtën e pronësisë, kur edhe është fshirë nga regjistri kadastral si pronar i këtyre pronave. Paditësi gjithashtu thekson se për këtë ka parashtruar ankesë dhe me Aktvendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësore Juridike të Komunës së S. nr. ... të datës 5 gusht 1969 është suprimuar Aktvendimi i mëparshëm si i kundërligjshëm. Megjithatë, nuk është bërë regjistrimi i kësaj prone në emër të paraardhësit të paditësit.

Më 25 nëntor 2005, DHPGJS kishte nxjerr Aktvendimin SCC-05-0010 me të cilin e kishte referuar lëndën për gjykim në Gjykatën Komunale të M.

1

2

- 3 Më 13 prill 2006, Gjykata Komunale në M. kishte marrë Aktgjykimin C.nr...., me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe ishte vërtetuar se paditësi është pronarë i ngastrave kadastrale nr. ... dhe ... në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha, sipas fletës poseduese nr. ... Z.K L. dhe detyrohet e paditura që ta pranoj këtë fakt, ndërsa detyrohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, KK M. që ta regjistroj në librat kadastral në emër të paditësit. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi kjo gjykatë thekson se me vendimin nr. ..., të datës 25 dhjetor 1963 nga e paditura e parë i është marrë paditësit paluajtshmëria kontestuese më 22 dhjetor 1967. Ndaj këtij vendimi ishte parashtruar mjeti i jashtëzakonshëm i goditjes, dhe sipas procesverbalit të shqyrtimit publik të datës 13 qershor 1969 të mbajtur në vendin e ngjarjes nga KK S., është anuluar Aktvendimi i parë me të cilin paditësi ishte shpallur uzurpues i kësaj paluajtshmërie. Ky shqyrtim ka rezultuar pozitivisht për paditësin, sepse me vendimin tjetër nr. ... të datës 15 gusht 1969, paditësit i është pranuar e drejta në pronësi mbi këtë paluajtshmëri, mirëpo ky vendim nuk është zbatuar asnjëherë nga organet përkatëse, andaj kjo paluajtshmëri ka mbetur në emër të të paditurit.
- 4 Edhe përfaqësuesi i Komunës së M., edhe përfaqësuesi i NSH-së, e kanë kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, edhe për faktin se kërkesëpadia është parashtruar.
- 5 Sipas mendimit të ekspertëve gjyqësor të angazhuar për këtë rast dhe historiatit kadastral, gjykata ka arritur në përfundim se ngastrat kadastrale kanë numrin kadastral ... në vendin e quajtur “B. i M.” në sipërfaqe prej ... ha dhe ngastra tjetër me nr. ... në vendin e quajtur “S. i M.” në sipërfaqe prej ... ha dhe që të dyja evidentohen në fletën poseduese nr. ..., Z.K L., në emër të të paditurës së parë. Gjykata gjithashtu ka konstatuar se e paditura e dytë nuk ka provuar gjatë procedurës se në çfarë baze juridike e mban këtë paluajtshmëri në emrin e vetë.
- 6 Më 12 qershor 2006 Kuvendi Komunal dhe më 13 qershor 2006 e paditura e dytë kishin parashtruar ankesë kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Komunale në M., në DHPGJS, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të të drejtës materiale.

- Më 1 shtator 2006, Gjykata Komunale në M. me Aktvendimin C.nr. ... e kishte bërë përmirësimin e Aktgjykimit të datës 13 prill 2006 në mënyrë që alineja 2 e dispozitivit ndryshohet, në vend të ngastrave kadastrale nr. ... dhe ... duhet të shënohet ngastra kadastrale nr.... dhe në vend të Fletës Poseduese nr. ... shënohet nr. **7**
- Më 6 maj 2007, DHPGJS me Aktvendimin SCA-06-006, i kishte miratuar ankesat si të bazuara ndërsa e kishte kthyer lëndën për rigjykim në Gjykatën Komunale të M. **8**
- Më 4 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në M. kishte marrë Aktgjykimin C.nr.... me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr. ... në sipërfaqe prej ... ha, sipas fletës poseduese ... Z.K L., dhe obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe pronë e Kuvendit Komunal M. që ta regjistroj pronën në emër të paditësit. **9**
- Edhe në arsyetimin e këtij Aktgjykimi nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor nga Aktgjykimi i parë i cili ishte anuluar nga DHPGJS. **10**
- Më 1 mars 2010 AKP kishte ushtruar ankesë kundër këtij Aktgjykimi të Gjykatës Komunale të M. Aktgjykimin e kundërshtuar AKP e kishte pranuar më 30 dhjetor 2009. Ajo thekson se Gjykata Komunale e M. nuk i ka përfillur sugjerimet e DHPGJS, që ka pasur obligim në procedurë të rigjykimit. Sipas AKP-së, Gjykata Komunale në rigjykim është dashur që të vërtetoj se a është përfillur deri në fund konflikti administrativ dhe si ka përfunduar. Kjo gjykatë nuk e ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike dhe se dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin dhe me provat e prezantuara. AKP thekson se paditësi nuk e ka kontestuar asnjëherë aktin administrativ me të cilin është bartur pronësia juridikisht te e paditura. **11**
- Më 26 korrik 2011, përfaqësuesi i paditësit kishte parashtruar përgjigje duke theksuar se AKP e ka parashtruar ankesën pas afatit ligjor andaj Kolegji i Ankesave duhet ta hedhë ankesën si të paafatshme. Ai thekson se afati i fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë 28 shkurt 2010 dhe pasi që dita e fundit është e diel, afati bie më 1 mars 2010, ndërsa AKP ka parashtruar ankesë më 2 mars 2010. **12**

- 13 Më tej paditësi në përgjigje mohon thëniet e AKP-së se paditësi nuk e ka kontestuar aktin administrativ mbi bartjen e pronës kontestuese. Sipas përfaqësuesit të paditësit, kjo është bërë [d.m.th ata e kanë kontestuar aktin administrativ] dhe me Vendimin nr. ... të datës 15 gusht 1969, kjo pronë iu ka kthyer paditësit, por nuk është regjistruar në librat kadastral.
- 14 **Arsyetimi Ligjor:** Më 31 gusht 2011, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi LDHP dhe Shtojcën e tij, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2012.
- 15 Sipas parimeve të përgjithshme juridike, ligjet dhe rregulloret procedurale të cilat janë në fuqi në kohën e gjykimit do të jenë të zbatueshme dhe do të shfrytëzohen – me kusht që legjislacioni i ri nuk parasheh dispozita devijuese për periudhën tranzitore. Në bazë të nenit 14.1 të LDHP-së, DHPGJS-ja mund të vazhdojë të zbatojë Rregulloren e vjetër dhe legjislacionin sekondar, nëse lënda e cila është në pritje pranë saj ka arritur
- një fazë të avancuar procedurale dhe gjykimi i drejtë i asaj lënde kërkon zbatim të vazhdueshëm të dispozitave të mëhershme procedurale të Rregullores së Dhomës së Posaçme apo të legjislacionit sekondar të lëshuar në pajtim me të.*
- 16 Paditësi e ka parashtruar padinë në DHPGJS më 14 janar 2005, ku korniza ligjore e zbatueshme ishte miratuar nga UNMIK-u. Sipas nenit 4.1(c), i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, DHPGJS-ja ka juridiksion për
- paditë, duke përfshirë paditë e kreditorëve ose paditë pronësore, të bërë kundër një ndërmarrje apo korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin administrues të Agjencisë, kur këto padi kanë lindur gjatë ose para se ndërmarrja apo korporata e tillë t'i jetë nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë.*
- 17 Në këtë lëndë, ankuesi[paditësi] i ka parashtruar padinë më 14 janar 2005, ndërsa ankesën më 1 mars 2010, dhe vërtet kjo procedurë ka aritur në
- një fazë të avancuar procedurale dhe gjykimi i drejtë i kësaj çështje kërkon zbatim të vazhdueshëm të dispozitave të mëhershme procedurale të Rregullores së Dhomës së Posaçme apo të legjislacionit sekondar të lëshuar në pajtim me të.*

Mu për këtë, Rregullorja e mëparshme [e UNMIK-ut] e DHPGJS dhe legjislacioni dytësor - duke përfshirë këtu edhe dispozitat që kanë të bëjnë me taksat gjyqësore - duhet të zbatohen në tërësi gjatë gjithë trajtimit të kësaj lëndë nga Kolegji i Ankesave.

Ankesa e AKP-së dhe vlerësimi nga Kolegji i Ankesave
Ankesa e AKP-së është e papranueshme.

18

Në bazë të nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave ka vendosur të refuzojë pjesën gojore të procedurës.

19

Kolegji i Ankesave, duke shqyrtuar këtë lëndë dhe sidomos afatshmerinë e ankesës të potencuar nga paditësi, konstatoi se ankesa është e paafatshme, andaj është hedhur si e papranueshme.

20

E paditura e kishte pranuar Aktgjykimin e kundërshtuar më 30 dhjetor 2009, ndërsa e kishte parashtruar ankesë[n] kundër këtij Aktgjykimi më 1 mars 2010, që do të thotë, 61 ditë pasi që e paditura e kishte pranuar Aktgjykimin e kundërshtuar. Në bazë të nenit 9.5 të Rreg. së UNMIK-ut 2008/4, i zbatueshëm në kohën e marrjes së Aktgjykimit të kundërshtuar dhe në kohën e parashtrimit të ankesës, “Brenda 30 ditësh nga marrja e Vendimit, pala mund të paraqes ankesë në Panelin e Apelit për rishqyrtim të Vendimit të tillë”.

21

Pasi që Aktgjykimi i kundërshtuar i është dërguar të paditurës më 30 dhjetor 2009, ndërsa ankesa është parashtruar më 1 mars 2010, kjo do të thotë se periudha prej 30 ditësh ka përfunduar më 30 janar 2010 dhe se ankesa është dorëzuar në DHPGJS pas afatit ligjor, konform Rreg. së UNMIK-ut 2008/4. (shih praktikën gjyqësore të DHPGJS-së në lëndët, ASC-09-0096, ASC-10-0012 etj.)

22

Edhe nëse UA i [e] UNMIK-ut [2008/6] [do] të zbatohet në rastin konkret, ankesa do të ishte e paafatshme, sepse afati kohor prej dy muaj ditësh deri në parashtrimin e ankesës, tashmë kishte kaluar.

23

Si rezultat i kësaj, ankesa e pasafatshme duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, në bazë të nenit 28.2(d), 58.2 [UA e UNMIK-ut 2008/6] lidhur me 67.1 të UA të UNMIK-ut 2008/6.

24

Shënim i Redaktorit: Ky Aktgjykim zhvillon më tej jurisprudencën në lidhje me zbatueshmërinë e legjislacionit paraardhës në kuptim të nenit 14.1 të LDHP. Ankuesi e ka kundërshtuar Aktvendimin e Kolegjit të Apelit në Gjykatën Kushtetuese, e cila e ka deklaruar atë si të papranueshme dhe ka refuzuar kërkesën për masë të përkohshme (Aktvendimi i datës 8 maj 2014 – Lënda nr. KI145/13).



6.

Juridiksioni i DHPGJS nëse Organi Publik Shtetëror është një ose i vetmi i paditur

Juridiksioni; Kompetenca; Komuna; neni 5.2 i LDHP-së

LDHP neni 4, 5, 5.2.2.2, 5.2.2.5, 10.9, 10.10; Shtojca e LDHP neni 60.2, 28.2.2.1, 28.2.2.3, 64.1, Reg. e UNMIK-ut 2008/4; UA e UNMIK-ut 2008/6

1. Nëse komuna është e vetmja e paditur në lëndën në fjalë, atëherë DHPGJS-ja nuk ka juridiksion.
2. Komuna vetëm mund të shtohet si e paditur, nëse tashmë ka të tillë, në lëndën në pritje pranë DHPGJS-së, të paditur që bie në nenin 5.2 të LDHP-së.

Aktvendimi i datës 19 shtator 2013 – AC-I.-12-0040 (Shkalla e parë: Aktvendimi i datës 1 qershor 2012 – SR-11-0087)

Rrethanat faktike dhe procedurale: Më 20 dhjetor 2010, paditësi e parashtroi një padi për masë të përkohshme pranë Gjykatës Komonale të D., duke kërkuar mbrojtjen e të drejtave të posedimit lidhur me ngas-trat kadastrale të përshkruara në Aktvendimin e Komunës së P., ...nr. ... të datës 20 maj 1960. Paditësja, NSH-ja pohon se e paditura me Aktvendimin e saj, ..., nr. ... të datës 27 gusht 2009, e anuloi Aktvendimin e mëhershëm të datës 20 maj 1960, dhe që në këtë mënyrë e tërë prona e kontestuar i ishte rikthyer Komunës. AKP-ja filloi procedurën gjyqësore në Gjykatën Komonale duke kërkuar anulimin e Aktvendimit të kontestuar, ..., nr. ... të datës 27 gusht 2009.

Gjykata Komonale e D. në Aktvendimit C.nr. ... të datës 4 maj 2011, e shpalli vetën jo kompetente në këtë çështje duke e zbatuar nenin 4 të LDHP dhe vendosi që gjykata kompetente është DHPGJS-ja dhe e referoi lëndën tek ajo.

- 3 Më 1 qershor 2012, Kolegji i Specializuar vendosi që DHPGJS nuk ka juridiksion që të merret me padinë sepse e paditura është organ publik shtetëror dhe se DHPGJS-ja nuk ka juridiksion për padinë në pajtim me nenin 28.2.2.1 dhe 28.2.2.3 të Shtojcës së LDHP lidhur me nenin 5.2 të LDHP-së.
- 4 Më 19 qershor 2012, paditësja (tash e tutje: Ankuesja) parashtrroi një ankesë ndaj Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar duke kërkuar nga DHPGJS-ja që ta lejojë ankesën, duke e prishur Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar dhe duke kërkuar rigjykimin nga ana e Kolegjit të Specializuar.
- 5 Më 11 korrik 2012, Kolegji i Apelit e urdhëroi paditësen që ta paraqesë një kopje të Aktvendimit ndaj të cilit është ushtruar ankesa dhe të vërtetojë se ankesa është dërguar tek e paditura. Urdhri është përmbushur.
- 6 **Arsyetimi ligjor:** Ankesa është e pabazuar. Kolegji i Apelit vendosi që të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës bazuar në nenin 64.1 të Shtojcës së LDHP dhe të mos e dërgojë ankesën tek e paditura në pajtim me nenin 10.9 të LDHP dhe nenin 60.2 të Shtojcës së LDHP.
- 7 Nenet 4 dhe 5 të LDHP përcaktojnë së kush mund të jetë palë në procedurë gjyqësore pranë DHPGJS-së. I paditur, në bazë të nenit 5.2.2.2 të LDHP-së, është sipas zgjedhjes së Agjencisë ose Ndërmarrjes që është nën administrimin e Agjencisë apo Agjencia që vepron në emër të Ndërmarrjes në fjalë.
- 8 DHPGJS-ja mund të shtojë si të paditur secilin person që ajo e sheh të domosdoshëm apo të përshtatshëm për të siguruar gjykimin e plotë dhe të saktë të secilës lëndë apo çështje pranë saj (neni 5.2.2.5 i LDHP-së). Një bashkim i tillë i palës presupozon një lëndë apo çështje në pritje tashmë pranë DHPGJS-së.
- 9 Andaj, Komuna mund vetëm të shtohet si e paditur nëse veçse është, në lëndën në pritje pranë DHPGJS-së, e paditura(at) që bie në nenin 5.2 të LDHP-së. DHPGJS-ja nuk ka juridiksion mbi padinë ku Komuna është e vetmja e paditur në lëndë.

- E vetmja e paditur në rastin në fjalë është Komuna dhe DHPGJS-ja nuk ka juridiksion. **10**
- Procedura gjyqësore fillimisht ishte sipas Rreg. së UNMIK-ut nr. 2008/4 dhe UA të UNMIK-ut nr. 2008/6; megjithatë, LDHP-ja hyri në fuqi më 1 janar 2012, i cili e ndryshoi juridiksionin e DHPGJS-së. Juridiksioni i DHPGJS-së është i përcaktuar në mënyrë të duhur në LDHP dhe Shtojcën e tij. **11**
- Prandaj, Kolegji i Apelit do t'i dërgojë shkresat e lëndës në Gjykatën Themelore në D., e cila është gjykata kompetente. **12**
- Andaj, Kolegji i Apelit në bazë të nenit 10.10 të LDHP e ka marrë Aktvendimin si në dispozitiv. **13**



Kriteret e pranueshmërisë: Mos kontestimi i pretendimeve nuk shpie në papranueshmëri

Qasja në gjykatë; Faktet e kontestuara dhe të pakontestuara; KED-NJ neni 6; Papranueshmëria; Njoftimi për qëllimin e parashtrimit të padisë.

Rreg. e UNMIK-ut 2002/12 neni 29.1, 29.3; UA e UNMIK-ut 2008/6 neni 28.3, 28.2, 28.2(e)

1. Nëse paditësi pohon se ai e ka njoftuar Agjencinë lidhur me qëllimin për të parashtruar padi dhe Agjencia nuk e ka kundërshtuar atë, atëherë padia nuk mund të hedhet poshtë si e papranueshme.
2. Detyra e ankuesit për ta njoftuar Agjencinë paraprakisht shton një barrë shtesë për të për sa i përket qasjes së tij në gjykatë dhe një dispozitë e tillë duhet të interpretohet në një mënyrë të kufizuar.

Aktvendimi i datës 31 tetor 2013 – ASC-10-0064 (Shkalla e parë: Aktvendimi i datës 26 gusht 2010 – SCC-09-0015)

- 1 **Rrethanat faktike dhe procedurale:** Më 20 prill 2010, gjyqtari i vetëm i Trupit Gjykses i DHPGJS-së refuzoi padinë e paditësve si të papranueshme me anë të Aktvendimit SCC-09-0015, duke argumentuar se paditësja kishte njoftuar Agjencinë vetëm pas parashtrimit të padisë, duke mos vepruar në pajtim me nenin 29.1 të Rreg. së UNMIK-ut 2002/12 e në lidhje me nenin 28.3 dhe 28.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6.
- 2 Më 17 shtator 2010, paditësja (më tej: ankuesja) parashtroi pranë DHPGJS-së një ankesë (të emëruar si kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme) - vetëm në gjuhën shqipe - kundër Aktvendimit SCC-09-0015 të Trupit Gjykses. Me anë të [Akt]vendimit të gjyqtarit kryesues të

Trupit Gjykses, të datës 22 mars 2010, ishte pranuar kërkesa e ankueses për ndihmë në përkthim dhe lirim nga taksat gjyqësore. Kolegji i Apelit sipas detyrës zyrtare kishte urdhëruar përkthimin e parashtrës.

Ankuesja në parashtrësën [e saj] kishte kërkuar kthim në gjendjen e mëparshme (më tej: ankesa) sepse gabimisht kishte konsideruar që afati kohor për ankesë kishte kaluar pasi që ajo e kishte pranuar Aktvendimin e Trupit Gjykses nga përfaqësuesi i saj më 7 shtator 2010. Kolegji i Apelit ka konstatuar, në bazë të njoftimit për pranimin e Aktvendimit të Trupit Gjykses që gjendet në shkresat e lëndës, se Aktvendimi, që është objekt i kësaj ankesë, ishte pranuar nga përfaqësuesi i ankueses, *BE*, më 7 shtator 2010. Ankuesja deklaroi se ajo kishte për qëllim të njoftonte Agjencinë, dhe kishte njoftuar Agjencinë pasi që ishte parashtruar padia, duke plotësuar kështu kushtin ligjor të caktuar në nenin 29.3 të Rreg. së UNMIK-ut 2001/12. Ajo kishte kërkuar nga Kolegji i Apelit, që të pranojë ankesën si të bazuar dhe të prish Aktvendimin e Trupit Gjykses SCC-09-0015 të datës 26 gusht 2010. 3

Më 2 nëntor 2011, Kolegji i Apelit lëshoi një urdhër për sqarim duke kërkuar nga ankuesja që të sqarojë se kush është duke e përfaqësuar ankuesen, avokati *BE* (përfaqësues pranë procedurave gjyqësore të Trupit Gjykses) apo *ML*, dëshmi me shkrim për heqjen e autorizimit nga avokati *BE* dhe një kopje të vërtetuar të autorizimit, duke i dhënë përfaqësuesit autorizimin për ta përfaqësuar ankuesen pranë DHPGJS dhe dëshmi me shkrim që *ML* është anëtar i regjistruar i Odës së Avokatëve. 4

Urdhri i Kolegjit të Apelit ishte dërguar tek ankuesja më 4 nëntor 2011. Ankuesja në kohë kishte informuar Kolegjin e Apelit se ajo kishte hequr autorizimin nga përfaqësuesi i saj *BE* dhe *ML* dhe se ajo i kishte dhënë autorizimin për ta përfaqësuar atë avokatit *NU*. 5

NU më 30 nëntor 2011 ishte urdhëruar që të parashtrojë një deklaratë duke vërtetuar se ai kishte konfirmuar dhe ratifikuar përmbajtjen e ankesës origjinale të parashtruar më 17 shtator 2010 si dhe të dokumenteve përcjellëse. 6

Urdhri i ishte dërguar *NU* më 16 dhjetor 2011. Me anë të një urdhri të datës 12 dhjetor 2011 Kolegji i Apelit lejoji *NU* që të bëjë ekzaminimin e shkresave të lëndës. 7

- 8 **Arsyetimi Ligjor:** Ankesa është e pranueshme edhe e bazuar. Kolegji i Ankesave ka vendosur në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP që të mos vazhdojë me pjesën gojore të procedurës gjyqësore dhe në pajtim me nenin 10.9 të LDHP-së dhe nenit 60.2 të Shtojcës së LDHP që të mos i dërgojë ankesën për përgjigje të paditurit.

Njoftimi i Agjencisë

- 9 Ashtu siç është sqaruar nga e drejta precedente e Kolegjit të Apelit (shih ASC-09-0072, ASC-10-0050, etj.) njoftimi që është bërë në Agjenci në lidhje me qëllimin për të parashtruar një padi, që është një ndër kriteret e pranueshmërisë, ashtu siç është përcaktuar në nenin 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Edhe pse kriteri i pranueshmërisë duhet të shqyrtohet ex officio në një fazë të mëhershme të procedurës gjyqësore, pa qenë i përfshirë i padituri akoma, argumenti i vetëm i paditësit në lidhje me atë se ka parashtruar një njoftim adekuat në kohë është i mjaftueshëm, pasi që është në zgjedhjen e të paditurit që të mos kontestojë faktet ashtu siç është deklaruar nga paditësja, duke përfshirë edhe çështjen e njoftimit. Prandaj, nëse një paditës deklaron se është parashtruar një njoftim adekuat, Trupi Gjyqësor nuk mund të hedh poshtë padinë si të papranueshme, bazuar në mungesën e dëshmisë për një njoftim të tillë. Vetëm nëse padia është e papranueshme mbi baza të tjera, atëherë të paditurit duhet t'i jepet mundësia që të mbajë qëndrim në lidhje me njoftimin e pretenduar, së bashku me meritat e lëndës, duke i dërguar padinë dhe dokumentet e tjera të paditurit. Të paditurit i takon që të kontestojë faktet ashtu siç janë deklaruar në padi, duke përfshirë edhe çështjen e kohës së njoftimit. Vetëm nëse një i paditur, i përfaqësuar nga Agjencia, konteston kohën e njoftimit, atëherë paditësi duhet të dëshmojë në lidhje me njoftimin.

- 10 Për lëndën në fjalë i padituri nuk është në gjendje që të kontestojë njoftimin. Më 18 shkurt 2009, ankuesja parashtroi një padi pranë Trupit Gjyqësor të DHPGJS-së. në pajtim me dokumentet e parashtruar, Agjencia është njoftuar në lidhje me padinë e ankueses më 3 qershor 2009, që është gati 4 (katër) muaj pasi që ankuesja ka parashtruar padinë pranë DHPGJS-së. Prandaj, ankuesja ka vepruar në pajtim me nenin 29.1 të Rreg. së UNMIK-ut 2002/12 dhe nenin 28.2 (e) dhe 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Nën këto rrethana nuk ka lindur nevoja e mëtutjeshme për përfshirjen e të paditurit.

Megjithatë, është evidente se prej datës 3 qershor 2009, AKP-ja ka qenë në dijeni në lidhje me padinë dhe nuk ka zgjedhur që të përfshihet në procedurat gjyqësore si përfaqësuese e të paditurit. Duke pasur në mendje se qëllimi i dispozitës në lidhje me njoftimin është që Agjencia të informohet në lidhje me paditë e mundshme dhe t'u jepet atyre mundësia që të veprojnë në emër të NSH-së, ai qëllim është plotësuar në mënyrë të dukshme. Si shtesë, duhet të merret parasysh se detyra e ankueses për të njoftuar Agjencinë paraprakisht e rrit barrën e saj për të pasur qasje në drejtësi dhe dispozita në lidhje me kriteret duhet të interpretohet në një mënyrë të kufizuar. Nëse Kolegji i Apelit e konsideron njoftimin si të paafatshëm, një gjë e tillë nuk do të ketë ndonjë ndikim në gjykimin e padisë.

11

Prandaj, hedhja poshtë e padisë si e papranueshme nuk ka qenë e saktë. Aktvendimi i ankimuar nuk mund të qëndrojë dhe si i tillë duhet të priset. Kolegji i Specializuar do ta gjykojë padinë, duke mos hedhur poshtë padinë mbi bazën e njëjtë.

12

Shënim i Redaktorit: Ky Aktvendim më tej zhvillon jurisprudencën lidhur me kriteret e pranueshmërisë, ASC-09-0072, ASC-10-0023 dhe ASC-10-0050.



8.

Papranueshmëria e veprimeve të mëtejme ligjore kundër Aktvendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS

Aktvendimi i Kolegjit të Apelit; Neni 10.14 i LDHP-së; Papranueshmëria; Mjeti i jashtëzakonshëm juridik; Mbrojtja e ligjshmërisë; Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

Shtojca e LDHP neni 64.1; LDHP neni 10.14; Reg e UNMIK-ut 2008/4 neni 10.10; UA e UNMIK-ut 2008/6

As mjete i jashtëzakonshëm juridik as ankesa nuk mund të parashtrohen ndaj një Aktvendimi të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

Aktvendimi i datës 31 tetor 2013 – AC-I-13-0094 (Lënda A: Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në P., Aktvendimi i datës 19 korrik 2007 – C.nr.1738/2007, Lënda B: Aktgjykimi i datës 27 dhjetor 2011 – SCA-08-0041, Lënda C: Aktgjykimi i datës 30 prill 2013 – AC-I-12-0055)

- 1 **Rrethanat faktike dhe procedurale:** Më 9 gusht 2013, Prokurori i Shtetit ka parashtruar tek Kolegji i Apelit kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke konsideruar se në Aktgjykimet, e përmendura më lartë nën A, B dhe C, për këtë çështje ligjore, është bërë shkelje e dispozitave ligjore.
- 2 Prokurori i shtetit nxjerr përfundim se Aktgjykimet/Aktvendimet në fjalë duhet të anulohen dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim tek Trupi Gjykses përkatës i DHPGJS-së.
- 3 **Arsyetimi ligjor:** Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga Prokurori i Shtetit është e papranueshme.
- 4 Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit konsideron se në bazë të nenit 10.14, të LDHP, të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të pre-ra dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër. Gjithashtu, LDHP-ja dhe Shtojca e vet nuk parashih ndonjë mjet të jashtëzakonshëm kundër Aktvendimeve apo Aktgjykimëve të tilla të Kolegjit të Apelit (mjete i tillë i jashtëzakonshëm nuk parashihet as me Rreg. e UNMIK-ut 2008/4 e as me UA të UNMIK-ut 2008/6).

Kolegji i Apelit konstaton se lëndët në fjalë, të përmendura më lartë nën A, B dhe C, tanimë janë vendosur dhe të gjitha mjetet juridike janë shteruar pas Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të datës 30 prill 2013 i cili u bë i formës së prerë në të njëjtën ditë. Prandaj, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si një mjet i jashtëzakonshëm, nuk mund të zbatohet kundër Aktvendimeve të tilla, kështu që si e tillë, ajo hedhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të argumenteve të përmendura më lartë dhe në pajtim me nenit 10.10 të LDHP-së, Kolegji i Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e dorëzuar nga Prokurori i Shtetit në bazë të dispozitave të LPK në emër të njëjës palë, mund të aplikojë për këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik kundër Aktvendimeve të formës së prerë të Gjykatave të shkallëve më të ulëta, por jo kundër një Aktvendimi të formës së prerë të Kolegjit të Apelit të DH-PGJS-së sepse, siç u përmend më lartë, neni 10.14 i LDHP-së e ndalon një mundësi të tillë.

⌋⌋⌋

9.

Ankesat Kundër Aktvendimeve të Plotfuqishme janë të papranueshme

Ankesa; Aktvendim i formës së prerë; Heqja dorë nga e drejta e ankesës; Çështje e gjykuar (res judicata); Ankesa e papranueshme

LPK neni 176, 186; Shtojca e LDHP neni 10.6, 10.7

“Ankesat” e ushtruara kundër Aktvendimeve të plotfuqishme janë të papranueshme.

Aktvendimi i datës 19 dhjetor 2013 – AC-II.-12-0053 (shkalla e parë: Aktvendimi i datës 14 shkurt 2008 i Gjykatës Komunale në M./M - N.nr.13/2008)

- 1 **Rrethanat faktike dhe procedurale:** Me Aktvendimin e kundërshtuar të Gjykatës Komunale të M. N.nr.... të datës 14 shkurt 2008, sipas propozimit të paditësit, të njëjtit i është njohur e drejta për blerje të banesës e cila gjendet në ish-rr. “M T” nr. ..., hyrja ..., kati ..., në sipërfaqe të tërësishe prej ... m2. Ky Aktvendim, sipas gjykatës, e zëvendëson kontratën për blerjen e banesës dhe paraqet bazë për fitimin e pronësisë.
- 2 Paraprakisht, paditësi e kishte lidhur kontratën me Organizatën Punuese për qarkullim me material ndërtimor “D”- P., OBPB, “Sb”- M., si dhënëse e banesës në shfrytëzim.
- 3 Në seancën gjyqësore të mbajtur më 14 shkurt 2008, i autorizuari i të paditurit nuk e ka kundërshtuar propozimin e paditësit as gjatë administrimit të provave e as në fjalën përfundimtare të tij.
- 4 Meqenëse nuk kishte kundërshtim të të paditurit, gjykata e nxorri Aktvendimin e kundërshtuar dhe në një klauzolë në vend të këshillës juridike kishte shënuar, “Ky Aktvendim është i plotfuqishëm, duke filluar nga data e 14 shkurt 2008, pasi që palët hoqën dorë nga e drejta e ankesës”.

- Më 28 mars 2012, AKP kishte parashtruar ankesë kundër këtij Aktvendimi të formës së prerë, duke mos ofruar asnjë provë se kur është njoftuar AKP lidhur me Aktvendimin e kundërshtuar. **5**
- Në përgjigje të urdhrit të Kolegjit të Ankesave, AKP ka pohuar se Zyra Regjionale e AKP-së në M. është njoftuar me këtë Aktvendim më 19 mars 2012 dhe ka afruar një komunikim me email ndërmjet një personi të quajtur *M H*, përfaqësues i AKP-së dhe *H B*, “shefe e kadas-trit”. **6**
- Arsyetimi Ligjor:** Ankesa e AKP-së është e papranueshme. **7**
- Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit ka vendosur që të mos vazhdojë me pjesën gojore të procedurës gjyqësore. **8**
- Aktvendimi i Gjykatës Komunale të M. N.nr. ..., i datës 14 shkurt 2008 ka marrë formën e prerë, në të njëjtën datë kur edhe është nxjerr. Në vend të këshillës juridike gjykata kishte shënuar klauzolën e plotfuqishmërisë në të cilën thuhej: “Ky Aktvendim është i plotfuqishëm, duke filluar nga data e 14 shkurt 2008, pasi që palët hoqën dorë nga e drejta e ankesës. **9**
- Sipas nenit 177.2, të LPK-së,
deri në momentin e dbënies së vendimit të gjykatës së shkallës së dytë, pala mund ta tërheq ankesën e paraqitur.
[redaktori: ankuesi mund ta tërheq ankesën e tij apo saj para se gjykata e shkallës së dytë të marrë Aktgjykim.] **10**
- Përfaqësuesi me autorizim i palës së paditur nuk e ka mohuar asnjëherë kërkesëpadinë gjatë seancës gjyqësore në shkallë të parë, andaj edhe e ka shfrytëzuar të drejtën ligjore për të hequr dorë nga ankesa. **11**
- Ankesa e AKP-së është bërë kundër një vendimi të formës së prerë (çështje e gjykuar), prandaj si e tillë duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. **12**
- Kolegji i Ankesave ia tërheq vërejtjen AKP-së se përdorimi i mjetit të goditjes- “Ankesës”, edhe kundër vendimeve të formës së prerë (res judicata) **13**

është e qartë se është në kundërshtim me ligjin dhe përfaqëson shpërdorim të të drejtave procedurale të palës, që gjithsesi shkakton vonesa dhe zvarritje të panevojshme të procedurës. Andaj poqëse AKP-ja vazhdon edhe më tutje që në kundërshtim me mirëbesimin dhe ndërgjegjen, ti shpërdoron të drejtat procedurale që i janë njohur me ligj, të zvarrit pa nevojë procesin gjyqësor dhe të dëmtoj të tjerët, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së do të aplikoj dënim me të holla, ose edhe masa të tjera ligjore, konform nenit 10.2 të LPK.

- 14 Gjithashtu, i tërhiqet vërejtja AKP-së se referimi që i bëhet në vazhdimësi një Aktvendimi të DHPGJS, SCA-07-0030, të datës 20 nëntor 2007, nuk është i duhur dhe se ai Aktvendim nuk përfaqëson jurisprudencën e Kolegjit të Apelit, andaj shkeljet procedurale nuk mund të arsyetohen duke iu referuar këtij Aktvendimi të paapelueshëm.

Shënim i redaktorit: Ky Aktvendim shfuqizon Aktvendimin SCA-07-0030 të datës 20 nëntor 2007.

⌚⌚⌚

Neni 70.4 i Shtojcës së LDHP përmban një listë shteruese të veprimeve dhe nuk lejon ta dërgoj lëndën prapa tek Autoriteti i Likuidimit për të ri-ushtuar diskrecionin

Veprime shteruese; Ligji i aplikueshëm; Kundërshtimi i Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit

Ligji mbi Punën e Bashkuar neni 608; Shtojca e LDHP neni 70.4, 70.2

1. Në procedura kundër ankesave të vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, neni 70.4 të Shtojcës së LDHP përmban listë shteruese të veprimeve – për të ‘vërtetuar’, ‘revokuar’, apo ‘ndryshuar’ – Aktvendimin e kundërshtuar – për t’u ndërmarë nga ana e Gjykatës.
2. Neni 70.4 i Shtojcës së LDHP nuk e autorizon Gjykatën për t’ia referuar lëndën prapa tek Autoriteti i Likuidimit për të ri-ushtuar zgjedhjen administrative. Gjykata duhet të vendosë vet mbi meritat e ankesës dhe të vendosë lidhur me padinë në fjalë.

Aktvendimi i datës 20 shkurt 2014 – AC-I.-13-0233 (shkalla e parë: Aktgjykimi i datës 12 nëntor 2013 – C-IV.-12-0039.)

Rrethanat faktike dhe procedurale: Më 4 dhjetor 2013, e paditura (ankuesja) kishte parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-IV-12-0039, të datës 12 nëntor 2013, duke e kundërshtuar atë si jo i drejtë dhe të pa bazuar. Sipas ankuesit, vendimi i Autoritetit të Likuidimit nuk është i paqartë, dhe se me Aktgjykimin e kundërshtuar është shkel[ur] neni 70.4 të Shtojcës së LDHP dhe se rasti nuk është e lejuar në bazë të ligjit që të kthehet tek Autoriteti i Likuidimit për rivendosje [ri-ushtimin e zgjedhjes administrative].

- 2 Me Aktgjykimin e kundërshtuar, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e kishte shfuqizuar Aktvendimin e Autoritetit të Likuidimit për të cilin thuhej se është i paqartë dhe konfuz, sa i përket dispozitivit dhe arsyetimit. Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompenzimin e pagave të papaguara, me arsyetimin se kërkesa ishte parashkuar dhe se nuk kishte bashkangjitur asnjë provë për të dokumentuar se ai ishte ankuar kundër vendimit për largimin e tij nga puna.
- 3 Më 23 dhjetor 2013, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së e kishte dërguar ankesën për përgjigje tek paditësi.
- 4 Më 3 shkurt 2013 paditësi në përgjigjen e vetë thekson se ankesa e AKP-së është e pabazuar, sepse ajo përmban të njëjtat çështje të theksuar në vendimin e atakuar. Paditësi thekson se refuzimi i AKP-së bazohet gjithnjë në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, se kinse paditësi nuk ka parashtruar asnjë provë se është kundërshtuar vendimi për largimin e tij nga puna dhe se na qenka parashkuar kërkesa.
- 5 Paditësi ka parashtruar edhe një herë së bashku me përgjigjen edhe padinë e parashtruar më 10 korrik 1992, me të cilën kishte kundërshtuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ai pretendon se i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike me rastin e largimit të tij nga puna.
- 6 **Arsyetimi Ligjor:** Ankesa është e bazuar
- 7 Bazuar në nenin 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vendosi që të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës.
- 8 Kolegji i Ankesave konsideron se asnjë dispozitë e ligjit të aplikueshëm në DHPGJS nuk determinon mundësinë e dërgimit në rivendosje [e saktë: ri-ushtrimin e zgjedhjes administrative] (te Autoriteti i Likuidimit) të çështjeve që duhet të gjykohen sipas ankesave të palëve ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.
- 9 Me Aktgjykimin e kundërshtuar, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së kishte vendosur që ta kthej lëndën në rivendosje [ri-ushtrimin e zgjedhjes administrative] tek Autoriteti i Likuidimit, pa e mbështetur këtë vendim në asnjë dispozitë ligjore.

Procedurën lidhur me ankesat ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit e rregullon neni 70 i Shtojcës së LDHP. Paragrafi 4 i këtij neni është një dispozitë shteruese [e saktë: dispozitë me një listë shteruese], e cila nuk i jep asnjë mundësi tjetër gjykatës, pos, “vërtetimit, shfuqizimit dhe ndryshimit të vendimit të Autoritetit të Likuidimit”. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e ka shfuqizuar vendimin e një organi administrativ (Komisionit [Autoritetit] të Likuidimit), me arsyetimin se ai vendim ka qenë i “pa qartë dhe kontradiktor”. Në këtë rast, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së është dashur të vendos në merita të ankesës, e jo ta kthej “në rivendosje” [ri-ushttrimin e zgjedhjes administrative]. Kthimi në rivendosje [ri-ushttrimin e zgjedhjes administrative] nga ana e Gjykatës, një organi administrativ nuk është kërkesë e nenit 70.4 të Shtojcës së LDHP. Çështja e kontestuar nuk është një çështje administrative që duhet të zgjidhet në bazë të ligjit për konflikte administrative, në bazë të cilit ligj Gjykata, ka mundësi pos tjerash edhe ta kthen në rishqyrtim [ri-ushttrimin e zgjedhjes administrative], tek organi administrativ. Kjo çështje është çështje lëndore e juridiksionit të DHPGJS, dhe kjo çështje fillimisht zgjidhet në rrugë administrative në procedurë administrative nga Komisioni [Autoriteti] i Likuidimit të AKP-së, e pastaj kur shterohen mjetet e palës në procedurë administrative, në bazë të nenit 70.2 të Shtojcës së LDHP hapet procedura gjyqësore në Kolegjin e Specializuar për likuidime pranë DHPGJS-së. Kolegji duhet të merr vendim për ‘vërtetim’, ‘shfuqizim’, apo ‘ndryshim’ të vendimit të kundërshtuar. Kjo dispozitë ligjore për shkak të natyrës specifike të çështjes nuk i jep autoritetin Gjykatës që çështjen ta kthen prapë tek organi administrativ, siç ndodh te konfliktet administrative, por duhet të vendos vet në meritat e ankesës dhe ta zgjedhë çështjen e kërkesës së ngritur.

Për këtë arsye, por edhe arsye tjera procedurale në vendimarrjen e Kolegjit të Specializuar (një çështje krejtësisht procedurale ka vendosur me Aktgjykim) “Aktgjykimi” i kundërshtuar, nuk mund të qëndroj si i tillë, andaj duhet të anulohet dhe lënda duhet të kthehet në rigjykim [tek Kolegji i Specializuar].

Kolegji i Specializuar duhet që në rigjykim të vendos në merita të ankesës, duke kërkuar nga palët precizimin dhe qartësimin e çështjeve të cilat Kolegji i Specializuar i ka pasur të pa qarta.



11.

Juridiksioni i Gjykatës Komunale (tani Gjykatës Themelore) pas hyrjes në fuqi të LDHP

Lëndë e referuar; Juridiksioni i Gjykatës Komunale (tani Gjykata Themelore); Dërgimi në rigjykim.

LDHP neni 10.9, 4.4(i); Shtojca e LDHP neni 60.2

Nëse gjykata të cilës iu është referuar lënda pas hyrjes në fuqi të LDHP, nuk ka ndërmarrë kurrfarë vendimi substantiv (me vendim substantiv do të kuptohet caktimi i seancës kryesore) lidhur me çështjen, një gjykatë e tillë nuk ka më tutje juridiksion dhe se lëndën duhet t'ia bartë DHPGJS-së.

Aktvendimi i datës 27 shkurt 2014 – AC-II-12-0169 (Shkalla e parë: Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në M. i datës 21 maj 2012 – C.nr.278/06)

- 1 **Rrethanat procedurale dhe faktike:** Më 19 korrik 2006, paditësi parashtrroi padi në DHPGJS me të cilën kërkoi të drejtat pronësore mbi ngastrën kadastrale numër ... në sipërfaqe prej ... ha “A. e B.”, ngastrën kadastrale numër ... tek “F.” në sipërfaqe prej ... ha, ngastrën kadastrale numër ... tek “S.” në sipërfaqe prej ... ha, ngastrën kadastrale numër ... tek “S” në sipërfaqe prej ... ha dhe ngastrën kadastrale numër ... tek “S.” në sipërfaqe prej ... ha, secila prej ngastrave kadastrale të përmendura të regjistruara sipas fletës poseduese numër....
- 2 DHPGJS-ja, me Aktvendimin SCC-06-0334, të datës 10 tetor 2006, e referoi padinë në Gjykatën Komunale të M. me të drejtë ankese në DHPGJS.
- 3 Më 29 mars 2007, grupi i parë i ndërhyrësve, *J M, H M, N M, Z M* dhe *Sh M*, secili i përfaqësuar nga avokati *A M*, paraqitën kërkesë pranë Gjykatës Komunale për bashkim të lëndës pasi që kishin interes [të përbashkët] pronësor dhe ligjor në padinë e paditësit.

- Më 7 nëntor 2009, paditësi dorëzoi një plotësim të padisë dhe kërkoi të shtojë si të paditur në padi *M R M, Z O M, V M, Sa M, H M* dhe *N M*. 4
- Më 21 maj 2012, Gjykata Komunale e M. në Aktgjykimin C. nr. ..., ia njohu të drejtën pronësore të paditësit mbi ngastrat kadastrale nr. ... në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha dhe ngastrën kadastrale nr. ... në sipërfaqe të përgjithshme prej ..., sipas fletës poseduese numër ..., zona kadastrale M. 5
- Ankesat u dorëzuan nga AKP-ja më 11 korrik 2012 të plotësuar më 31 dhjetor 2013, nga ndërhyrësit *J M, H M, N M, Z M* dhe *Sb M* më 19 korrik 2012 dhe në fund nga ndërhyrësit *Z M* dhe *M M* më 20 korrik 2012. 6
- Ankuesit me ankesat e tyre e kontestuan juridiksionin e Gjykatës Komunale mbi padinë e kontestuar dhe i kundërshtuan rrethanat faktike mbi të cilat ishte bazuar Aktgjykimi i kundërshtuar. Ankuesit kërkuan prishjen e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe rigjykimin para DHPGJS-së. 7
- Ankesa e ankuesit të parë para DHPGJS-së ishte regjistruar me numrin AC-II-12-0184. Me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, të datës 23 nëntor 2012, lënda ankimore u bashkua me lëndën ankimore AC-II-12-0169. 8
- Me urdhrat e Kolegjit të Apelit, të datës 13 shtator 2012, nga të gjithë ankuesit u kërkua që të përmbushin procedurat e zakonshme ankimore dhe secili ankues i plotësoi formalitetet sipas rregullit. 9
- Arsyetimi ligjor:** Ankesat janë të pranueshme dhe të bazuara. 10
- Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës dhe të mos i dërgohet ankesa të paditurës sipas nenit 10.9 të LDHP dhe nenit 60.2 të Shtojcës së LDHP. 11
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të M. duhet të priset. 12

Meritat e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

- 13 Aktgjykimi i ankimuar nuk mund të qëndrojë, sepse nga shkresat e lëndës shihet që Gjykata Komunale nuk kishte juridiksion mbi padinë në kohën kur synoi të vendosë për padinë. Ato procedura jenë të pavlefshme.
- 14 Me Aktvendimin e DHPGJS-së të datës 10 tetor 2006, padia ishte referuar në Gjykatën Komunale të M. me të drejtë ankese në DHPGJS. Gjykata Komunale dështoi të gjykojë lëndët deri në maj të vitit 2012, pesë muaj pasi që LDHP hyri në fuqi më 1 janar 2012.
- 15 Neni 4.4(i) i LDHP e bën të qartë se lidhur me ndonjë kërkesë, lëndë, rast apo procedurë....
të referuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji: (i) nëse gjykata tek e cila është referuar lënda, nuk ka marrë ndonjë Aktvendim substancial në lidhje me atë lëndë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ajo gjykatë pushon së pasuri kompetencë mbi lëndën dhe i kthen gjitha dokumentet dhe shkresat e lëndës tek Dhoma e Posaçme.
- 16 Gjykata Komunale e M. vendosi në mënyrë substanciale, me Aktgjykim, më 25 maj 2012, më shumë se 5 (pesë) muaj pas hyrjes në fuqi të LDHP. Gjykata Komunale nuk është duhur [dashur] të gjykojë padinë dhe është duhur [dashur] të kthejë lëndën në DHPGJS për gjykim.
- 17 Për këto arsye dhe në bazë të neni 4 të LDHP-së dhe neni 5 të LDHP-së, DHPGJS-ja në maj të vitit 2012 dhe më tej ka juridiksion ekskluziv mbi padinë. Procedurat e Gjykatës Komunale janë të pavlefshme dhe prishen [e saktë: Aktgjykimi priset].
- 18 Mbi këtë përfundim dhe në bazë të neni 10.10 të LDHP u vendos si në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

⌚-⌚-⌚

12.

Nuk ka Juridiksion mbi Shoqëritë Aksionare

Juridiksioni; SHA; Dërgimi në rigjykim; I Paditur

LDHP neni 4, 5, 4.1.1.4, 2; Ligji për AKP-në 2008 neni 3, 5.1(a)(i)

Nëse i paditur i vetëm është një SHA, DHPGJS nuk ka juridiksion dhe lënda duhet të hudhet poshtë.

Aktvendimi i datës 16 prill 2014 – AC-II.-13-0030 (Shkalla e parë: Aktvendimi i Gjykatës Komunale në P. i datës 20 shtator 2011 – C.nr.163/2008)

Rrethanat faktike dhe procedurale: Më 10 tetor 2011, paditësi **1**
(ankuesi) ka parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në P., me të cilin ajo e kishte shpallur inkompetencën e kësaj gjykate, duke e dërguar lëndën në DHPGJS në kompetencë të mëtejme [e saktë: si gjykatë kompetente].

Ankuesi pretendon se DHPGJS nuk ka kompetencë në këtë çështje **2**
juridike sepse kjo palë është SHA, ndërsa gjykata me rastin e vendim-marrjes, nuk e ka qartësuar këtë fakt të rëndësishëm.

Padia në këtë çështje juridike ishte ngritur në Gjykatën Komunale **3**
të P. më 3 shtator 2008, me pretendimin për vërtetim të pronësisë së lokalit afarist të cilin paditësi pretendon se e kishte fituar në bazë të një kontrate mbi bashkimin e mjeteve financiare, të lidhur me BVI-në për Banim në P., nr. ... të datës 8 qershor 1984. Kjo kontratë ishte vërtetuar më 2006 në Gjykatën Komunale të S. [tani Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës].

Në përgjigjen e saj lidhur me ankesën, më 18 shkurt 2014, AKP pos **4**
aspektit deklarativ se e paditura NSH “Sb-C” është nën administrimin e AKP-së, asnjë provë lidhur me këtë nuk ka ofruar.

- 5 **Arsyetimi ligjor:** Ankesa është e bazuar.
- 6 Bazuar në nenin 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Ankesave vendosi ta përjashtojë pjesën gojore nga procedura.
- 7 Juridiksioni i DHPGJS është i rregulluar me nenin 4 të LDHP, kurse neni 5 i LDHP përcakton se kush mund të jetë paditës dhe i paditur në procedurën para DHPGJS.
- 8 Neni 4.1.1.4, i LDHP thotë se DHPGJS ka kompetencë ekskluzive mbi një padi kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që supozohet të ketë lindur gjatë ose para kohës kur Ndërmarrja apo Korporata e tillë është apo ishte subjekt i autoritetit administrativ i AKM-së, apo Agjencisë.
- 9 Sipas nenit 2 të LDHP termi “Ndërmarrje” i përdorur në këtë ligj, ka kuptimin e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit për AKP-në2008. Neni 3 i këtij ligji thotë se, termi “Ndërmarrje”, nënkupton një ndërmarrje mbi të cilën Agjencia ka kompetenca sipas nenit 5.1 (a)(i) të Ligjit të njëjtë.
- 10 Sipas nenit 5.1 (a)(i) të Ligjit për AKP-në2008, përcaktohet se, *Agjencia ka autoritetin të administrojë ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pa varësisht nëse i janë nënshtruar Transformimit.*
- 11 Në rastin konkret në këtë lëndë në procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Komonale në P., palë procedurale janë një person privat si paditës dhe një ndërmarrje nga S, Republika [Federata] e Bosnjës dhe Hercegovinës.
- 12 AKP në përgjigjen e saj të paraqitur në ankesën e paditësit, thekson se AKP është administratore e këtij aseti dhe e mbështet Aktvendimin e ankimuar si të drejtë dhe të ligjshëm. AKP nuk ofron asnjë dëshmi që do të mund të bindej gjykata se ky aset është nën administrimin e saj.
- 13 Në anën tjetër, ankuesi ka ofruar prova, siç janë: Kontrata për bashkimin e mjeteve ndërmjet BVI-së për Banim dhe “Sb-K” nga S. [tani Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës], vërtetimin lidhur me këtë bashkim, të kërkuar nga AKM më 4 maj 2006, Kontratën e shitblerjes ndërmjet paditësit dhe “Sb K”, lidhur me lokalin kontestues, të lidhur më 27 qershor 2006. Sipas certifikatës nga regjistri gjyqësor nr. ..., dt. 4 qershor 2008, shihet qartë se pala e paditur është e regjistruar si SHA.

Në bazë të nenit 5.1 (a)(i) të Ligjit për AKP-në2008, AKP-ja ka autoritetin ligjorë t'i administrojë vetëm NSH, pavarësisht nëse janë nënshtruar transformimit, të cilat janë në Kosovë. Kjo dispozitë nuk e autorizon AKP-në t'i administrojë ndërmarrjet të cilat janë jashtë Kosovës, edhe nëse ajo është NSH. **14**

Në këtë lëndë është e qartë se e paditura nuk përfshihet me dispozitat e cekura, prandaj nuk mund të jetë palë në procedurë para DHPGJS. **15**

Në bazë të fakteve të elaboruara më lartë, por edhe në bazë të jurispridencës së deritashme të Kolegjit të Apelit, ku si palë në procedurë kishte subjekte që nuk janë nga Kosova (shih rastet: AC-II-12-0212, AC-II.-12-0058, etj), Kolegji i Ankesave nuk ka kompetencë për gjykimin e këtyre rasteve, andaj ankesa e paditësit është e bazuar dhe çështja duhet të zgjidhet në Gjykatën Themelore të P. **16**

Në bazë të këtyre arsyeve dhe në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së u vendos si në dispozitiv. **17**

⌈⌋⌈⌋⌈⌋

Kundër Aktvendimeve dhe Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit, Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është e papranueshme

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë; Mjet i jashtëzakonshëm juridik; Aktvendimi i Kolegjit të Apelit; Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit; Neni 10.14 i LDHP; Mbrojtja e Ligjshmërisë

LDHP neni 1.3, 10.14; LPK neni 245, 247; LGJ neni 21, 22.1.2;

1. Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë përbëjnë shqyrtim të Gjykatës Supreme të vendimit përfundimtar të cilësdo gjykate më të ulët (në shkallë të parë apo të dytë) në mënyrë që të korrigjohen shkeljet thelbësore të rregullave procedurale apo zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
2. Aktvendimet e nxjerra nga kolegjet e DHPGJS-së në shkallë të parë, të cilat janë bërë të plotfuqishme ngase ndaj tyre nuk është parashtruar ankesë sipas rregullit, mund të konsiderohen se janë nxjerrë nga një gjykatë më e ulët dhe si pasojë të përfshihen në sferën e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë.
3. DHPGJS është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës. Prandaj, Aktvendimet dhe Aktgjykimet e lëshuara nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk janë nxjerrë nga një gjykatë më e ulët por nga vet Gjykata Supreme.

Aktvendimi i datës 12 shtator 2014 – AC-I-14-0077 (shkalla e dytë: Aktgjykimi i datës 13 shtator 2012 – ASC-09-0084; shkalla e parë: Aktgjykimet e datës 15 tetor 2009 – SCC-05-0080, SCC-06-0029, SCC-06-0470, SCC-06-0482, SCC-06-0524)

- 1 **Rrethanat procedurale dhe faktike:** Më 23 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtrroi një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër

Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, ASC-09-0084 të datës 13 shtator 2012.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të gabuar dhe Kolegjit të Apelit i propozon që ta anulojë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit ASC-09-0084 të datës 13 shtator 2012 dhe Aktgjykimet e shkallës së parë SCC-05-0080, SCC-06-0029, SCC-06-0470, SCC-06-0482, SCC-06-0524, të gjithë të datës 15 tetor 2009 dhe lëndën ta kthejë në rigjykim. **2**

Arsyetim ligjor: Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pa-pranueshme. **3**

Sipas nenit 10.14 i LDHP, të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër. Apeli është një mjet i zakonshëm juridik (Kreu XIII i LPK). **4**

LDHP-ja dhe Shtojca e saj nuk përmbajnë një referim ndonjë mjeti të jashtëzakonshëm juridik kundër Aktvendimeve apo Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit. Mjete të tilla të jashtëzakonshme juridike nuk janë paraparë as me Rreg. e UNMIK-ut 2008/4 e as me UA të UNMIK-ut 2008/6. **5**

Ndonëse ky lëshim nuk do të thotë medoemos se vullneti i ligjvënësit ka qenë që të përjashtojë të gjitha mjetet e jashtëzakonshme juridike nga procedura para DHPGJS-së, Kolegji i Apelit konsideron se një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e pranueshme kundër Aktvendimeve dhe Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. **6**

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë përbëjnë vlerësimin nga Gjykata Supreme të një vendimi të formës së prerë të cilësdo gjykatë më të ulët (të shkallës së parë apo të dytë) në mënyrë që të korrigjojë shkeljet të konsiderueshme të caktuara të rregullave procedurale apo aplikimin e gabuar të së drejtës materiale (neneve 245 dhe 247 të LPK-së dhe nenit 22.1.2 i LGJ). **7**

Neni 22.1.2 i LGJ, përcaktojnë qartë se Gjykata Supreme (përfshirë degët e saj të posaçme) **8**

është kompetente të vendosë lidhur me kërkesat për mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të prera të gjykatave të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me ligj.

Në bazë të nenit 1.3 të LDHP-së dhe nenit 21 të LGJ, DHPGJS është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës.

- 9 Vendimet e nxjerra nga Trupat Gjykuese (siç quheshin kolegjet e shkallës së parë të DHPGJS-së para 1 janarit 2012), Kolegjet e Specializuara, nën-kolegjet apo gjyqtarët e vetëm të DHPGJS-së, të cilat janë bërë të plotfuqishme meqë asnjë ankesë nuk është parashtruar në kohë të rregullt, sipas organizimit të veçantë të DHPGJS-së, mund të konsiderohen si të lëshuara nga një gjykatë më e ulët dhe rrjedhimisht të përfshihen në sferën e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë. Megjithatë, në rastin konkret, Aktgjykimet dhe Aktvendimet e Trupave Gjykuese ishin ankimuar me mjete të zakonshme juridike në pajtim me dispozitat ligjore të LDHP-së. Kolegji i Apelit ka lëshuar Aktgjykimet e tij përfundimtare në këto ankesa. Andaj, Aktgjykimet në fjalë të Trupave Gjykuese nuk mund t'i nënshtrohen vlerësimit në bazë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
- 10 Aktvendimet dhe Aktgjykimet e lëshuara nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk nxirren nga një gjykatë më e ulët por nga vet Gjykata Supreme. Një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është menduar si një vlerësim nga Gjykata Supreme i vendimeve të nxjerra nga një gjykatë më e ulët, jo si një vet-vlerësim. Rrjedhimisht, vendimet e nxjerra nga Kolegji i Apelit përjashtohen nga sfera e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.
- 11 Andaj, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar kundër Aktgjykimit të prerë të Kolegjit të Apelit ASC-09-0084 i datës 13 shtator 2012 dhe kundër Aktgjykimeve të Trupave Gjykuese SCC-05-0080, SCC-06-0029, SCC-06-0470, SCC-06-0482, SCC-06-0524, të gjithë të datës 15 tetor 2009, duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.
- 12 Për këto arsye, u vendos si në dispozitiv.



Kundër Aktvendimeve dhe Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit, Revizioni është i papranueshëm.

Kërkesë për revizion; Mjet i jashtëzakonshëm juridik; Aktvendim i Kolegjit të Apelit; Aktgjykim i Kolegjit të Apelit; Neni 10.14 i LDHP

LDHP neni 1.3, 10.6, 10.14; LPK neni 211.1, 212, 214, 229; LGJ neni 21, 22.1.3

1. Revizioni parashih vlerësimin nga Gjykata Supreme të një Aktgjykimi të lëshuar nga një gjykatë e shkallës së dytë i cili nuk i nënshtrohet ndonjë apeli tjetër, në mënyrë që të korrigjojë shkeljen thelbësore të rregullave procedurale apo zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
2. Aktvendimet dhe Aktgjykimet e lëshuara nga Kolegji i Apelit nuk mund të jenë objekt i revizionit sepse nuk janë lëshuar nga një gjykatë e shkallës së dytë por nga vet Gjykata Supreme.

Aktvendimi i datës 12 shtator 2014 – AC-I-14-0078 (shkalla e dytë: Aktgjykimi i datës 13 shtator 2012 – ASC-09-0084)

Rrethanat faktike dhe procedurale: Më 18 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës kërkoi revizion të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHP-GJS-së, ASC-09-0084, të datës 13 shtator 2012, të cilin e kishte pranuar më 28 shtator 2012. 1

Parashtruesi pretendoi se Gjykata kishte shkelur LPK pasi që dispozita ligjore ishte e pakuptueshme dhe në kundërshtim me arsyet e Aktgjykimit dhe për shkak se ekzistonin mospajttime në vlerësimin e fakteve vendimtare. Veç kësaj, ishte i mendimit se gjykata e duhur për vendosje ishte gjykata për çështje penale. 2

- 3 Në këtë kërkesë për revizion, parashtruesi i propozon DHPGJS-së ta anulojë Aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta refuzojë padinë si të pabazuar, ose ta kthejë lëndën në rigjykim pranë një gjykate tjetër kompetente.
- 4 **Arsyetim ligjor:** Kërkesa për revizion është e papranueshme.
- 5 Sipas nenit 10.14 i LDHP, të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër. Apeli është një mjet i zakonshëm juridik (Kreu XIII i LPK).
- 6 LDHP-ja dhe Shtojca e saj nuk përmbajnë një referim ndonjë mjeti të jashtëzakonshëm juridik kundër Aktvendimeve apo Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit. Mjete të tilla të jashtëzakonshme juridike nuk janë paraparë as me Rreg. e UNMIK-ut 2008/4 e as me UA të UNMIK-ut 2008/6.
- 7 Ndonëse ky lëshim nuk do të thotë medoemos se vullneti i ligjvënësit ka qenë që të përjashtojë të gjitha mjetet e jashtëzakonshme juridike nga procedura para DHPGJS-së, Kolegji i Apelit konsideron se revizioni nuk është i pranueshëm kundër Aktvendimeve dhe Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
- 8 Revizioni parasheh vlerësimin nga Gjykata Supreme të një Aktgjykimi të lëshuar nga një gjykatë e shkallës së dytë i cili nuk i nënshtrohet ndonjë apeli tjetër (neni 229 i LPK-së) për të korrigjuar shkelje të konsiderueshme të rregullave procedurale apo aplikimin e gabuar të së drejtës materiale (në bazë të neneve 211.1, 212 dhe 214 të LPK-së dhe neni 22.1.3 të LGJ).
- 9 Sipas nenit 1.3 të LDHP-së dhe nenit 21 të LGJ, DHPGJS është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës. Neni 22.1.3 i LGJ, përcakton qartë se Gjykata Supreme (përfshirë degët e saj të posaçme) është kompetente të vendosë lidhur me revizionin kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së dytë për çështjet kontestuese, siç është paraparë me ligj.
- 10 Aktvendimet dhe Aktgjykimet e Kolegjeve të Specializuara, nën-kolegjeve apo të gjyqtarëve të vetëm të DHPGJS-së, në bazë të organizimit

të veçantë të DHPGJS-së, janë Aktvendime dhe Aktgjykime të shkallës së parë dhe mund të ankimohen (neni 10.6 i LPK-së). Rrjedhimisht, ato përjashtohen nga sfera e revizionit.

Aktgjykimet e lëshuara nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së janë gjithashtu të përjashtuara nga sfera e revizionit. Aktvendimet dhe Aktgjykimet e Kolegjit të Apelit nuk nxirren nga një gjykatë e shkallës së dytë por nga vet Gjykata Supreme. Revizioni është paraparë të jetë një vlerësim nga Gjykata Supreme i Aktgjykimeve të nxjerra nga një gjykatë më e ulët, jo si një vet-vlerësim. Rrjedhimisht, Aktvendimet dhe Aktgjykimet e Kolegjit të Apelit nuk mund t'i nënshtrohen revizionit. **11**

Andaj, kërkesa e parashtruesit për revizion, e parashtruar kundër Aktgjykimit të formës së prerë të Kolegjit të Apelit, ASC-09-0084, të datës 13 shtator 2012, duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. **12**

Për këto arsye, u vendos si në dispozitiv. **13**

⌚⌚⌚

15.

Mos-përrjashtimi i përgjithshme i zbatueshmërisë së ligjeve që kanë hyrë në fuqi pas 22 marsit 1989/Roli i Këshillit të Punëtorëve në procesin e Privatizimit/Vlerësimi i aseteve të NSH-së

Themelimi i SHA/SHPK; Zbatueshmëria e ligjeve të aprovuara pas 22 marsit 1989; Transformimi i kapitalit të NSH-së në pronësi shoqërore në SHA

LN neni 94, 100, 36.1, 47.1, 50; Ligji për Kapitalin Shoqërorë (Gazeta Zyrtare e RSFJ 46/90) neni 4, 1b.2, 1b, 2a; Ligji për Qarkullimin dhe Disponimin me Kapital Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89) neni 4, 2a; LDHP neni 10.10; Rreg. UNMIK-ut 1999/24

1. Nëse një ligj i miratuar pas 22 marsit 1989 nuk përmban elemente diskriminuese – siç është Ligji për Kapitalin Shoqëror, i 20 gushtit 1990 -, mund të përcaktohet të jetë i zbatueshëm në përputhje me Rreg. e UNMIK-ut 1999/24, e cila ishte e nevojshme nga natyra diskriminuese e disa prej legjislacioneve të mëvonshme të RSFJ.
2. Këshilli i Punëtorëve të NSH ka autoritet ekskluziv për të vendosur për fillimin e procesit të privatizimit përmes transformimit. Megjithatë, si palë në privatizim, këshilli e punëtorëve nuk ka autoritet për të vendosur mbi vlerën e kapitalit që do të gjenerohet përmes shpërndarjes së aksioneve.
3. Bilanci nuk është një zëvendësim për një vlerësim të duhur të aseteve të NSH-së.
4. Edhe në qoftë se një agjenci e akredituar vlerësimi nuk ekziston ose nuk ka qenë në dispozicion në kohën kur këshilli i punëtorëve ka miratuar vendimin për transformim, diçka e tillë nuk do të shtojë vlerën ligjore vendimit të këshilli që të zëvendësojë vlerësimin zyrtar me çfarëdo lloj raporti.

5. Një vlerësim i miratuar nga agjencia e akredituar e vlerësim-it përbën një lloj akti administrativ. Si një parim i përgjithshëm, asnjë person - fizik ose juridik – nuk është i lejuar për të zëvendësuar ndonjë akt administrativ me vullnetin e tyre.
6. Transformimi është një proces shumë fazësh ku vlefshmëria e çdo hapi është e përcaktuar edhe me vlefshmërinë e hapave të mëparshëm. Një dështim i theksuar në një fazë, e bën tërë procesin të pavlefshëm edhe nëse nuk ka pasur dështime të tjera.

Aktvendimi i 18 shtatorit 2014 – AC-I.-14-0102 (Shkalla a parë: Aktvendimi i 7 marsit 2014 – SCC-08-0124)

Rrethanat faktike dhe procedurale: Më 5 maj 2008, paditësi ka dorëzuar padi në DHPGJS duke kërkuar që të njihet si SHA, me 100 për qind të aksioneve, duke ofruar prova që datojnë duke filluar nga viti 1991 e deri më 2003. Më 27 mars 2013, paditësi ka ushtruar një kërkesë për ndryshimin e padisë, duke e tërhequr padinë kundër AKM-së dhe duke kërkuar tashmë vetëm 58 % të aksioneve. 1

Përgjigja e AKP-së

Më 30 tetor 2013, AKP-ja e ushtroi një përgjigje në padi dhe theksoi si në vijim: 2

Në bazë të dokumentacionit shtesë të paraqitur nga paditësi mund të konstatohet se:

- i) Nuk është bërë asnjë vlerësim i kapitalit shoqëror para fillimit të procesit të transformimit.
- ii) Në dosje të lëndës nuk është paraqitur asnjë dëshmi që lidhet me pagesën e aksioneve që përdorin llogari bankare të ndërmarrjes ashtu siç parashihet me Ligjin mbi Ndërmarrjet (Ligji 77/88, neni 94 dhe neni 100).
- iii) Aksionet e brendshme ishin regjistruar duke u bazuar në ngritjen enorme të pagave të punëtorëve me baza retroaktive.
- iv) Nuk është prezantuar asnjë dokument financiar në dispozicion që mund të dëshmojë transformimet financiare nga ndërmarrja shoqërore në shoqëri aksionare.
- v) Nuk është prezantuar asnjë dëshmi mbi investimet në ndërmarrje si rezultat i shitjes së kapitalit.

vi) Nuk janë paraqitur dëshmi të pagesës efektive të aksioneve që paraqet një prej kushteve kryesore për vlefshmërinë e transformimit.

AKP-ja i propozon DHPGJS që të refuzohet në tërësi padia e paditësit si e pabazuar në ligj.

Kundërpërgjigjja e paditësit

3 Më 26 dhjetor 2013, paditësi i është përgjigjur në këtë parashtrësë të AKP-së. Sipas paditësit procedura e transformimit ka ndodhur si në vijim:

1. Vendimi i Këshillit të Punëtorëve për të transformuar ndërmarrjen në një SHA ose ShPK

4 Në vitet e 90-ta, një NSH, ndërmarrje në pronësi shoqërore, ishte në gjendje për të themeluar një SHA ose ShPK në pajtim me nenin 36.1 të LN, i cili thotë:

Një ose disa subjekte shoqërore juridike mund të themelojnë një Shoqëri Akcionare ose Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, si një ndërmarrje në pronësi shoqërore.

Në bazë të nenit 47.1 të LN, organi drejtues i NSH do të jetë Këshilli i Punëtorëve, ose një organ menaxhues përgjegjës me të në aspektin e pozitës dhe funksionit. Këshilli i Punëtorëve vendosë me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Punëtorëve, përveç nëse një tjetër kuorumi parashikohet nga aktet nënligjore të NSH për të vendosur për çështje të veçanta (neni 50 i LN-së).

2. Vendimi i Gjykatës për Regjistrimin- lëshuar nga Gjykata Ekonomike e Gj.

3. Vlerësimi i kapitalit shoqëror të ndërmarrjes.

5 Sipas nenit 4 të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, kur vendosë për të shitur një ndërmarrje ose një pjesë të saj, apo për të kthyer borxhet, trupi drejtues i një ndërmarrjeje ose korporate do të vazhdojë nga një vlerësim i parashikuar i asaj ndërmarrjeje. Vlëra e një ndërmarrjeje do të vlerësohet nga një organizatë e autorizuar me ligj.

Në fakt Serbia kurrë nuk ka ngritur një agjenci që t'i autorizojë ato, por vlerësimet e duhura megjithatë janë miratuar zyrtarisht nga gjykata kompetente. **6**

4. Vendimi për lëshimin dhe ndarjen e aksioneve të brendshme.

Një NSH mund të emetojë aksione, nëpërmjet shitjes së aksioneve që përcjellin të drejtën e pronësisë. Lëshimi i aksioneve, është rregulluar me Ligjin për Letra me Vlerë. **7**

Sipas nenit 1b.2 të Ligjit për Kapitalin Shoqëror, aksionet e brendshme fituan karakteristikat e aksioneve të përmendura në Ligjin e Letrave me Vlerë, me kusht që e gjithë shuma është paguar dhe se kushtet e tjera të parashikuara nga ky ligj janë plotësuar. Megjithatë, punonjësit kishin të drejtë në shpërndarjen e 30% të aksioneve pa kompensim, plus një shumë shtesë në përqindje në bazë të viteve të punësimit (+ 1% për çdo vit përvojë pune). **8**

5. Dëshmi se aksionet janë paguar nga aksionarët.

“E” SHA, pastaj u bë pronare e asetëve të identifikuar. Në përgjithësi, vetëm makineri, ndërtesa dhe toka të lidhura ngushtë janë transformuar, ndërsa tokat bujqësore nuk janë përfshirë. **9**

Analiza më e dobishme, bazë për të kuptuar rastet, është raporti i shkëlqyer i përgatitur nga një ekip prej tre personave të avokatëve që vepruan për paraardhësit e AKM-së. Ky raport 17 faqe (i bashkëngjitur në këtë lëndë) ofron një sfond ligjor dhe historik që është thelbësorë për të kuptuar pretendimet. **10**

Më 20 gusht 1990, u miratua Ligji për Kapital Shoqërorë në të atëhershmen RSFJ. Edhe pse data e këtij ligji ishte pas datës 22 mars 1989, data e përcaktuar në Rreg. e UNMIK-ut 1999/24 (mbi ligjin në fuqi në Kosovë), ishte ligji i aplikueshëm gjatë fillimit të viteve 1990-ta dhe regjistrimet kompanitë të cilat kanë ndodhur në vitin 1990-1991, ishin të ligjshme. Rregullorja 1999/24 u bë e nevojshme nga ana e karakterit diskriminues të disa prej legjislacioneve të mëvonshme të RSFJ-së. Duhet theksuar se 1990 Ligji për Kapitalin Shoqërorë nuk përmban asnjë element të diskriminimit. **11**

12 Ky ligj është përdorur në të gjithë Jugosllavinë, por zbatimi i tij filloi në Gj., Kosovë e cila ishte shkurtimisht zona më aktive e biznesit derisa masat e dhunshme të Millosheviqit u paraqiten dhe ndërhyjnë në proces.

13 Paditësi kërkon nga DHPGJS për të nxjerrë një Aktgjykim që konfirmon se “E” është një SHA e themeluar ligjërisht, dhe se 58% e aksioneve është në pronësi private nga 185 aksionarët, të cilët kanë paguar për aksione. Pjesa e mbetur prej 42% të aksioneve është në pronësi shoqërore dhe nën administrimin e AKP-së.

Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar

14 Më 7 mars 2014, Kolegji i Specializuar morri Aktgjykimin SCC-08-0124, me të cilin padia e paditësit refuzohet si e papabuar.

15 Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi thuhet se, padia në fjalë është deklarative sipas natyrës. Objekti i çështjes gjyqësore është përgjigja e saktë e pyetjes: “A ka qenë “E”, NSH nga Gj. ligjërisht e transformuar në SHA dhe 58% (pesëdhjetetë për qind) e kapitalit të saj është caktuar në pronësi private të aksionarëve”. Afati kohorë i transformimit të pohuar fillon më 23 prill 1991 dhe është dashur që të përfundojë në një moment të papërcaktuar në vitet e 90- ta, para ardhjes së Administratës Ndërkombëtare në Kosovë.

16 “E” fillimisht ishte organizuar si një sistem i biznesit, duke ofruar lloje të ndryshme të prodhimit dhe të shërbimeve. Më 19 mars 1990, sistemi ishte ndarë në gjashtë entitete dhe vetëm njëra prej tyre – Kompania e paditësit – e kishte ruajtur emrin “E”. Entiteti i ri “E” do të ofronte shërbime menaxheriale ligjore dhe administrative, për pesë të tjerat. Më 23 prill 1991, një Këshilli i Punëtorëve i të gjitha gjashtë entiteteve vendosi (vendimi nr. ..., i datës 30 prill 1991) t’i transformojë ato në SHA. Pas kësaj, më 30 prill 1991, Këshilli i Punëtorëve të entitetit “E”, mori një vendim për transformimin dhe riorganizimin. Me këtë vendim, u themelua një strukturë e re menaxhuese si dhe mundësia që të gjithë 185 punëtorët t’i blejnë aksionet e kompanisë nëpërmjet regjistrimit të brendshëm. Këshilli po ashtu vendosi për shumën e kapitalit që do të transformohej ishte ... dinarë. Siç thuhet në vendim, kjo vlerë ishte marrë drejtpërdrejt nga bilanci i gjendjes së fundit të entitetit. Në ditën e njëjtë, Këshilli i njëjtë i Punëtorëve e mori vendimin nr. ... për lëshimin e aksioneve të brendshme. Me anë të këtij vendimi, të gjithë punëtorët ishin ftuar për të blerë aksione dhe ishin njoftuar për të drejtën e tyre për të marrë aksione në vend të rrogave.

Më vonë, një parashtrësë për regjistrim, ishte ushtruar pranë gjykatës kompetente – Gjykatës Ekonomike në Gj. Më 20 qershor 1991, kjo gjykatë e lëshoi Aktvendimin me të cilin e miratoi kërkesën për të bërë ndryshimet në Regjistrin e Entiteteve, domethënë – ndryshimin e statusit të “E” dhe themelimin e SHA. Emri sipas së cilit entiteti i sapokrijuar do të vepronte ishte, “NSH për Qarkullim, Shërbime, Informatikë dhe Marketing -“E”, SHA në Gj.”. Emri do të pasqyronte statusin transitor të entitetit, sepse regjistrimi nuk e ka finalizuar procesin e transformimit. Ky proces do të duhej të avanconte me blerjen e aksioneve.

17

Këshilli i Punëtorëve i NSH-së ka kompetencë ekskluzive për të vendosur që të fillohet procesi i privatizimit përmes transformimit. Megjithatë, si palë në privatizim, Këshilli i Punëtorëve nuk ka pasur kompetencë për të vendosur për vlerën e kapitalit të cilën ata kanë dashur ta blejnë [e saktë: gjenerojnë] nëpërmjet shpërndarjes së aksioneve. Për këtë arsye, Ligjvënësi Federativ i ish RSFJ-së e miratoi pikën 4 të Ligjit për Transformimin [e saktë: Qarkullimin] dhe Shitjen [e saktë: Disponimin] me Kapitalin Shoqërorë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 46/1990). Sipas kësaj dispozite, Organi Menaxhues (pra Këshilli i Punëtorëve), kur të vendosë për transformimin, do të vazhdojë nga vlera e përlllogaritur e kapitalit shoqërorë. Kjo vlerë do të krijohej nga organizata e autorizuar me Ligj. Kjo organizatë– agjenci, ishte referuar në pikën [nenin] 2a të Ligjit të njëjtë. Agjencia kishte kompetencën për të emëruar një Organ për të ekzekutuar vlerësimin aktual të kapitalit dhe pastaj që ta miratojë atë.

18

Nga të gjitha vendimet e Këshillit të Punëtorëve të paraqitura si dëshmi si dhe nga vendimi i Gjykatës Ekonomike për regjistrimin, janë të qarta se asnjë vlerësim i tillë nuk është paraqitur. Në vend të kësaj, Bilanci i Gjendjes ishte përdorur si zëvendësim i vlerësimit dhe më vonë ishte dorëzuar në gjykatë. Pse e kishte pranuar këtë parashtrësë Gjykata Ekonomike – në kuptim të dispozitës shumë të qartë të pikës [nenin] 4 nuk është e qartë, megjithatë vendimi nuk ka arsyetim. Çështja e mungesës së vlerësimit ishte marrë parasysh nga palët dhe gjykata. Me parashtrësën e datës 26 dhjetor 2013, paditësi kishte shpjeguar se Këshilli i Punëtorëve nuk i ishte drejtuar Agjencisë sepse një Agjenci e tillë “kurë nuk kishte ekzistuar në Serbi”. Por në seancën e fundit dëgjimore, e paditura e paraqiti një kopje të certifikatës që mbanë nr. e Regjistrimit Ky dokument ishte lëshuar në emër të “Agjencisë Republikane për

19

Përcaktimin e Vlerës së Kapitalit Shoqëror”. Nuk është precizuar se kur është formuar ajo agjenci, para apo pas transformimit të kësaj NSH-je.

- 20 Përfaqësuesi i paditësit nuk e ka kundërshtuar vërtetësinë e dokumentit, por duke u përballur me këtë dëshmi, ai e ndryshoi deklaratën e tij. Tani kundërshtimi i paditësit ishte s Agjencia ka mundur që të ekzistojë në Serbi si institucion serb, por Kosova nuk e ka pasur Agjencinë e saj.
- 21 Gjykata gjen se certifikata në fjalë (e bashkëngjitur me dëshmi) e vërteton ekzistimin e Agjencisë në fjalë, pra në vitin 1991 dhe personat të cilët kanë qenë të ngarkuar me transformimin e “E”, thjeshtë, nuk e kanë paraqitur kërkesën për vlerësimin e kapitalit.
- 22 Por, edhe nëse Agjencia nuk ka ekzistuar ose nuk ishte në dispozicion në kohën kur Këshilli i Punëtorëve e miratoi vendimin për transformimin, një fakt i tillë nuk i shton kurrfarë vlere ligjore vendimit të Këshillit për të zëvendësuar vlerësimin zyrtar me çfarëdo lloj tjetër raporti. Kjo është sepse një vlerësim i miratuar nga Agjencia përbënte njëfarë Akti Administrativ. Si parim i përgjithshëm, asnjë person - fizik apo juridik - nuk lejohet që të zëvendësojë çfarëdo akti administrativ me vullnetin e tyre. Dhe kjo është pikërisht ajo se çfarë kishte ndodhur kur Këshilli i Punëtorëve e mori Bilancin e Gjendjes më të fundit në vend të vlerësimit zyrtar. Bilanci i Gjendjes si raport financiar dhe vlerësimi i ofruar në bilanc kanë qëllime krejtësisht të kundërta dhe nuk mund të konsiderohen si vlerësim i duhur i kapitalit shoqërorë.
- 23 Për shkak të kësaj shkelje thelbësore kundër kësaj të fundit dhe kundër parimit të ligjit, që të dyja, pra vendimi i Këshillit të Punëtorëve për transformim dhe vendimi pasues i gjykatës për regjistrimin e transformimit do të konsiderohen pa efekt ligjor [e saktë: që nuk ka asnjë efekt ligjor]. Ky dështim ligjor e përcakton vlefshmërinë e të gjithë procesit të transformimit të NSH “E” në SHA. Transformimi është një proces shumëfazësh ku vlefshmëria e secilit hap përcaktohet gjithashtu edhe nga vlefshmëria e hapave të mëparshëm. Një dështim thelbësor në një fazë e bënë të gjithë procesin të pavlefshëm edhe nëse nuk ka pasur dështime të tjera.
- 24 Paditësi nuk ka paraqitur dëshmi relevante për pagesën ekzistuese të aksioneve. Përfaqësuesi i paditësit thekson se arkiva e kompanisë ishte

shkatërruar në luftën e fundit në Kosovë. Megjithatë, fakti i shkatërrimit do të duhej të vërtetohet nga pala paditëse e cila nuk ka paraqitur asnjë dëshmi në mbështetje të saj. Për më tepër – çfarëdo pagese nëse janë ekzekutuar dhe regjistruar ashtu siç duhet është dashur që t'i raportohen autoriteteve zyrtare dhe që akoma këto të dhëna do të mund të merreshin. Të dhënat e vetme për pagesat mund të nxirren nga vendimi i Gjykatës Ekonomike në Gj. ku thuhet se ... din. ishin paguar para regjistrimit. Sidoqoftë, lidhur me arsyet e shprehura më sipër - këto pagesa nuk kanë pasur efekt transformues.

Paditësi po ashtu nuk ishte në gjendje që të vërtetojë në mënyrë të qartë mënyrën se si shumica e pretenduar prej 58% e transformimit të kapitalit ishte rregulluar. Në të vetmet dokumente ku shkruhet për 58% të transformimit është parashtrësja e ish të paditurës AKM e datës 2 korrik 2012. Kjo deklaratë në të vërtetë mund të trajtohet si pëlqim i pjesshëm për padinë. Megjithatë, ky pëlqim as nuk është dëshmi dhe as nuk është i detyrueshëm për gjykatën ose për të paditurën e mbetur, Agjencinë Kosovare e Privatizimit. Në këtë rast, që të dyja, AKM dhe AKP kanë marrë pjesë në anën e të paditurës që nga fillimi dhe kanë vepruar në mënyrë të pavarur derisa padia ishte tërhequr kundër AKM-së.

Ankesa dhe veprimet procedurale të Kolegjit të Apelit

Më 2 prill 2014 paditësi(ankuesi) ka parashtruar ankesë kundër këtij Aktgjykimi, të cilin e quan si të pa drejtë dhe të pa bazuar, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të nxjerr një Aktgjykim me të cilin do të konfirmohet se “E” është transformuar në mënyrë të ligjshme dhe ka statusin e SH.A, gjegjësisht të konfirmohet se 58 për qind e aksioneve është në pronësi private dhe se 185 aksionarët të cilët kanë paguar aksionet e tyre, janë pronarë të atyre aksioneve.

Në këtë ankesë prej 8 faqesh, ankuesi ka bërë elaborimin e transformimit të pretenduar, por duke konsideruar se të gjitha provat janë ofruar në procedurën paraprake në shkallë të parë. Ai ka përsëritur të gjithë atë që është thënë në padi lidhur me statusin e kësaj ndërmarrjeje.

Më 29 prill 2014, AKP ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit dhe e ka kundërshtuar në tërësi atë si të pabazuar ankesën e paditësit. AKP ka përsëritur të njëjtat pretendime kundërshtuese ndaj pretendi-

meve të ankuesit për “E” si SHA, duke e kundërshtuar në tërësi për të njëjtat shkaqe që i kishte potencuar në përgjigje të padisë.

29 AKP ka deklaruar gjithashtu se, “me vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, është vendosur që të themelohet një grup i posaçëm, i specializuar për analizimin e transformimit të pretenduar të kësaj ndërmarrjeje”.

30 Lidhur me këtë deklaram të AKP-së, më 28 maj 2014, Kolegji i Ankesave ka kërkuar nga AKP-ja që të saktësoj se kur është marrë ky vendim, kush janë ekspertët që do e shqyrtojnë transformimin e mundshme të kësaj ndërmarrje dhe në cilën fazë të hulumtimeve ka arritur ky grup, dhe nëse ka ndonjë vlerësim inicial zyrtar lidhur me këtë. Më 6 qershor 2014 AKP ka dorëzuar përgjigje përmes postës dhe një dokument me titull “raport gjithëpërfshirës”, të datës 15 tetor 2010, ku përshkruhet në hollësi proceduar lidhur me zhvillimet për transformim të pronës në ndërmarrjet e lartpërmendura në vitet 90 e deri më sot. Në këtë grup punues figurojnë emrat e katër anëtarëve të grupit dhe dy këshilltarë. Nuk ka nënshkrime të këtyre anëtarëve.

31 **Arsyetimi ligjor:** Ankesat është e pabazuar.

32 Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e Kolegjit të Ankesave

33 Kolegji i Ankesave pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, Aktgjykimin e ankimuar dhe të gjitha provat materiale në shkresat e lëndës gjeti se ankesa është e pabazuar, dhe, rrjedhimisht vërtetohet Aktgjykimin i ankimuar i Kolegjit të Specializuar.

34 Sa i përket provës së ofruar nga ankuesi, lidhur me Vendimin e Këshillit të Punëtorëve për të transformuar ndërmarrjen në një SHA ose SHPK., Vendimin i Gjykatës për Regjistrimin- lëshuar nga një Gjykatë Ekonomike e Gj., nuk ka asgjë kontestuese, sepse ato janë prova të administruara dhe të pakontestuar edhe në shkallë të parë.

35 Ankuesi, edhe në padi edhe në ankesë e potencon nenin 1b.2 të Ligjit për Kapitalin Shoqëror (pa cekur cili numër), që sipas ankuesit,

punëtorët në mënyrë automatike kanë të drejtën në zbritje prej 30 për qind të çmimit të aksioneve, plus 1 për qind për çdo vit të përvojës së punës.

Edhe pse ankuesi nuk e ka identifikuar qartë ligjin në të cilin është thirrë, Kolegji i Apeli e ka vlerësuar këtë pretendim ankimor, konform kompetencave ligjore që i ka. Sipas gjetjeve të Kolegjit të Apelit, pasi që fazat tjera kryesore për procesin e transformimit të kësaj prone nuk janë përmbyshur, siç janë: Vlerësimi i kapitalit shoqëror të ndërmarrjes, Vendimi për lëshimin dhe ndarjen e aksioneve të brendshme, Dëshmi për pagesat e aksioneve nga aksionarë. Nuk mund të merret si provë valide asnjë veprim tjetër i menaxhmentit dhe punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje.

36

Vlerësimi i Kapitalit shoqëror

Siç ka konstatuar edhe Kolegji i Specializuar në Aktgjykimin e kundërshtuar, Këshilli i Punëtorëve i NSH kishte kompetencë ekskluzive për të vendosur që të fillohet procesi i privatizimit përmes transformimit. Megjithatë, si palë në privatizim, Këshilli i Punëtorëve nuk ka pasur kompetencë për të vendosur për vlerën e kapitalit të cilën ata kanë dashur ta blejnë [e saktë: gjenerojnë] nëpërmjet shpërndarjes së aksioneve. Për këtë arsye, Ligjvënësi Federativ i ish RSFJ-së e miratoi pikën [nenin] 4 të Ligjit për Transformimin dhe Shitjen e Kapitalit në Pronësi Shoqërore [e saktë: Ligji mbi Qarkullimin dhe Disponimin me Kapitalin Shoqërorë] (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 46/1990 [e saktë: 84/89]). Sipas kësaj dispozite, Organi Menaxhues (pra Këshilli i Punëtorëve), kur të vendosë për transformimin, do të vazhdojë nga vlera e përlogaritur e kapitalit në pronësi shoqërore. Kjo vlerë do të krijohej nga organizata e autorizuar me ligj. Kjo organizatë, agjenci, ishte referuar në nenin 2a, të ligjit të njëjtë [Ligji mbi Kapitalin Shoqërorë]. Agjencia kishte kompetencën për të emëruar një Organ për të ekzekutuar vlerësimin aktual të kapitalit dhe pastaj që ta miratojë atë. Çështja thelbësore në këtë rast është se a është bërë vlerësim i duhur ligjor i kapitalit shoqëror, i cili duhej të transformohej në SHA.

37

Nga të gjitha vendimet e Këshillit të Punëtorëve të paraqitura si dëshmi si dhe nga vendimi i Gjykatës Ekonomike për regjistrimin, duket qartë se asnjë vlerësim i tillë nuk është paraqitur. Në vend të kësaj, Bilanci i Gjendjes ishte përdorur si zëvendësim i vlerësimit të kapitalit shoqëror, dhe më vonë ishte dorëzuar në gjykatë. Gjendja e

38

bilancit nuk e bënë vlerësimin dhe regjistrimin e të gjitha asetëve të ndërmarrjes, por vetëm pjesën financiare të saj.

39 Fillimisht paditësit kishin deklaruar se Këshilli i Punëtorëve nuk i ishte drejtuar Agjencisë sepse një Agjenci e tillë kurrë nuk kishte ekzistuar në Serbi. Në seancën dëgjimore, e paditura e kishte paraqitur një kopje të certifikatës që mbanë nr. e Regjistrimit ..., e që ishte lëshuar nga Agjencisë Republikane për Përcaktimin e Vlerës së Kapitalit Shoqëror.

40 Kjo dëshmon se në bazë të nenit 4 të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror [e saktë: Ligji mbi Qarkullimin dhe Disponimin me Kapital Shoqërorë] të aplikueshme në atë kohë, vlerësimin e kapitalit shoqëror për një NSH, ka mund ta bëjë vetëm agjencia e specializuar për këtë, dhe asnjë organ i NSH-së. Për më tepër, ky vlerësim nuk është bërë asnjëherë nga askush në këtë ndërmarrje, pos bilancit financiar, që nuk ka të bëjë asgjë me kapitalin shoqëror të ndërmarrjes, për faktin se kapitali i një NSH-je përbëhet prej shumë asetëve, mjeteve financiare dhe mjeteve tjera të nevojshme për prodhim.

41 Me ankesë nuk janë ofruar prova tjera për këtë proces, andaj nuk ka asnjë arsye që Kolegji i Ankesave të mos pajtohet me këtë vlerësim dhe këto gjete të Kolegjit të Specializuar.

Emetimi dhe shitblerja e aksioneve

42 Vendimet e marra nga Këshilli i Punëtorëve për emetimin e aksioneve interne, sipas bazës së pagesës së të ardhurave personale, siç janë; Marrëveshje për lejimin e shitblerjes së lirë të aksioneve interne, Vendimi për emetimin e aksioneve interne dhe shitjen e kapitalit, Thirrje për regjistrimin dhe blerjen e aksioneve interne, janë marrë në një datë të vetme, 30 prill 1991. Ky fakt është vështirë të vlerësohet nga perspektiva aktuale, por domosdo shtrohet pyetja se pse ka ndodhur kjo nguti. Të gjitha këto procedura ishin të rregulluara me ligjet e atëhershme që u sqaruan më lartë, dhe do të sqarohen në vijimin e këtij arsyetimi.

43 Çështje tjetër kontestuese, që nuk është vërtetuar nga paditësi, është fakti se, si është e mundur që të gjitha këto veprime të këshillit punëtorëve, sa i përket shitblerjes së aksioneve është bërë përkundër masave të dhunshme të aplikuara nga Kuvendi i Serbisë për këtë ndërmarrje, një ditë pasi që ky transformim ishte regjistruar në Gjykatën

Ekonomike të Gj., më 21 qershor 1991, ku udhëheqësit aktual ishin zëvendësuar me udhëheqës të imponuar nga pushteti serb. Në ankesë ankuesi thekson se, “me lëshimin e masave të përkohshme nga Serbia, lëshimi i aksioneve si dhe funksionimi i këtyre ndërmarrjeve ishte ndërprerë. Si rezultat i kësaj, blerja e aksioneve nuk kishte përfunduar në tërësi”. Përkundër këtij fakti shumë të rëndësishëm që e pranon edhe vetë ankuesi, ajo pretendon se është kryer transformimi.

Madje në arsyetimin e bërë në ankesë lidhur me pagesën e aksioneve, paditësi thekson se pagesa është bërë në bazë të ndalimit të të ardhurave, duke i rritur të ardhurat në mënyrë enorme. Kjo është mjaftë sfiduese dhe dyshuese, sepse në kohën kur kemi një menaxhment të ri, si është e mundur që këto të rriten të ardhurat dhe të organizohet shitblerja e aksioneve nga një menaxhment inekzistent, gjegjësisht, kush ka qenë kompetent për rritjen e pagave dhe për shitjen e aksioneve.

Sa i përket pagesave të pretenduara të aksioneve për mbi 58 për qind, kjo nuk është dëshmuar, pos me disa shënime të shkruara në mënyrë manuale, por edhe kompjuterike, pa asnjë element sigurues dhe zyrtar që mund ta bindte gjykatën se vërtet këto pagesa janë kryer. Këto shënime kompjuterike, ishin të titulluar, “Libri i aksioneve për vitet 1990 dhe 1991. Ky dokument dëshmon se është në kundërshtim me vendimet për transformimin e pronës shoqërore në shoqëri aksionare të marrë më 30 prill 1991 dhe vendimin e Gjykatë Ekonomike të Gj. të datës 20 qershor 1991, sepse nuk ka mund të ketë aksione në vitin 1990, (në mënyrë retroaktive) derisa kjo ndërmarrje as që kishte filluar transformimin në SHA. Në anën tjetër, kjo procedurë e pagesave është përfunduar për pak më shumë se një vit, edhe pse është paraparë që kjo të zgjas së paku 10 vjet. Edhe këto aspekte determinojnë qëndrimin se ky proces nuk ka mund të jetë i rregullt dhe i bazuar në ligj.

Në nenin 4 të Vendimit për emetimin e aksioneve interne thuhet ndër të tjera se,

Ndërmarrja Shoqërore, tani shoqëri aksionare në pronësi të përzier, emeton 736 akcione interne prej ... din, të cilat thirren në emër, me të drejtë të blerjes në të njëjtën kohë të aksioneve nga ana e;

1. *Punëtorëve të punësuar në ndërmarrje*
2. *Punëtorëve që kanë punuar në ndërmarrje më shumë se dy vjet, respektivisht punëtorëve të pensionuar të ndërmarrjes, të cilët para se të dalin në pension, kanë punuar më shumë se dy vjet*

3. *Personave të tjerë fizik*
4. *Organizatave të sigurimit pensional dhe invalidor.*

- 47 Nga procesverbali i seancës dëgjimore shihet se në pyetjen e gjyqtarit se, sa punëtorë ka pasur kjo ndërmarrje të punësuar, paditësi përgjigjet, “aq sa ka aksionarë”, që do të thotë 185 të punësuar. Nëse është ashtu, këtu janë përjashtuar nga e drejta e ndarjes së aksioneve për pensionistët, personat e tjerë fizikë dhe organizatat e sigurimit pensional, siç ishte paraparë me vendimin e lartëcituat. Kjo do të thotë se kemi një veprim në kundërshtim me vetë vendimin për emetimin e aksioneve interne.
- 48 Meqenëse në nenin 4 të këtij vendimi thuhet se kjo SHA emeton 736 aksione, në nenin 7 të këtij vendimi thuhet se, “numri i përgjithshëm i aksioneve të emetuara është 898 copë”, që bie në kundërshtim me numrin paraprak të përcaktuar në nenin 4.
- 49 Në nenin 7 [të këtij Aktvendimi] janë caktuar edhe elementet e aksioneve, ndër të cilat janë edhe: emërtimi i blerësit të aksionit, shënimin se është aksion me emër apo për prurësin, afatin e pagesës së dividendës.
- 50 Në shkresat e lëndës nuk ka të dhëna për aksionet e emetuara, e aq më pak emrat e blerësve të aksioneve apo afatin apo edhe modelin e pagesës së dividendës. Në shkresat e lëndës gjendet vetëm një Aksion intern dhe kupon për pagesë të dividendës të nënshkruar nga “Drejtori kryesor” dhe të vulosur, por pa asnjë emër që do të kuptonte se në emër të kujt është bërë kjo pagesë eventuale. Sipas nenit 8 të vendimit për emetimin dhe lëshimin e aksioneve interne, sipas bazës së pagesës së të ardhurave thuhet se, “pagesa e dividendës bëhet në arkën e ndërmarrjes, ku punëtori është i obliguar që për këtë të paraqes kuponin për pagesën e dividendës”. As për këtë nuk ka asnjë dëshmi, që e bënë këtë proces jo të përfunduar dhe jo të plotë.
- 51 Në nenin 11 [të këtij Aktvendimi] thuhet se procedura e shitjes dhe e pagesës së aksioneve duhet të përfundoj në tërësi brenda 10 vjetësh.
- 52 Neni 16 [i këtij Aktvendimi] thotë se pagesa mund të bëhet përmes ndalesës së një pjese të të ardhurave personale të punëtorëve, drejtpërdrejtë në arkën e ndërmarrjes, ose në gjyrollogarinë e ndërmarrjes që evidentohet në shërbimin e Kontabilitetit shoqëror në Gj.

Madje në pikën 9 të Thirrjes për regjistrim dhe blerje të aksioneve interne, thuhet se pagesa e aksioneve interne, të blera dhe të regjistruara do të bëhen në dinarë, në këste mujore për 10 vjetët e ardhshme, duke filluar nga data e lidhjes së kontratave të shitblerjes së aksioneve interne. **53**

Nuk ka dëshmi që kjo pagesë të jetë bërë konform vendimeve që kanë pasuar transformimin dhe konform ligjeve që kanë qenë në fuqi në këtë kohë, madje nuk ka asnjë dëshmi që të jetë bërë regjistrimi i këtyre aksioneve të blera. Megjithatë, paditësi pretendon se ky proces është përfunduar, madje është paguar më shumë se sa që është dashur, edhe atë brenda një viti. Megjithatë, pos deklaratave, i takon paditësit që të dëshmoj se procesi i transformimit ka ecur në mënyrën e duhur ligjore, sepse barra e të provuarit edhe ligjërisht bie mbi paditësin. **54**

Raportet e AKM-së dhe të AKP-së

Paditësi e përdorë një analizë apo raport i përgatitur nga një ekip prej tre personave të cilët vepruan në emër të AKM-së, nga viti 2002, si dëshmi për përfundimin e procesit të transformimit të ndërmarrjes. Me këtë raport 17 faqesh pretendohet se procesi i transformimit tashmë ishte kryer dhe se mbi 58 për qind të aksioneve tashmë kanë kaluar në pronarë privat. Ky raport ka duket se ka shërbyer edhe për parashtrimin e padisë së paditësit. Siç ka vlerësuar edhe Kolegji i Specializuar, “kjo deklaratë në të vërtetë mund të trajtohet si pëlqim i pjesshëm për padinë nga ana e AKM-së, por ky pëlqim as nuk është dëshmi dhe as nuk është i detyrueshëm për gjykatën ose për të paditurën e mbetur, AKP-në”. **55**

Kolegji i Apelit, pasi që e ka analizuar këtë raport, ka gjetur se raporti është vetëm një vështrim privat, i pa autorizuar i disa të ashtuquajtur avokatë [ekspertë] të AKM-së, dhe asnjëherë nuk iu është njohur [që ka] vlera e një ekspertize që do të mund të caktohej nga gjykata. Pos tjerash raporti është i përgjithësuar dhe nuk ka vlerësim, gjegjësisht rekomandim specifik për të paditurën “E”, madje nuk përmendet askund me emër.

Në anën tjetër, në dosje të lëndës kemi edhe një raport të AKP-së, i hartuar nga një grup ekspertësh të caktuar nga AKP, i datës 15 tetor 2010, i cili është krejtësisht i kundërt me atë të AKM-së. Në të ndër të tjera thuhet në procedurat për transformimin e kësaj ndërmarrje ka pasur shumë të meta të cilat e kanë bërë procesin të pasuksesshëm. Në këtë raport përmenden mungesa e vlerësimit të vlerës së kapitalit sho- **56**

qëror konform ligjeve të kohës, nuk ka dëshmi për pagesën e aksioneve, duke e shfrytëzuar llogarinë bankare, siç parashihet me LN (77/88, neni 94 dhe 100), nuk ka asnjë dokument financiar që do të dëshmonte për transformimin financiar nga NSH në SHA, nuk është gjetur asnjë dëshmi për investimet në ndërmarrje, si rezultat i shitjes së kapitali. Është e qartë se mbrojtjen e vetë në këtë lëndë, AKP e ndërton pikërisht nga gjetjet e këtij raporti.

57 Duke i analizuar këto raporte kundërtënëse të paraardhësit dhe pasardhësit të administratorit të NSH-ve, gjykata konsideron se asnjëra e as tjetra nuk e kanë vlerën valide të dëshmisë, përkundër faktit se raporti i AKP-së është më i qartë dhe më konkret, i bazuar konkretisht në mungesën e respektimit të plotë të procedurave ligjore, për transformim të ndërmarrjes.

Vendimi i Gjykatës Ekonomike të Gj.

58 Ankuesi pretendon se Gjykata Ekonomike e Gj. me vendimin e vet ka konfirmuar se procesi i transformimit ishte përfunduar, sepse para se të merrej vendimi i tillë, gjykata, bazuar në dokumentet e pakontestueshme ligjore me të cilat paditësi posedon, ka vlerësuar ose është dashur të vlerësojë nëse transformimi kishte përfunduar.

59 Kolegji i Ankesave Konsideron se Vendimi i Gjykatës Ekonomike të Gj. ishte i bazuar në ligjet e atëhershme, sepse ajo vendosi për kushtet ligjore të fillimit të procesit të transformimit. Megjithatë, nuk ka vlerësim gjyqësor nëse janë plotësuar kriteret tjera për transformim të plotë, gjegjësisht nuk ka vlerësim për rrjedhën e procedurës, pas vendimit gjyqësor të marrë më 20 qershor 1991. Nuk mund të jetë ky vendim gjyqësor tregues se kjo procedurë është [ka] përfunduar me sukses. Andaj referimi që ankuesi i bënë këtij vendimi, nuk është determinues për DHPGJS, sepse ky vendim nuk është tregues i rrjedhjes së plotë [e saktë: zinxhirit të veprimeve] dhe respektimit të procedurave, të zhvilluara më vonë në këtë ndërmarrje. Vendimi i kësaj gjykate për më tepër tregon për emërtimin transitor të kësaj ndërmarrje, si NSH dhe SHA, dhe nuk ka referenca futuriste për rrjedhën e procesit për kompletimin e transformim që është dashur të bëhet duke u bazuar në ligjet e asaj kohe.

60 Në fund të fundit, provat tjera të cilat janë në shkresat e lëndës, mungesa e vlerësimit të kapitalit shoqëror, mungesa e dëshmimeve për

shitblerjen e aksioneve, tregojnë se ky proces ka ngelur që në fillim të procesit të transformimit, gjegjësisht që nga momenti i futjes së masave të dhunshme në këto ndërmarrje. Të gjitha përpjekjet tjera për të dëshmuar me disa prova se ky proces është [ka] përfunduar, janë më shumë tregues dhe prova fiktive, të cilave gjykata nuk ua jep besimin ligjor.

Andaj, në bazë të këtyre arsyeve dhe në bazë të nenit 10.10 të LD-HP-së u vendos si në dispozitiv.

61



16.

Papranueshmëria a ankesës së parashtruar kundër Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës së rregullt

Aktgjykimi i formës së prerë; Aktvendimi i formës së prerë; Aktvendimi i gjykatës së rregullt; Pranueshmëria e ankesës; Papranueshmëria; Mjet i jashtëzakonshëm juridik

LPK neni 17, 18, 19, 182.2(f), 245, 232, 214.4, 194; Rreg. e UNMIK-ut 2008/4 neni 4

- 1. Ankesa kundër Aktgjykimit apo Aktvendimit të plotfuqishëm të gjykatës së rregullt është e papranueshme.**
- 2. Aktgjykimet apo Aktvendimet e plotfuqishme të gjykatave të rregullta mund të kundërshtohen vetëm përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike.**

Aktvendimi i datës 4 dhjetor 2014 – AC-II-14-0015 (Lënda A: Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në P. i datës 18 shkurt 2009 – C.nr.192/08; Lënda B: Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në P. i datës 11 shtator 2009 – Ac.nr.255/2009)

- 1 Rrethanat faktike dhe procedurale:** Me 25 mars 2008, paditësi parashtroi padi në Gjykatën Komunale të P., duke kërkuar nga e paditura njohjen e së drejtës pronësore për ngastrën kadastrale nr. ..., e regjistruar në fletën poseduese nr. ..., ZK – P., në vendin e quajtur “V. A.”.
- 2** Me 11 shtator 2009 [e saktë: 18 shkurt], Gjykata Komunale në P. ka lëshuar Aktgjykimin C.nr.192/08 me të cilin kërkesa e paditësit ishte miratuar, me arsyetimin se paditësi e ka fituar këtë të drejtë në bazë të parashkrimit fitues, sepse paditësi e ka në posedim pa asnjë pengesë këtë paluajtshmëri që nga viti 1972. Këtë vendim kjo gjykatë e ka marrë pasi që ka administruar një sërë provash, të cilat nuk janë kontestuar nga askush.

- Me 4 maj 2009, e paditura ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në P., përmes Gjykatës Komunale të P. **3**
- Me 11 shtator 2009, Gjykata e Qarkut në P. ka lëshuar Aktgjykimin Ac.nr. 255/2009 me të cilin e ka refuzuar ankesën e lartpërmendur si të pabazuar. Sipas arsytimit të këtij Aktgjykimi, nuk janë konstatuar asnjë shkelje e dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat ka pretenduar ankuesi. **4**
- Me 6 tetor 2009, të paditurës ... i është dorëzuar Aktgjykimimi i Gjykatës së Qarkut në P. **5**
- Me 20 tetor 2009, AKP si administruese e NSH-së, ka parashtruar ankesë në DHPGJS, duke kërkuar që të anulohen Aktgjykimet e gjykatave të rregullta, pasi që ato janë lëshuar nga organet jo-kompetente. **6**
- Në ankesë thuhet se me vendimet e tyre, Gjykata Komunale dhe e Qarkut në P. kanë vendosur në mungesë të juridiksionit dhe në këtë mënyrë kanë bërë shkelje të nenit 17, 18, 19 dhe të nenit 182.2(f) të LPK-së dhe dispozitat e nenit 4 të Rreg. së UNMIK-ut 2008/4. Këto gjykata kanë qenë të obliguara ex officio që ta shpallin veten jokompetente për të gjykuar në këtë çështje **7**
- Me 19 nëntor 2009, Gjyqtari Kryesues i Trupit Gjykses së DHPGJS-së ka lëshuar një urdhër duke kërkuar nga Gjykata Komunale e P. dosjen e lëndës. C.nr 192/08, dhe më 3 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në P. ia ka dorëzuar DHPGJS dosjen e lëndës C.nr.192/08. **8**
- Me 5 mars 2010, paditësi ka dërguar përgjigjen e saj [tij] ndaj ankesës duke e konsideruar atë si të pabazuar. **9**
- Kolegji i Specializuar, pas shqyrtimit të dokumentacionit, të dispozitave të LDHP, si dhe Vendimet e Presidiumit të DHPGJS-së, në këtë lëndë konkrete përcaktoi se dosja e lëndës do të mbyllet dhe lënda i referohet Kolegjit të Apelit duke ia dhënë një numër të ri të dosjes. **10**
- Më 6 gusht 2014, Kolegji i Ankesave ia ka dërguar paditësit ankesën e AKP-së për përgjigje. Paditësi është përgjigjur në urdhër [për dorëzimin e ankesës] më 26 gusht dhe kishte deklaruar se ankesa e AKP-së bazo- **11**

het vetëm në parafrazim, por jo në baza juridike. Sipas paditësit, AKP ka qenë pjesë e seancave gjyqësore bashkë me të paditurën dhe i kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të goditjes, të lejuara me ligj. Megjithatë, ajo ka dështuar të ushtroj mjete të jashtëzakonshme juridike në afatin e paraparë ligjor. Mu për këtë, sipas paditësit, Aktgjykimi tashmë është i plotfuqishëm dhe për shkak të sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk mund të anulohet, edhe për faktin se edhe DHPGJS ka një qëndrim të tillë, duke parafrazuar Aktvendimin SCA-10-0036. Paditësi e njofton gjykatën edhe një herë se familja e tij, që nga viti 1971 e shfrytëzon këtë paluajtshmëri lëndore pa asnjë pengesë, ku edhe është ndërtuar shtëpia e tyre familjare. Paditësi potencon se vetë evidentimi i pronës në emër të NSH-së nuk përcakton pronësinë vetvetiu.

- 12 Paditësi ia ka bashkangjitur kësaj përgjigje edhe disa foto të shtëpisë dhe rrethojës së shtëpisë, që është shtëpi e vjetër, por edhe deklaratën e *R K*, i cili dëshmon se babai i tij e kishte blerë këtë pronë nga *N (I) M*, i cili më pas ia ka shitur *H (S) K*, por edhe një kopje të një kontrate të shkruar në serbisht, ku vërtetohet deklarata e dëshmitarit.
- 13 Më 6 gusht 2014 Kolegji i Apelit ia ka dërguar një urdhër edhe AKP-së me të cilin ka kërkuar që të provohet data se kur AKP është ftuar për të marrë pjesë në seancën gjyqësore të thirrur nga Gjykata Komunale e P. dhe kur e ka pranuar Aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut në P.
- 14 AKP më datë 20 gusht 2014 ka dërguar një përgjigje, duke deklaruar se AKP dhe e paditura në procedurat pranë Gjykatës Komunale të P. asnjëherë nuk është ftuar me rregull. Pos tjerash, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi në kohën e marrjes së vendimit, asnjë gjykatë e rregullt nuk ka pasur kompetencë[/juridiksion] të vendos lidhur me kontestet për pronat shoqërore pa iu referuar lënda nga DHPGJS.
- 15 Sa i përket kërkesës së Kolegjit të Apelit se kur është pranuar nga AKP Aktgjykimi i kundërshtuar, përgjigja është kjo: "... Aktgjykimi e mban vulën e pranimit të dt. 9 tetor 2009, por kjo nuk është me rëndësi, sepse përgjigja e AKP-së e datës 20 tetor 2009, ka të bëjë me juridiksion të gjykatave që kanë vendosur", dhe i sugjeron DHPGJS që të aplikoj nenin 4.5.1 të LDHP.

- Arsyetimi ligjor:** Ankesa është e papranueshme. 16
- Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP. 17
- “Ankesa” e AKP-së me të cilën kërkon anulimin e Aktgjykimit të formës së prerë nuk është e pranueshme, për faktin se kjo ankesë është parashtruar ndaj një Aktgjykimi të formës së prerë në gjykatat e rregullta. Aktgjykimet e formës së prerë sipas ligjit në fuqi, mund të atakohen vetëm me mjete të jashtëzakonshme juridike të goditjes. Në rastin konkret, ankesa e AKP-së nuk mund të interpretohet si çfarëdo mjeti i jashtëzakonshëm, në bazë të përmbajtjes së saj pasi që nuk ka përmbajtje të duhur që kërkohen për një mjet të tillë të goditjes. Ajo nuk mund të trajtohet si kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse një kërkesë të tillë, sipas ligjeve në fuqi, mund ta ngritë vetëm Prokurori i Shtetit (neni 245 i LPK-së). Kjo nuk mund të konsiderohet as si kërkesë për rihapje të procedurave në mungesë të bazës së paraparë me nenin 232 të LPK-së. Në fund, parashtrësja e AKP-së nuk mund të konsiderohet si revizion me çfarëdo mundësie për të pasur sukses për shkak se nuk janë dhënë bazat e cekura në Nenin 214.4 të LPK-së. Kjo për faktin se i padituri as nuk e ka ngritur çështjen e mungesës së juridiksionit në ankesën e tij në Gjykatës së Qarkut në P. e as nëse juridiksioni është çështje ligjore që ekzaminohet ex officio nga ana e gjykatës së shkallës së dytë (shih nenin 194 [të LPK] ku juridiksioni sipas nenit 182.2(f) [të LPK] nuk është theksuar).
- Andaj konform nenit 10.10 të LDHP, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi. 19
- Shënim i Redaktorit:** Ky Aktvendim më tej zhvillon jurisprudencën e themeluar me Aktvendimin ASC-10-0030.



Nuk ka juridiksion mbi Lëndët në Procedurë të Përmbarrimit

Procedura përmbarrimore; Juridiksioni

LDHP neni 4.1, 4.6; Rreg. e UNMIK-ut 2002/13 neni 4.3; Rreg. e UNMIK-ut 2008/4 neni 4.3; LGJ neni 18

1. Nëse një lëndë bie në juridiksionin e DHPGJS-së ose jo, për këtë vendos ekskluzivisht DHPGJS-ja në bazë të nenit 4.6 të LDHP-së.
2. DHPGJS-ja nuk është kompetente të vendos lidhur me çështjet në procedurën përmbarrimore.

Aktvendimi i datës 5 shkurt 2015 – AC-II-14-0047 (Shkalla e parë: Aktvendimi i Gjykatës Komunale në P. i datës 2 dhjetor 2011 – E.nr.1366/11)

- 1 **Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike:** Më 14 korrik 2011, kreditori ka parashtruar propozimin për lejimin e ekzekutimit [përmbarrimit] të dhunshëm të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në P. C.nr. ... të datës 2 tetor 1991, dhe të obligohet e paditura gjegjësisht debitori “P E” në P., që në emër të realizimit [me qëllim të zbatimit] të kontratës mbi ndërrimin e paluajtshmërive OV.nr. ... të datës 3 korrik 1971, t’ia dorëzojë në shfrytëzim dhe posedim të lirë sipërfaqen prej ... ari, nga parcela kadastrale nr. ... ZK D.
- 2 Më 2 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në P., me Aktvendimin E.nr.1366/11 e ka hedhur poshtë propozimin për përmbarrim si të palejueshëm [të papranueshëm] të kreditorit R Sh kundër debitorit KBI “P E” P., duke konstatuar në dispozitiv se çështja është gjë e gjykuar res judicata. Gjyqtari përmbarrues në arsyetimin e Aktvendimit të ankimuar thekson se Aktgjykimi për të cilën po kërkohet përmbarrimi, është i pa përshtatshëm për përmbarrim.
- 3 Kundër këtij Aktvendimi me 30 dhjetor 2011, përfaqësuesja e paditësit/kreditorit ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në P., duke

kërkuar nga Gjykata e shkallës së dytë që të aprovohet ankesa si e bazuar, Aktvendimi i ankimuar të ndryshohet ose për të njëjtën lëndë të kthehet në rishqyrtim – ekzekutim [përmbarim] të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në P. C.nr. ... të datës 2 tetor 1991, të përfundohet procedura e ekzekutimit [përmbarimit] dhe debitori të pranohet obligimin e vet që del nga Aktgjykimi i plotfuqishëm.

Më 25 qershor 2012 Gjykata e Qarkut në P., i dorëzon në DHPGJS shkresat e lëndës AC.nr. ... dhe shkresat e lëndës të Gjykatës Komunale në P. E.nr.1366/2011, për të vendosur lidhur me ankesë. 4

Më datë 24 tetor 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e mbyll lëndën e kësaj ankesë të regjistruar si C-III-12-1101 dhe urdhëron Zyrën e Regjistrimit të regjistrojë lëndën për Kolegjin e Apelit e cila merr numrin AC-II-14-0047. 5

Kolegji i Apelit më urdhrin e datës 26 nëntor 2014, ankesën dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës/debitorës për të dhënë përgjigje në ankesë. 6

Në përgjigjen në ankesë e paditura/debitorja në tërësi e kundërshton ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj. AKP-ja e mbështet në tërësi Aktvendimin E.nr.1366/11 të datës 2 dhjetor 2011, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. E paditura nuk e ka të qartë se në çfarë raporti statusor qëndron paditësi me paraardhësin e tij. Padia është parashtruar në kundërshtim me parimin procedural “legjitimacio ad causam”. Paditësi nuk ka legjitimitet aktiv në procedim të çështjes gjyqësore sepse nuk ka dëshmuar se është trashëgimtar i paraardhësit të tij. Sipas të paditurës, ankesa e parashtruar përmban shkelle procedurale të Shtojcës së LDHP, të përcaktuar me nenin 27.2 (e), si dhe nenit 253, të LPK-së, pasi që ankesa nuk përmban elementet thelbësore të cilat duhet t’i përmbajë ankesa, nuk përmban argumentet ligjore në të cilat mbështetet kërkesëpadia. E paditura nuk e ka të qartë se për çfarë ngastre kontestues[e] bëhet fjalë, sepse paditësi nuk e ka bashkangjitur kontratën mbi të cilën pretendon të realizojë të drejtën. Po ashtu e paditura pohon se ankesa është parashtruar në kundërshtim me parimin res judicata. Andaj i propozon Gjykatës që ankesën ta hedhë poshtë si të palejueshme dhe të vërtetoj Aktvendimin C.nr. ... të datës 2 tetor 1991. 7

8 **Arsyetimi ligjor:** Kolegji i Apelit nuk është kompetent për shqyrtimin e ankesës.

9 Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Mungesa e kompetencës të Dhomës së Posaçme për shqyrtimin e ankesës

10 Gjykata Komunale në P., me Aktvendimin E.nr.1366/11 të datës 2 dhjetor 2011, e ka hedhur poshtë propozimin për përmbarim të Aktgjykimit të plotfuqishme të Gjykatës Komunale në P. C.nr. ... të datës 2 tetor 1991 si të palejueshëm [papranueshëm] të kreditorit *R Sh* kundër debitorit KBI “*P E*” P., duke konstatuar se çështja është gjë e gjykuar res judicata.

11 Gjykata e Qarkut në P. më datë 25 qershor 2012, ankesën e paditësit/kreditorit të paraqitur kundër Aktvendimit të ankimuar E.nr.1366/11 të datës 2 dhjetor 2011 si dhe shkresat e lëndës AC.nr. ... dhe shkresat e lëndës të Gjykatës Komunale në P. E.nr.1366/2011, i ka dorëzuar në DHPGJS për të vendosur lidhur me ankesën.

12 Në bazë të nenit 4.1 të LDHP, DHPGJS-ja nuk është kompetente të vendos lidhur me çështjet në procedurën përmbarimore.

13 Kolegji i Apelit vlerëson se neni 4.3 i Rreg. së UNMIK-it nr.2002/13, lidhur më nenin 4.3 të Rreg. së UNMIK-ut 2008/4, së cilave dispozita ju referohet Gjykata e Qarkut në P., nuk ka të bëjë me mjetet e rregullta juridike të goditjes, përfshirë edhe ankesën e cila në këtë rast është paraqitur ndaj një Aktvendimi procedural të Gjykatës Komunale në P. në procedurën përmbarimore. Dosja asnjëherë nuk ishte e referuar nga DHPGJS-ja, andaj kjo dispozitë të cilës i referohet ish Gjykata e Qarkut në P. nuk është e aplikueshme në këtë rast.

14 Nëse një lëndë bie ose jo në jurisdiksionin e DHPGJS-së për këtë vendos ekskluzivisht DHPGJS-ja në bazë të nenit 4.6 të LDHP-së. Sipas kësaj dispozite ligjore është e qartë se DHPGJS-ja ka autoritetin ekskluziv për të vendosur nëse një lëndë specifike bie brenda jurisdiksionit të saj. Andaj autoriteti përfundimtar për ta zgjidhur çështjen e kompetencës, në bazë të dispozitës së nenit 4.6 të LDHP-së, është DHPGJS-ja.

Në këtë rast pasi që është një çështje përmbarimore, Kolegji i Apelit ka vendosur që lënda të kthehet në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit në bazë të nenit 18 të LGJ, është kompetente ta shqyrton ankesën e kreditores të paraqitur ndaj Aktvendimit të ankimuar të Gjykatës Themelore në P. i nxjerrë në një procedurë përmbarimore.

15

Me sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv.

16

⌋⌋⌋

18.

Ligji i aplikueshëm për ankesat kundër Aktvendimeve të Autoritetit të Likuidimit/Parashkrimi

Aktvendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së; Ligj special (lex specialis); Parashkrimi; Paga e papaguar; Letra informuese; Ligji i Aplikueshëm; Procedura e Likuidimit

Ligji për AKP-në2011; LDHP neni 10.4.1; Ligji mbi Punën e Bashkuar neni 608; Reg. e UNMIK-ut 1999/24 neni 1; LN

1. Për ankesat kundër vendimeve të autoritetit të likuidimit në lidhje me kërkesat për rrogat e papaguara, Ligji për AKP-në 2011, i cili rregullon procedurën e likuidimit dhe përmbushjen e kërkesave kreditore, është ligj special (lex specialis) dhe dominon ndaj dispozitave të parashkrimit të Ligjit të Punës së Bashkuar që është ligj i përgjithshëm (lex generalis).
2. Shkresa përmes së cilës APK-ja i njofton punëtorët për ndërprerjen e punësimit dhe se rrogat e papaguara mbesin përgjegjësi e punëdhënësit, pezullon parashkrimin.

Aktvendimi i datës 4 mars 2015 – AC-I.-14-0323 (Shkalla e parë: Aktgjykimi i datës 25 shtator 2014 – C-IV.-14-1201)

- 1 **Rrethanat procedurale dhe faktike:** Me datë 9 korrik 2013, paditësi *S B* nga *P.* ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit për *NSH 'D'* (në likuidim), nr. PRN... të datës 6 qershor 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej ... euro.
- 2 Me datë 25 shtator 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1201 e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e ka shfuqizuar vendimin e AKP-së/Autoritetit të Likuidimit PR ... të datës 6 qershor 2013. Me këtë Aktgjykim është obliguar e padi-

tura që ankuesit *SB* në emër të kompensimit për pagat e papaguara për periudhën mars – nëntor 2006 të paguajë shumën prej ... euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se ankesa e paditësit është e bazuar dhe duhet të shfuqizohet vendimi i ankimuar i AKP-së pasi që ankuesit pa ndonjë arsye të bazuar i është refuzuar kërkesa e tij për pagesën e pagave të papaguara dhe arsyet nuk ishin të bazuara dhe të pranueshme për Gjykatën. Më tutje Kolegji i Specializuar arsyeton se arsyet janë të paqarta dhe të pakuptueshme për palët. Sipas Kolegjit të Specializuar e paditura AKP në mbrojtjen e saj ndaj ankesës dhe në kundër përgjegjjen e parashtruar ndaj përgjegjës së ankuesit nuk e ka kontestuar faktin se ankuesi ka punuar në NSH në periudhën kohore mars –nëntor 2006, deri kur ankuesi me njoftimin e AKP-së të datës 17 nëntor 2006 i është ndërprerë marrëdhënia e punës pranë NSH-së. Përmes këtij njoftimi ankuesit i ishte bërë me dije se pagat që janë mbetur borxh sipas kontratës së punës me punëdhënësin, mbesin për tu shqyrtuar në procedurën e likuidimit, për çka edhe do të njoftoheni kur të fillojnë këto procedura. Më tutje Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se nuk e ka pranuar mbrojtjen e AKP-së/Autoritetit të Likuidimit se kërkesa e paditësit është e parashkruar duke mos qenë e dorëzuar ajo kërkesë në ndonjë Gjykatë në afatin prej 3 viteve, dhe as qëndrimin e të paditurës se duhet të aplikohet neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar. Kësaj mbrojtje të paditurës Kolegji i Specializuar i përgjigjet me mendimin se Ligji për AKP-në2011 është ligj special (*lex specialis*) dhe Shtojca e tij dhe se me këtë ligj është rregulluar procedura e likuidimit dhe mënyra e përmbushjes së kërkesave kreditore, pra edhe të punëtorëve të NSH-së nën likuidim.

Me datë 24 tetor 2014, e paditura dorëzon një ankesë ndaj vendimit të Kolegjit të Specializuar C-IV-14-1201 të datës 25 shtator 2014, të cilin Aktgjykim e konteston edhe mbi baza procedurale dhe mbi baza të meritës. E paditura me ankesë pretendon se historiku procedural i përshkruar në Aktgjykimin e ankimuar është i pasaktë, dhe si rrjedhim i kësaj përfundimet e Kolegjit të Specializuar janë të gabuara dhe se sipas të paditurës ky Aktgjykim ka dështuar ti përmbushë kërkesat e nenit 10.4.1 të LDHP. E paditura për më tepër në ankesë e konteston Aktgjykimin e ankimuar edhe lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelin e lëndës. E paditura pretendon se ishte i gabuar qëndrimi ligjor i Kolegjit të Specializuar se nuk mund të zbatohet neni 608 i Ligjit për

3

4

Punën e Bashkuar i cili sipas të paditurës është ende në fuqi në bazë të Rreg. së UNMIK-ut 1999/24 (neni 1). E paditura në ankesë e konteston qëndrimin ligjor të Kolegjit të Specializuar se në këtë rast nuk mund të flitet për parashkrimin e kërkesës. E paditura përsërit prapë se bëhet fjalë për një kërkesë të paditësit e cila është e parashkruar dhe se paditësi nuk ka sjellë dëshmi se ka kërkuar nga ndonjë Gjykatë realizimin e kërkesës për pagat e papaguara. Sipas të paditurës letra e dërguar paditësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës flet se ankuesi është njoftuar vetëm për të drejtën e tij që të aplikoj për 20% nga të ardhurat e privatizuara dhe kjo letër nuk ka ndikim në çështjen e pagave dhe pretendon se nuk është i drejtë konstatimi i Kolegjit të Specializuar se me këtë letër është vënë në dijeni paditësi se do të shqyrtohen kërkesat e tij për paga [të papaguara] në bazë të kontratës së punës pas fillimit të likuidimit të NSH-së. E paditura i kërkon Kolegjit të Apelit që ta shfuqizojë Aktgjykimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar, ose ta gjykojë rastin mbi themelin [e saktë: në merita] dhe të refuzojë ankesën e paditësit kundër vendimit të autoritetit të likuidimit ose të vërtetojë vendimin e Autoritetit të Likuidimit të NSH-së 'D'.

5 Me datë 24 nëntor 2014, paditësi paraqet përgjigje në ankesë me të cilin kërkon nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër në përgjigjen në ankesë paditësi deklaron se më nuk është në zbatim Ligji mbi Punën e Bashkuar i cili është shfuqizuar me LN, andaj e konteston pohimin e të paditurës se bëhet fjalë për parashkrimin e kërkesës në kuptim të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Paditësi deklaron se përfundimet dhe arsyetimet ligjore të Kolegjit të Specializuar janë të sakta andaj Aktgjykimi i ankimuar duhet të vërtetohet.

6 **Arsyetimi ligjor:** Ankesa është e pranueshme por e pabazuar.

7 Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

8 Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit
Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vlerëson se përfundimet e arritura dhe arsyetimet ligjore të cilat i ka përdorë Kolegji i Specializuar në Aktgjykimin e animuar janë të sakta dhe ato si të tilla i pranon edhe Kolegji i Apelit. Padiësi me kërkesën e tij drejtuar Autoritetit të Likuidimit kërkon pagat e papaguara nga muajt mars-nëntor 2006. Fakti i punësimit të padiësit dhe i mos pagesës së pagave të tij për këtë periudhë nuk kontestohet nga asnjëra palë. E paditura e mbron qëndrimin se kërkesa e padiësit për këto paga është e parashkruar në kuptim të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, mirëpo kjo arsye e përdorur në vendimin e vet kur e ka refuzuar kërkesën nuk është e saktë. Letra e datës 17 nëntor 2006 të cilën e paditura ia ka dërguar padiësit e njofton padiësin për ndërprerjen e punësimit në ditën e shitjes së NSH-së, 17 nëntor 2006 dhe e njofton gjithashtu padiësin se pagat të cilat u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit për të cilat do të njoftoheni. Kjo letër në fakt e njofton padiësin se mbetet përgjegjësi e punëdhënësit që duhet të merret me pagat e punëtorëve nëse ato nuk janë paguar. Nga këto arsye del që saktë ka vendosur Kolegji i Specializuar kur e ka aprovuar ankesën e padiësit si të bazuar dhe ka shfuqizuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit për arsyet e cekura në Aktgjykim të cilat arsye pranohen edhe nga Kolegji i Apelit.

Kolegji i Apelit nuk pajtohet me pretendimin e të paditurës se Aktgjykimi i ankimuar ka historik procedural të pasaktë dhe se për shkak të kësaj gabimisht janë ardhur përfundimet dhe arsyetimi i Kolegjit të Specializuar. Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar nuk ka shkelur nenin 10.4.1 të LDHP-së siç pohon e paditura në ankesë pasi që janë dhënë arsye dhe shtjelluar çështjet në mënyrë të qartë dhe bindëse për palët. E paditura edhe në ankesë e ka ngritur çështjen e parashkrimit të kërkesës së padiësit. Kolegji i Apelit vlerëson se parashkrimi i kërkesës nuk është e aplikueshme për këtë rast, pasi që ligji mbi AKP-në i cili rregullon procedurën e likuidimit dhe mënyrën e përmbushjes së kërkesave të kreditorëve si Ligj special duhet të zbatohet në këtë rast në raport me Ligjin për punën e bashkuar i cili është ligj i përgjithshëm. Kolegji i Apelit nuk pajtohet me pohimin e të paditurës se letra informuese e datës 17 nëntor 2006 dërguar padiësit ka pasur karakter të njoftimit vetëm për të drejtën për 20%. Kjo letër nuk flet shprehimisht për të drejtën për 20% megjithëse kjo mund të nënkuptohet

[në mënyrë të tillë] por flet edhe për pagat dhe kërkesat tjera kreditore që mund ti ketë paditësi ndaj NSH-së nën likuidim. Andaj për këto arsye nuk është i pranueshëm pohimi i të paditurës se kjo letër nuk ka ndikim në realizimin e të drejtës në pagë të paditësit që ka mbetur e papaguar nga NSH-ja.

- 11 Mbi bazën e këtyre arsyeve e në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

⌋⌋⌋

Aspektet procedurale dhe materiale të procedurave që merren me diskriminimin e punëtorëve të NSH-ve

Diskriminimi; SCEL; Lista e punëtorëve; Lista e përkohshme; Punëtorët shqiptarë; Punëtorët serbë; Trajtim i barabartë; Minoritet; Masat e dhunshme; Lista përfundimtare; Entitet; Papranueshmëri; Dështimi për të kundërshtuar listën e përkohëshme; Barra e provës

Rreg. së UNMIK-ut 2003/13 (e ndryshuar me Rreg. e UNMIK-ut 2004/45) neni 10.4 i; Ligjit kundër Diskriminimit 2004/3 (i miratuar më 30 korrik 2004, shpallur me Rreg. e UNMIK-ut 2004/32) neni 8, 8.1; Ligji mbi Mardhëdhëniet e Punës në Rrethana të Jashtëzakonshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 40/90); Ligji mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore (publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Serbisë Nr. 49 i datës 28 tetor 1989), i cili nuk është i aplikueshëm, pasi që përmban elemente diskriminuese, siç parashihet në Rreg. e UNMIK-ut 1999/24; UA e UNMIK-ut 2008/6 neni 67.2

1. Një ankues, për të pohuar diskriminimin ndaj mos përfshirjes në listën përfundimtare të punëtorëve të një NSH-je, duhet vetëm të përcaktojë faktet e veçanta nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim – të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.
2. E kundërta e barrës së provës kërkon nga i padituri që të provojë të kundërtën, d.m.th. se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
3. Personat që supozohet se i janë nënshtruar diskriminimit janë punëtorët të cilët nuk janë përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta për të përfituar një pjesë nga 20% e të ardhurave për shkak të përkatësisë së tyre etnike, besimeve politike dhe fetare. Varësisht nga periudha, ata ishin në veçanti:

- a) punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, ashkali, romë, egjiptian, goran dhe turq, të cilët ishin pushuar për shkaqe diskriminuuese në periudhën prej vitit 1989 dhe 1999 dhe
- b) punëtorët e përkatësisë etnike serbe, të cilët nuk janë paraqitur në punë pas qershorit të vitit 1999.

4. Dështimi për të kundërshtuar listën e përkohshme nuk e bën një ankesë kundër listës përfundimtare të papranueshme.

*Aktgjykimi i datës 12 mars 2015 – AC-I-14-0023 (Shkalla e parë):
Aktgjykimi i datës 14 janar 2014 – C-II-13-0040)*

- 1 **Rrethanat faktike dhe procedurale:** NSH “Gj” në D., është privatizuar nga AKP-ja më 6 nëntor 2006.
Lista e përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar 20 për qind nga privatizimi i NSH-së, ishte publikuar më 11 prill 2013 dhe data e fundit për dorëzimin e ankesave në AKP kundër listës së përfundimtare, ishte 4 maj 2013.
- 2 Më 14 janar 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS ka marrë Aktgjykimin C-II-13-0040 dhe ka vendosur që:
- 3 I. Ankesat e ankuesve të cekur më poshtë, aprovohen si të bazuara. Këta ankues duhet të përfshihen në Listën Përfundimtarëve të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20%-it nga privatizimi i NSH “Gj”, në D.[:.] 1. *I G* (C 0004), 2. *S (I) M* (C 0005), 3. *M B* (C 0009), 4. *R (R) T* (C 0020),
- 4 II. Ankesat e ankuesve të cekur më poshtë, refuzohen si të pa bazuara: *I I* (C 0001), *B (D) G* (C 0002), *I Q* (C 0003), *N (M) M* (C 0007), *K H* (C 0008), *Sh (Xh) R* (C 0011), *Z (S) B* (C 0012), *N K* (C0013), *X (U) I N* (C 0014), *G (I) F* (C 0015), *K (H) B* (C 0016), *R (I) Q* (C 017), *T (S) H* (C 0018), *H (Z) T* (C 0019), *R O-D.* (C 0021), *Xh (S) V* (C 0022), *S C-M* (C 0023), *S T* (C 0024), *R Sh* (C 0025), *M B* (C 0026), *S N* (C 0027), *H I* (C0028), *M L* (C 0029), *H I* (C 0030), *J O* (C 0031), *M T* (C 0032), *N G* (C 0033), *N P* (C 0034), *A T* (C 0035), *Z U* (C 0036), *I D* (C 0037), *R R* (C 0038), *S N* (C 0039), *R K* (C 0040), *A (A) A* (C 0041), *I (H) L* (C 0042),

HA (C 0043), *IB* (C 0044), *MJ* (C 0045), *K(U)M* (C 0046), *Xb(B)J* (C 0047), *A(T)I* (C 0048), *R(D)M* (C 0049), *Xb(S)A* (C 0050), *Z(S)I* (C 0051), *X(A)C* (C 0052), *B(S)S* (C 0053), *D(S)C* (C 0054), *C(B)IL* (C 0055), *K(M)D* (C 0056), *EL* (C 0057), *K(H)B* (C 0060), *B(R)D* (C 0061), *N(A)F* (C 0062), *Xb(S)N* (C 0063), *SG* (C 0064), *H(H)B* (C 0065), *H(I)K* (C 0066), *T(B)H* (C 0067), *L(M)O* (C 0068), *A(U)M* (C 0069), *D(I)T* (C 0006), *M(H)O* (C 0010).

III. Ankesat e ankuesve: *MG* (C 0059), *TD* (C 0070), *MSh* (C 0071), *HH* (C 0072), *G(T)F* (C 0058), hedhen poshtë si të pa afatshme. **5**

Me [korekt: në] Aktgjykimin e ankimuar, Kolegji i Specializuar i DHPGJS, ankesat e ankuesve nga pika e I-rë e dispozitivit i aprovon si të bazuara dhe vendos që këta ankues të përfshihen në listën përfundimtare, për shkak se këta ankues kishin pohuar se kanë qenë të diskriminuar dhe e paditura nuk ka arritur të dëshmojë me ndonjë provë se nuk ka qenë i shkelur parimi i trajtimit të barabartë të punëtorëve të NSH-së dhe mbi këtë bazë Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ka vlerësuar se këta ankues i kanë plotësuar kushtet nga neni 10.4 i Rreg. së UNMIK-ut 2003/13, e ndryshuar me Rreg. e UNMIK-ut 2004/45, për të hyrë në listën përfundimtare, për të drejtën legjitime për 20%. **6**

Kolegji i Specializuar në pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar i ka refuzuar ankesat e ankuesve të përfshirë në këtë pikë me arsyetimin se të njëjtit nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore në bazë të nenit 10.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2003/13. **7**

Kolegji i Specializuar në pikën III-të të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar ankesat i ka hedhur poshtë si të papranueshme, me arsyetimin se ankesat janë paraqitur jashtë afatit të paraparë me ligj. **8**

Ndaj këtij Aktgjykimi janë parashtruar 14 ankesa të ankuesve në vijim: Ankuesi A 0001, *H(Z)T*, më datë 28 janar 2014 ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-II.-13-0040, të datës 14 janar 2014. Ankuesi, kërkon nga Kolegji i Apelit që ta shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, ta aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfituar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. **9**

Ankuesi ka pohuar se ka punuar në NSH prej datës 18 gusht 1987. Më datë 1 prill 1993 kanë filluar masat e dhunëshme serbe dhe si në shumicën e ndermarrjeve edhe në ndërmarrjen e tyre ka filluar largimi i punëtorëve nga vendi i punës për shkak të përkatësisë etnike. Në vitin 1998, i njejt menaxhment në mënyre arbitrare e ka larguar nga puna edhe ankuesin. Ankuesi pohon se pas përfundimit të luftës në Kosovë është paraqitur disa herë për të vazhduar punën në fabrikë, mirëpo si pasojë e dëmtimit të fabrikës dhe mos funksionimit të saj, ka mbetur në listën e punëtorëve në pritje deri në privatizimin e NSH-së, si shumë punëtorë të tjerë. Ankuesi më tutje pohon se ndihet i diskriminuar edhe tash me mos përfshirjen në listën përfundimtare dhe mos trajtimit të barabartë të punëtorëve. Ankuesi shton se në Aktgjykimin e ankimuar nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, gjendja faktike qendron në librezën e tij të punës dhe në librin amzë, nga të cilat shihet se të njejtat nuk janë mbylluar dhe se asnjëherë nga NSH-ja nuk është marr ndonjë vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ankuesi si dëshmi ka bashkangjitur kopjen e Librezës së Punës, e hapur, Vërtetimi i lëshuar nga ish-menaxheri i NSH-së, [i cili thot se] për shkak të mos funksionimit të fabrikës, [ai] është lënë në listën e punëtorëve në pritje deri në privatizimin e saj, Librin Amzë nr. ..., e hapur, lista e pagave të datës 30 prill 1993, Listën e të ardhurave personale, Deklaratë mbi Diskriminim.

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesi dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhënë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

10

Ankuesja A 0002, *K(H) B*, më datë 31 janar 2014 ka parashtuar ankesë kundër Aktgjykimit C-II-13-0040, të datës 14 janar 2014. Ankuesja, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e saj si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutuar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Ankuesja kërkon anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit.

Ankuesja ka pohuar se ka punuar në NSH prej datës 15 maj 1987 deri në mars të vitit 1998 kur e kanë larguar masat e dhunëshme serbe në mënyre diskriminuese. Ankuesja pohon se është i pa qëndrueshëm [korekt; i paarsyeshëm] konstatimi i AKP-së që e ajo nuk ka punuar pas luftës së fundit në Kosovë. Ankuesja pohon se ajo posedon kontratën e

punës nr. ..., prej 15 shtator 2002, të cilën ia ka bashkangjitur kësaj ankese. Ankuesja shton se në Aktgjykimin e ankimuar nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike. Ankuesja pohon se e ajo ka punuar në NSH deri në privatizimin e saj. Si dëshmitarë ankuesja propozon që të dëgjohën *z.MA*, menaxher i NSH-së nga fshati G., Komuna e D., *DC, HI* që të dy nga D. dhe *S Sh* nga fshati Ll., Komuna e D.

Ankuesja pohon se të gjithë dokumentacionin që vërteton marrëdhënien e saj të punës në NSH, gjindet në dosjen e shkallës së parë.

11

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesës dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhënë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhenë përgjigje në ankesë.

Me datë 5 korrik 2014 e paditura (në vazhdim ankuesja) A0003, ka paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specilizuar, C-II-13-0040 duke atakuar vetëm pjesërisht Aktgjykimin e ankimuar respektivisht pikën e I-rë të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, me të cilin ju është aprovuar ankesa e 4 (katër) ankuesve.

12

Ankuesja, pohon se më Aktgjykimin e ankimuar gabimisht është aplikuar e drejta materiale dhe gabimisht është vërtetuar edhe gjendja faktike. Ankuesja më tutje pohon se me Aktgjykimin e ankimuar ankesat e ankuesve janë pranuar si të bazuara pa asnjë fakt relevant, në bazë të të cilit do të ishte vërtetuar diskriminimi, dhe pa ofruar nga ankuesit fakte dhe prova nga të cilat mund të parashikohet diskriminimi direkt apo indirekt. Ankuesja më tutje pohon se ankuesit nuk kanë ofruar dokumentacion të mjaftueshëm me të cilin do të vërtetonin marrëdhënien e tyre të punës në NSH, dhe së të njëjtit nuk i plotësojnë kriteret e parapara më nenin 10.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2003/13. Andaj sipas AKP-së, me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale dhe interpretimin e gabuar të nocionit të diskriminimit, ka pasuar edhe aprovim të pabazë të të drejtave për ankuesit e cekur në pikën I-rë të Aktgjykimit të atakuar. Sipas AKP-së, asnjë ankues i përfshirë në pikën I-rë [të dispozitivit] të Aktgjykimit të ankimuar nuk ka prezantuar fakte relevante, në bazë të të cilave kishte për të vërtetuar faktin se nuk ishin të barabartë dhe arsyetimin për aplikimin e diskriminimit direkt apo indirekt në pajtim më nenin 8.1 të Ligjit kundër Diskriminimit. Ankuesit nuk kanë ofruar fakte për diskriminim dhe e paditura nuk ka mundur t'i paraqes kundërgargumentet e saja lidhur më diskriminimin. Sipas AKP-së, në

arsyetimin e Aktgjykimit të ankimuar për një pjesë të ankuesve të përfshirë në pikën e I-rë, të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, është konstatuar se një pjesë e ish-punëtorëve nuk kanë pasur vendim mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës. Edhe kësaj radhe AKP i referohet Aktgjykimit të Trupit Gjykses të DHPGJS-së në rastin e NSH-së "R/M", në bazë të cilit barra e të provuarit e të qenit të diskriminuar i jepet ankuesit i cili duhet të paraqes fakte në bazë të cilave drejtpërdrejt, ose tërthorazi është i diskriminuar, si dhe Aktgjykimin e NSH "Kooperativa B" – F SCEL-10-0013 të datës 28 dhjetor 2012. Këto Aktgjykime siq është thënë në raste të më hershme, nuk e ndjekin vijën konstante të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që e ka ndaj mënyrës së interpretimit të diskriminimit.

13 AKP i propozon Kolegjit të Apelit që ankesën ta aprovojë si të bazuar, të anulon pikën e I-rë të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, dhe t'i refuzon ankesat e ankuesve si të pabazuara.

14 Kolegji i Apelit me urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e AKP-së u'a ka dorëzuar ankuesve të përfshirë në pikën I-rë të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar. Përgjigje në ankesë kanë dhënë ankuesit *SM*, *IG* dhe *R (R) T*, të cilët në tërësi e kundërshtuan ankesën e AKP-së si të pa bazuar, duke i kërkuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, që këtë ankesë ta refuzojë si të pa bazuar dhe ta vërtetoj pikën e I-rë të Aktgjykimit të ankimuar, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Ankuesi *R T*, në përgjigjën në ankesë i propozon Gjykatës që të caktojë seancë degjimore, për të dëshmuar pretendimet e tij.

15 Ankuesja A 0004, *X (U) I - N*, më datë 7 shkurt 2014 ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-II.-13-0040, të datës 14 janar 2014. Ankuesja, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e saj si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutur një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, duke e anuluar Aktgjykimin e kundërshtuar, respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesja ka pohuar se ka punuar në NSH prej datës 15 maj 1987 deri në kohën e privatizimit të ndërmarrjes. Ankuesja pohon se librezën e punës e ka të hapur. Si dëshmi ankuesja i ka dorëzuar DHPGJS këto dokumente: Deklaratën mbi pranimin e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara më aktet e përgjithshme normative të Fabrikës nr. ..., të dt. 13 janar 1989, Ak-

tvendimin mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor nr. ..., të dt. 16 maj 1990, Aktvendimin mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor Nr. ..., të dt. 19 qershor 1989, Aktvendimin mbi caktimin me punët dhe detyrat e punës nr. ..., të dt. 13 jana[r] 1989, librezën e punës nr. ..., data e fillimit 5 maj 1987, e pa mbyllur, Librin amë të punëtorëve e cila gjendet në numrin rendor Kësaj ankese ia ka bashkangjitur listat e pagave për vitet 1988, 1989, dhe 1990, këto në origjinal. Ankuesja ndihet e diskriminuar me mos përfshirjen e saj në listën përfundimtare.

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesës dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhënë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

16

Ankuesi A 0005, *Xb (S) N*, më 7 shkurt 2014 ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-IL-13-0040, të datës 14 janar 2014, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

17

Ankuesi, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutur një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, duke anuluar Aktgjykimin e kundërshtuar, respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesi ka pohuar se ka punuar në NSH prej datës 18 gusht 1987. Si dëshmi ankuesi pohon se të gjithë dokumentacionin për të vërtetuar marrëdhënien e tij të punës ia ka bashkangjitur shkallës së parë. Ankuesi pohon se ndihet i diskriminuar në raport me kolegët e tjerë të punës e të cilët janë të përfshirë në listën përfundimtare. Tani kësaj ankese ia ka bashkangjitur kopjen e Librit Amë, në të cilin ankuesi mban numrin ..., pasqyrën tabelare të të ardhurave personale për ankuesin dhe punonjësit e tjerë të NSH-së, si dhe listat e pagave të të ardhurave personale për vitin 1989. Po ashtu njoftimin e datës 11 nëntor 2013, të nënshkruar nga menaxheri i NSH-së *MA* dhe udhëheqësit sindikal: *JD, S Sh, MN* dhe avokati *QF*.

Më 11 shkurt 2014 ankuesi ka dorëzuar 5 libraza të punës të dëmtuara dhe 21 fotografi të zyrave ku ishin të vendosura dosjet personale të punëtorëve, të cilët janë ankuar në këtë gjykatë. Këto dokumente ankuesi pohon se janë si dëshmi për të treguar se janë demoluar zyrat,

18

janë shkatërruar e asgjësuar dosjet personale gjatë kohës së luftës në Kosovë. Andaj kërkon nga Gjykata që të ketë parasysh këtë rrethanë, ngase në mesin e të ankuarve ka mjaft të tillë të cilët nuk kanë mundur të sigurojnë në tërësi dosjet e tyre nga marrëdhënia e punës.

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesës dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhenë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

19 Ankuesit A 0006, *II, B (D) G, I Q, D (I) T, N (M) M, K H, M (H) O, Sh (Xb) R, Z (S) B, N K, G F, T (S) H, R (Sh) O, Xb (S) V, S (C) M, S T, M L, H S, M T, N P, A T, Z U, R R, S N, R K, A (A) A, I (H) L, H A, M J, I B, Xb (B) J, R (D) M, Xb (S) A, X (A) C, K (M) D, E L, B (R) D, N (A) F- S, S G, H (H) B, H (I) K, T (B) H, L (M) O, A (U) M*, nga fshati S. i E., D., kanë parashtruar ankesë më 7 shkurt 2014 kundër Aktgjykimit C-II-13-0040, të datës 14 janar 2014, për shkak të vertetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Ankuesi *II*, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutur një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Ankuesi kërkon anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesi pohon se në NSH ka punuar 26 vite. Kopjen e librezës së punës nuk ka mundur ta sjellë për arsye se ajo i është djegur nga lufta, këtë gjykata është dashur që ta trajtojë si *Vis Major*. Ankuesi nuk ka paraqitur ankesë ndaj listës së përkohshme, sepse është i pa arsimuar dhe se nuk ka ditur se duhet të parashtronte ankesë ndaj listës së përkohshme. Andaj kërkon që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar.

muese të dokumentacionit të punonjësve të fabrikës, e bashkë me to, edhe dosjen e saj personale. Ankuesja ankeses ia ka bashkangjitur disa fotografi në të cilat shihet dokumentacione të demoluara, si dhe një librezë e punës pa ndonjë shënim në të.

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesës dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhenë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhenë përgjigje në ankesë.

Ankuesi A 0008, *H(M)I*, më datë 8 shkurt 2014 ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-II-13-0040, të datës 14 janar 2014. Ankuesi, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutuar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, dhe anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesi ka pohuar se ka punuar në NSH prej datës 5 maj 1987, deri në mars të vitit 1998. Pas luftës, në korrik të vitit 1999 ka vazhduar punën në NSH, e deri në privatizimin e ndërmarrjes. Ai konsideron se ka status të njëjtë me punëtorët e tjerë të cilët janë përfshirë në listën përfundimtare. Më tutje pohon se nuk ka mundur të ofrojë deshmi të tjera që vërtetojnë marrëdhënien e punës, ngase siq kanë deklaruar edhe disa koleg të tjerë, në Fabrikën në të cilën ka punuar, në kohën e luftës kanë qenë të vendosura forcat ushtarake – policore serbe, dhe dosjet personale janë demoluara dhe asgjësuar. Po ashtu hapja dhe mbyllja e stazhit të punës [Libri Amë] nuk është bërë pas luftës.

64

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesës dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhenë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhenë përgjigje në ankesë.

Ankuesi A 0010, *TD*, më datë 8 shkurt 2014 ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-II-13-0040, të datës 14 janar 2014. Ankuesi, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutuar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, dhe anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, respektivisht pikën III-të të dispozitivit të Aktgjykimit, me të cilën i është hedhur posht si e pa afatshme ankesa. Ankuesi ka pohuar se

65

ka punuar në NSH prej vitit 1976 dhe e kishte ndërprerë marrëdhënien e punës më 20 mars të vitit 1998, kur janë paraqitur shenjat e para të luftës, për të filluar sërish me datë 6 korrik të vitit 1999, ku ka punuar deri në privatizimin e saj, përkatësisht deri në fund të vitit 2006.

Ankuesi ka pohuar se është i pa shkollë dhe nuk ka qenë në dijeni për lëshimin e afatit për parashtrimin e ankesës, kundër listës përfundimtare për përfitim të 20%, andaj kërkon nga Gjykata që të merr parasysh këtë fakt.

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesës dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhenë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhenë përgjigje në ankesë.

66

Ankuesi A 0012, R (I) Q, më datë 8 shkurt 2014 ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-II-13-0040, të datës 14 janar 2014. Ankuesi, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutur një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, kërkon anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesi ka pohuar se ka punuar në NSH prej datës 18 gusht 1987, deri në kohën e privatizimit të ndërmarrjes. Ai konsideron se ka status të njëjtë me punëtorët e tjerë të cilët janë përfshirë në listën përfundimtare, dhe propozon që në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohen ish kolegët-punëtorë nga ndërmarrja. Ankuesi në ankesë pohon se kësaj gjykate në shkallë të parë i ka bashkangjitur prova të mjaftueshme të cilat e vërtetonin marrëdhënien e tij të punës në NSH si: Aktvendimin nr. ..., të dt. 7 shtator 1989, Aktvendimin mbi caktimin në punë dhe detyrat e punës, nr. ..., të dt. 2 shtator 1989, Aktvendimin mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor nr. ... të vitit 1989, Vërtetimin mbi dorëzimin e fletëparaqitjes-çregjistrimi i sigurimit, të dt. 23 maj 1990. Shton se librezja e punës i është djegur gjatë kohës së luftës në Kosovë. Pohon se posedon kopjen e librit amë nga e cila shihet se është i regjistruar në numrin rendor ..., kjo kopje është në AKP. Kësaj ankese ia ka bashkangjitur deklaratën e datës 27 janar 2014 të nënshkruar nga MA ing. i diplomuar, udhëheqësit sindikal, JD, S Sh dhe MN si dhe QF.

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesës dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhenë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhenë përgjigje në ankesë.

[Ankesa e] ankuesit A0013, *S (I) M*, nuk është ankesë, është vetëm përgjigje në ankesën e AKP-së, dhe Zyra e Regjistrimit në DHPGJS gabimisht e ka regjistruar si ankesë.

67

Ankuesja A 0014, *C(B)IL*, më datë 29 prill 2014 ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-II-13-0040, të datës 14 janar 2014. Ankuesja, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e saj si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutur një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, dhe kërkon anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesja ka pohuar se ka punuar në NSH prej datës 28 korrik 1987, deri në kohën e privatizimit të ndërmarrjes. Ajo konsideron se ka status të njëjtë me punëtorët e tjerë të cilët janë përfshirë në listën përfundimtare, dhe propozon që të dëgjohen dëshmitarë ish punëtorët e ndërmarrjes. Ankuesja pohon se kësaj gjykate në shkallë të parë i ka bashkangjitur prova të mjaftueshme të cilat e vërtetonin marrëdhënien e [saj] të punës në NSH si: Aktvendimet për shfrytëzimin e pushimit vjetor nr. ..., të datës 1 korrik 1989, Aktvendimin e datës 1 gusht 1989, Aktvendimin mbi caktimin në punë dhe detyrat e punës nr. ..., të datës 2 shtator 1989. Ankuesja pohon se për shkakë të luftës në Kosovë i është imponuar të ndërpresë punën së bashku me punëtorë tjerë me datë 22 Mars të vitit 1998. Ankuesja me tutje pohon se në NSH ka punuar edhe pas luftës në korrik të vitit 1999, ku ka punuar deri në privatizimin e NSH-së. Gjithashtu, ankuesja pohon se në kohën e luftës së fundit në Kosovë, në lokalet e fabrikës ishin stacionuar forcat ushtarako-policore serbe dhe gjatë qëndrimit të tyre ato kishin asgjësuar pjesën dërmuese të dokumentacionit të punonjësve të fabrikës, e bashkë me to edhe dosjen e saj personale.

68

Kolegji i Apelit më urdhërin e datës 6 qershor 2014 ankesën e ankuesës dhe dokumentacionin mbështetës ia ka dorëzuar të paditurës për të dhenë përgjigje në ankesë. Urdhërin AKP-ja e ka pranuar më datë 12 qershor 2014, mirëpo nuk ka dhenë përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor: Ankesat e ankuesve A 0001 *H (Z) T*, A0002 *K (H) B*, A 0004 *X (U) I N*, A 0005 *Xb (S) N*, A 0006 *I Q* dhe të tjerët, *M (H) O*, *R R*, *N K*, *Xb (S) V*, *S (C) M*, *R (D) M*, *H (H) B*, *B (D) G*, *D (I) T*, *N (M) M*

69

K H, Sb (Xh) R, G F, T (S) H, R (Sh) O, S T, M L, H S, N P, A T, Z U, S N, R K, A (A) A, I (H) L, M J, Xb (B) J, Xb (S) A, X (A) C, K (M) D, I B, E L, B (R) D, N (A) F- S, S G, H S, M T, H A, H (H) B, H (I) K, T (B) H, A0007 K (H) B, A0008 H (M) I, dhe A0012 R (I) Q, janë të bazuara dhe obligohet AKP që ti fus në listën për fundimtare për të drejtën e 20 për qind të të ardhurave nga privatizimi i i NSH-së.

70 Ankesat e ankuesve A 0003 *AKP*, A0006 *II, K (H) H, Z (S) B, K H, L (M) O, A (U) M* dhe A 0010 *TD* refuzohen si të pabazuara.

71 Ankesa e ankueses A 0014 *C (B) I L* dhe e A0013 *S (I) M*, hedhen poshtë si të papranueshme.

72 Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP.

Merita e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Diskriminimi

73 Në mënyrë që të ndalojë diskriminimin, promovojë dhe të fusë në fuqi parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, më 30 korrik 2004, miratoi Ligjin Kundër Diskriminimit nr. 2004/3 (të shpallur me Rreg. e UNMIK-ut 2004/32), i cili është dokument juridik ligjërishit i detyrueshëm edhe aktualisht.

74 Sa i përket barrës së provave, neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, thotë si vijon:

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

75 Sipas interpretimit të mësipërm, kur një ankues ka për qëllim të dëshmojë se është diskriminuar, nga ai/ ajo kërkohet vetëm që të pretendojë faktet specifike nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë), dhe i mbetet të paditurit (në këtë rast Agjencisë) që të dëshmojë të kundërtën, d.m.th. të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

Sipas të drejtës precedentele DHPGJS-së (ASC-11-0069, AC-I-12-0012 etj), [persona] të diskriminuar mund të llogariten:

- a) punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, apo që u takojnë minoriteteve ashkali, romë, egjiptian, goran dhe turq, të cilët ishin larguar për arsye diskriminimi në periudhën e ashtuquajtur të “masave të përkohshme serbe” (që sillen prej vitit 1989 deri në vitin 1999), apo të cilët u diskriminuan edhe në periudha të ndryshme, për shkak të etnisë së tyre, besimeve politike dhe religjioze, etj.;
- b) punëtorët e përkatësisë etnike serbe të cilët, për shkaqet e njohura botërisht pas luftës në Kosovë, pas vitit 1999, nuk u paraqiten në punë dhe të njëjtit nuk u gjenden në listat përfundimtare të punëtorëve.

Në veçanti, shikuar në aspektin kohor, në lidhje me diskriminimin e pësuar nga kategoritë e lartpërmendura të punëtorëve, duhet të përmendet si vijon:

- a) Më 26 korrik 1990, qeveria serbe shpalli “Ligjin e Marrëdhënieve të Punës në Rrethana të Veçanta” (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 40/90), me të cilin, si rezultat, erdhi largimi i mijëra punëtorëve shqiptarë nga vendet e tyre të punës (shih në këtë pikë, edhe Aktgjykimin e TPNJ-së të datës 30 nëntor 2005 në lëndën nr. IT-03-66, faqe 16, par. 39, që thotë:

Në vitin 1990, Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria Krabinore u suprimuan. Në mars 1990, Kuvendi i Serbisë miratoi një sërë masash të cilat çuan në heqjen nga puna të shqiptarëve të Kosovës nga institucionet politike dhe ekonomike dhe nga ndërmarrjet e mëdha ekonomike ...

Në vitet 1990 u miratuan disa rezoluta nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, mes të cilave Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr. 48/153 e datës 20 dhjetor 1993, e cila e njeh ekzistimin e (dhe dënon) – mes tjerash –

... masat dhe praktikat e diskriminimit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës, si dhe represionin e madh të bërë nga autoritetet serbe, duke përfshirë: ... b. Largimin diskriminues të zyrtarëve shqiptarë, veçanërisht nga policia dhe gjyqësori, largimin masiv të shqiptarëve nga pozitat profesionale, administrative dhe pozitat tjera të kualifikuara në ndërmarrjet shoqërore dhe institucionet publike, duke përfshirë mësuesit nga sistemi shkollor i drejtuar nga serbët.

Si pasojë e të ashtuquajturave “Masa të Përkohshme” të vëna në NSH, menaxhmenti shqiptar u largua dhe u zëvendësua me menaxhmentin serb (shih “Ligji mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore”, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Serbisë nr. 49 të datës 28 tetor 1989, i cili nuk është ligj në fuqi sipas Rreg. së UNMIK-ut 1999/24).

b) Në anën tjetër, një numër i punëtorëve që i takojnë minoritetit serbo-kosovar, punuan gjatë periudhës së masave të përkohshme serbe (1989-1999), por nuk ishin në gjendje që të kthehen në punë menjëherë pas luftës, pra duke u diskriminuar nga menaxhmenti i ri. Siç u vërejt më lartë, kur një ankues pretendon fakte specifike diskriminuese, i mbetet të paditurit që të dëshmojë se ankuesi nuk është diskriminuar. E njëjta rregull e “kthimit të barrës së provës” që po zbatohet tek punëtorët shqiptarë (dhe minoritetet tjera) që kanë pretenduar diskriminim në lidhje me largimin e tyre nga puna gjatë masave të përkohshme serbe, duhet të zbatohet edhe tek ky grup i punëtorëve.

78 Për të gjitha arsyet e mësipërme ligjore, ankesa pranohet si e bazuar kur ankuesi dëshmon të ketë qenë i punësuar në NSH, për së paku tre vjet dhe ai është i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit, ose kur ai ka dorëzuar prova se nuk ishte në gjendje të punojë, sepse ishte diskriminuar (me fjalë tjera: ai do të ishte i regjistruar si punëtor po të mos ishte diskriminuar). Në të kundërtën, ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar kur faktet dhe rrethanat e lartpërmendura nuk janë të vërtetuara nga ankuesi.

79 Ankuesi A 0001 H(Z) T, ka pohuar se në NSH ka punuar prej datës 18 gusht 1987. Më datë 1 prill 1993 kanë filluar masat e dhunëshme serbe dhe si në shumicën e ndërmarrjeve edhe në ndërmarrjen e tyre ka filluar largimi i punëtorëve nga vendi i punës për shkak të përkatësisë etnike. Në vitin 1998 i njëjti menaxhment ka larguar [atë] nga puna në mënyrë diskriminuese dhe në mënyrë arbitrare. Ankuesi pohon se pas përfundimit të luftës në Kosovë është paraqitur disa herë për të vazhduar punën në fabrikë, mirëpo si pasojë e dëmtimit të fabrikës dhe mosfunksionimit të saj, ka mbetur në listën e punëtorëve në pritje, deri në privatizimin e NSH-së, si shumë punëtorë të tjerë. E paditu-

ra, AKP-ja, në përgjigjen në ankesë nuk ka kontestuar pretendimet e ankuesit, vetëm se ka kërkuar që ankesa e tij të hedhet poshtë si e pa pranueshme, për arsye se ankuesi nuk ka parqitur ankesë kundër listës së përkoheshme.

Kolegji i Apelit vlerëson se mos paraqitja e ankesës ndaj listës së përkohshme, në pajtim me nenin 67.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, nuk e bënë ankesën ndaj listës përfundimtare si të pa pranueshme.

80

Andaj, ankuesi në bazë të provave të prezantuara i plotëson kriterët e parapara me nenin 10.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2003/13, e ndryshuar dhe ankesa e tij aprovohet si e bazuar.

81

Kolegji i Apelit konstaton se pretendimet e ankuesit janë të plota dhe të qarta. Këto pretendime ankimore, nuk janë kundërshtuar nga AKP, dhe për këtë arsye, ankuesja duhet të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta për të përfituar 20 për qind të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së.

Ankuesja A 0002 K (H) B, ka pohuar se ka punuar në NSH prej datës 15 maj 1987 deri në mars të vitit 1998, kur e kanë larguar masat e dhunshme serbe në mënyrë diskriminuuese. Ankuesja pohon se është i pa qendrueshëm konstatimi i AKP-së që e njejtja nuk ka punuar pas luftës së fundit në Kosovë. Ankuesja pohon se ajo posedon kontratën e punës nr. ..., prej 15 shtator 2002, të cilën ia ka bashkangjitur kësaj ankese, që dëshmon punësimin e saj edhe pas luftës.

82

Kolegji i Apelit vlerëson se në bazë të provave të prezantuara nga ankuesja në shkallë të parë, librezja e hapur e punës, si dhe nga provat tjera të ofruara, ajo i plotëson kriteret e parapara me nenin 10.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar, dhe ankesa e saj aprovohet si e bazuar.

Kolegji i Apelit konstaton se pretendimet e ankuesit janë të plota dhe të qarta. Këto pretendime ankimore, nuk janë kundërshtuar nga AKP, dhe për këtë arsye, ankuesja duhet të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta për të përfituar 20 për qind të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së.

[Paragrafet 83 deri 88 nuk ceken pasi që rethanat faktike dhe procedurale dhe arsyetimi ligjorë në ankesat e $X(U)IN$, $X(S)N$, $B(D)G$, $I Q$, $D(I)T$ dhe $N(M)M$ janë të ngjashme me ankuesin A 0002 K (H) B]

83-88

Ankuesi *Sh (Xh) R*, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfituar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së dhe anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesi pohon se kësaj gjykate i ka dorëzuar prova materiale të mjaftueshme që vërtetojnë marrëdhënien e tij të punës së NSH. Pohon se ankesa i është refuzuar pa u vërtetuar drejtë gjëndja faktike. Në NSH ka filluar të punoj prej 5 shtator 1988 [dhe ka punuar] deri më 3 prill 1998. Pas luftës është kthyer në punë më datë 6 korrik 1999 në detyrat e punës të cilat i ka pasur edhe para luftës dhe ka punuar deri në privatizim të NSH-së. Ankuesi pohon se gjykatës ia bashkangjësë kopjen e librezës së punës me nr. të regjistrimit ... dhe nr.evidence

Kolegji i Apelit gjenë se ankesa e këtij ankuesi, nuk është e bazuar. Ai nuk ka dëshmuar me asnjë provë materiale të ketë punuar në këtë NSH, nuk ka as librezë të punës, por nuk ka asnjë dëshmi tjetër që të ketë punuar pas luftës.

[...]

Ankuesi *N K*, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfituar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, dhe anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesi pohon se kësaj gjykate i ka dorëzuar prova materiale të mjaftueshme që vërtetojnë marrëdhënien e tij të punës së NSH. Pohon se ankesa i është refuzuar pa u vërtetuar drejtë gjëndja faktike. Në NSH ka filluar të punoj prej 5 maj 1987, këtë e vërteton vërtetimi i lëshuar nga kompetentët e kësaj ndërmarrje, më 16 prill 2013, të cilin ia ka bashkangjitur ankesës në shkallë të parë. Ankuesi shton se, pas luftës është kthyer në punë, prej 6 korrik 1999, në detyrat e punës të cilat i ka pasur edhe para luftës, dhe ka punuar deri në privatizim të NSH-së. Ankuesi më tutje pohon se librezë e punës i është dëmtuar, pasi që në lokalet e fabrikës, gjatë kohës së luftës në Kosovë ishin përqëndruar forcat ushtarako-policore serbe, dhe për atë arsye shumë dosje personale të disa punëtorëve janë asgjësuar apo djegur. Ai ka prezantuar një Vërtetim me vulë të NSH-së nga i cili del se ai kishte lidhur marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar me këtë NSH. Vërtetimi mban datën 16 prill 2013.

Këto pretendime të këtij punëtori nuk janë kundërshtuar nga AKP, andaj Kolegji i Apelit gjenë se ankuesi duhet të futet në listën e punëtorëve për të gëzuar të drejtën për 20 për qind të të ardhurave nga shitja e NSH-së.

[Paragrafi 91 nuk ceket pasi që rethanat faktike dhe procedurale dhe arsyetimi ligjorë në ankesën e *GF* është e ngjashme me ankuesin *NK*] 91

Ankuesi *T(S)H*, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutuar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, dhe anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesi pohon se kësaj gjykate i ka dorëzuar prova materiale të mjaftueshme, që vërtetojnë marrëdhënien e tij të punës në NSH. Pohon se ankesa i është refuzuar pa u vërtetuar drejtë gjendja faktike. Në NSH ka filluar të punoj prej 16 maj 1990, sipas Aktvendimit ..., i cili gjendet në shkresat e lëndës. Shton se edhe pas luftës ka punuar në NSH në detyrat e punës të cilat i ka pasur edhe para luftës dhe ka punuar deri në privatizim të NSH-së. 92

Kolegji i Apelit konstaton se në bazë të fakteve të prezantuara, kopja e librit amë, ku ankuesi gjendet në numrin ..., shihet se marrdhënia e tij është ndërprerë në vitin 1989, dhe disa vendimeve tjera paraprake, është e qartë se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi për vazhdimësinë e punës pas vitit 1989, andaj, ankesa e tij është e pabazuar.

[...]

Ankuesi *R (Sh) O*, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfutuar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, dhe anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, respektivisht pikën II-të të dispozitivit të Aktgjykimit. Ankuesi pohon se kësaj gjykate i ka dorëzuar prova materiale të mjaftueshme që vërtetojnë marrëdhënien e tij të punës së NSH. Pohon se ankesa i është refuzuar pa u vërtetuar drejtë gjendja faktike. Në NSH ka filluar të punoj prej 18 gusht 1987. Libreza e punës nuk i është mbyllur. Shton se në NSH ka punuar edhe pas luftës, prej datës 6 korrik 1999, në detyrat e punës të cilat i ka pasur edhe para luftës, dhe ka punuar deri në privatizim të NSH-së. 93

Nga AKP nuk janë kundërshtuar këto pretendime, por ankuesit kanë ofruar edhe listën e nënshkruar nga drejtori i kësaj NSH-je dhe anëtarët tjerë të organizatës sindikale të kësaj NSH-je ku shihet se edhe ankuesi është në listën e punëtorëve që i plotësojnë kriteret ligjore për të qenë në listën përfundimtare për 20 për qind. Për këto arsye Kolegji i Apelit konstaton se ankuesi i plotëson kriteret ligjore për 20 për qind, dhe obligohet AKP që ta fus në listën përfundimtare të punëtorëve që gëzojnë të drejtën për të përfituar 20 për qind të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së.

- 94- [Paragrafet 94 deri 126 nuk ceken pasi që pasi që rethanat faktike
126 dhe procedurale dhe arsyetimi ligjorë në ankesat e *S T, M L, H S, N P, A T, Z U, R R, S N, R K, A (A) A, I (H) L, M J, I B, X (B) J, X (S) A, X (A) C, K (M) D, E L, B (R) D, N (A) F-S, S G, H (I) K, T (B) H, M (H) O, X (S) V, R (D) M, H (H) B, H S, M T, H A, S (C) M, K (H) B, H (M) I dhe R (I) Q* janë të ngjashme me ankuesin *R (S) O*]

Ankesat e ankuesve A 0003 AKP, A 0006 I I, K(H) H, Z(S) B, L (M) O, A 0010, A(U) M dhe T D refuzohen si të pabazuara.

Ankesa e të paditurës AKP-së A 0003

- 127 E paditura e konteston [në] Aktgjykimin e ankimuar, pikën I-rë të dispozitivit për ankuesit, ankesat e të cilëve janë aprovuar si të bazuara dhe këta ankues janë përfshirë në listën përfundimtare për të drejtën legjitime për 20 %.

E paditura në ankesë pretendon se Aktgjykimi i ankimuar është jokonsistent i pa argumentuar në bazë të ligjit, nuk përmban fakte qenësore dhe në mënyrë arbitrare e interpreton ligjin. Këto pretendime vazhdimisht përsëriten nga e paditura në çështjen kur e konteston interpretimin e diskriminimit që e bënë DHPGJS-ja në rastin e ankuesve që pohojnë se kanë qenë të diskriminuar. Këto pretendime ankimore të paditurës të dhëna edhe në këtë ankesë siq është thënë edhe në rastet tjera nuk janë të sakta.

- 128 Qasja që i bënë Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, çështjes së interpretimit të diskriminimit që ka ndodhur lidhur me ankuesit është e saktë dhe e bazuar në ligj dhe një qasje e tillë e interpretimit të diskriminimit, pranohet edhe nga Kolegji i Apelit. Ankuesit e nacionalitetit serb janë larguar nga NSH-ja që në qershor të vitit 1999, ata kishin

deklaruar se nuk ishin ndjerë të sigurt të kthehen në punë, për shkak të rrethanave të krijuara, ndërsa e paditura nuk e ka kontestuar faktin se ankuesi është larguar prej vendit të tij të punës nga frika dhe as nuk e ka kundërshtuar se frika e tillë pas përfundimit të luftës ishte arsyeuar për personat e kombësisë serbe. Arsyet e dhëna nga Kolegji i Specializuar për aprovimin e ankesës së këtyre ankuesve janë të sakta, pasi që e paditura e cila e kishte barrën e provave në bazë të nenit 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit, nuk ka arritur me ndonjë provë të vërtetohet se nuk ishte shkelë parimi i trajtimit të barabartë të punëtorëve. Andaj këta ankues i kishin plotësuar kriteret ligjore në bazë të nenit 10.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar me Rreg. [e UNMIK-ut] 2004/45 që të futet në listën përfundimtare. Andaj Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, ankesën e ankuesës e refuzon si të pabazuar dhe vërteton Aktgjykimin e ankimuar.

Ankuesi A 0006 *II*, pohon se në NSH ka punuar 26 vite. Kopjen e Librezës së Punës nuk ka mundur ta sjellë për arsye se ajo i është djegur nga lufta, dhe sipas tij, këtë gjykata është dashur që ta trajtojë si Vis Major.

129

Kolegji i Apelit gjeti se ky ankues në kohën e privatizimit ishte në moshën mbi 70 vjeçare, dhe nuk i plotëson kriteret ligjore të nenit 10.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2003/13, e ndryshuar, andaj ankesa e tij refuzohet si e pabazuar.

Kolegji i Apelit ankesën e ankuesit K (H) H, e refuzon si të pabazuar për faktin se, në bazë të kopjes së librezës së punës shihet se librezja e tij e punës është mbyllur më datë 31 dhjetor 1992, edhe pse ky ankues deklaroi se librezja e tij i është djegur gjatë luftës. Nuk ka dëshmi të ketë punuar pas kësaj date në këtë NSH.

130

Ankuesi *L (M) O*, kërkon nga Kolegji i Apelit që të shqyrtojë Aktgjykimin e ankimuar, të aprovojë ankesën e tij si të bazuar dhe ta përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime që gëzojnë të drejtën për të përfituar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, dhe anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, respektivisht pikën [e] II-të të dispozitivit të Aktgjykimit.

131

Ankuesi pohon se kësaj gjykate i ka dorëzuar prova materiale të mjaftueshme që vërtetojnë marrëdhënien e tij të punës në NSH. Pohon se ankesa i është refuzuar pa u vërtetuar drejtë gjendja faktike. Ankuesi

pohon se në OPB “Gj” në D., OBPB “F e p” me seli në D. ka punuar prej vitit 1986. Në vitin 1988 e ka shkëputur marrëdhënien e punës në OBPB “Sb”, dhe është pranuar në Fabrikën e Mobileve Masive në D., për kohë të pacaktuar [me kontratë me kohë të pasaktuar]. Në fabrikë ka punuar deri në vitin 1991. Prej datës 20. Mars 1998 e deri më 22 qershor 1999, në lokalet e kësaj fabrike janë stacionuar forcat ushtarake – policore serbe dhe kanë asgjësuar apo djegur dokumentacionin, i cili do të justifikonte marrëdhënien [e tij] të punës në këtë NSH.

Kolegji i Apelit nuk ka gjetur asnjë dëshmi që mbështeten këto pretendime të ankuesit. Nuk ka asnjë provë materiale se ka punuar në këtë NSH pas vitit 1991, e aq më pak të ketë punuar pas luftës në këtë NSH. Për këto arsye ankesa refuzohet si e pabazuar.

132 Ankesa e ankuesit *A (U) M*, refuzohet si e pabazuar, sepse ai as në shkallë të parë, e as pranë Kolegjit të Apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi që do e mbështetnin pretendimet e tij. Madje ai vetë ka deklaruar në ankesë se deri me fillimin e luftës në Kosovë ka punuar si punëtor sezonal në këtë NSH, ndërsa pas luftës ka filluar të punoj me kohë të pacaktuar, por as këtë periudhë pas luftës nuk e provon me asnjë provë materiale.

133 Ankesa e [ankusit] *A 0010, T D*, refuzohet si e pa pabazuar, sepse me Aktgjykimin e ankimuar, ankesa e ankuesit ishte hedhur poshtë si e papranueshme. Kolegji i Apelit vlerëson se Kolegji i Specializuar me të drejtë ka vlerësuar kur ka hedhur poshtë si të papranueshme ankesën e ankuesit ngase e njëjta ishte paraqitur jashtë afatit të paraparë më ligj. Afati për parashtrimin e ankesës në DHPGJS kundër Listës Përfundimtare ishte data 4 maj 2013, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 1 tetor 2013.

Kolegji i Apelit pohimin e ankuesit se është i pa shkollë dhe nuk ka ditur të përcjellë afatin për paraqitjen e ankesës në afatin e paraparë me ligj nuk mund ta merr për bazë ngase nga afati i fundit për paraqitjen e ankesës e deri në kohën kur ankuesi ka parashtruar ankesë kanë kaluar 5 muaj, andaj kërkesa e tij nuk mund të merret si kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme.

Për arsyet e lartëcekura, ankesat e këtyre ankuesve refuzohen si të pabazuara, ndërsa vërtetohet pika III e Aktgjykimit të ankimuar sa u përket këtyre ankuesve.

- Ankesa e ankueses A 0014 C (B) IL hedhet poshtë si e pa afatshme.
- 134 Ankesa e ankueses e paraqitur ndaj Aktgjykimit të ankimuar të Kolegjit të Specializuar, është e pa afatshme dhe si e tillë hedhet poshtë si e papranueshme.
- Me Aktgjykimin e ankimuar C-II.-13-0040 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, në këshillën juridike të këtij Aktgjykimi, ankuesit ishin njoftuar se ankesën duhet ta parashtrojë brenda 21 (njëzet e një) ditëve nga pranimi i Aktgjykimi. Ankuesja e ka pranuar Aktgjykimin e ankimuar më 21 janar 2014, ndërsa ankesën e ka parashtruar në DHPGJS më datë 29 prill 2014, jashtë afatit të paraparë ligjor.
- Andaj, Kolegji i Apelit për këto arsye vlerëson se ankesa e ankueses është e pa afatshme dhe si e tillë hedhet poshtë si e papranueshme.
- 135 Ankesa e ankuesit A 0013 S (I) M, nuk është ankesë, por vetëm përgjigje në ankesën e AKP-së, ndërsa Zyra e Regjistrimit në DHPGJS gabimisht e ka regjistruar si ankesë. S (I) M ka qenë i përfshirë në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, me të cilin i është njohur e drejta në 20 për qind të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së
- 136 Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Shënim i redaktorit: Ky Aktgjykim më tutje zhvillon ASC-11-0069, AC-I.-12-0012



Transformimi i kapitalit në pronësi shoqërore të NSH-së të jetë i bazuar në Kontratë me Detyrime të Ndërsjellta/ Analiza nëse Bordi menaxherial i NSH-së është themeluar në pajtim me Rregullat e vetë-menaxhimit

Zbatueshmëria e ligjeve të aprovuara pas 22 marsit të vitit 1989; Transformimi i kapitalit të NSH-së në pronësi shoqërore në SHA; Diskriminimi etnik në shkarkimin dhe emërimin e bordit menaxherial; Ri-konfigurimi i bordit drejtues

Rreg. e UNMIK-ut 1999/24 neni 1.2, 1.1; Rreg. e UNMIK-ut 2002/12 neni 5.4; LN neni 187(1), 187a(3), 187a(1), 27(1) deri në (4), 14; Ligji për Qarkullimin dhe Disponimin me Kapitalin Shoqëror neni 2, 2.1, 2b, 4

1. Kapitali në pronësi shoqërore i një NSH-je mund të shpërndahet vetëm përmes një kontrate që mbartë obligime dhe të drejta reciproke por jo përmes dhurimit.
2. Vetëm këshilli i punëtorëve të NSH-së është i autorizuar që të marr vendim për shitjen e kapitalit shoqëror.
3. Edhe në qoftë se një numër i madh i punëtorëve të nacionalitetit shqiptar ka vazhduar punën, e edhe nëse madje atyre iu janë shpërndarë të aksionet, kjo nuk mund të çojë në përfundimin se nuk ka ekzistuar një paragjykim etnik atëherë kur bordi drejtues është rikonfiguruar në atë mënyrë që asnjë menaxher shqiptar nuk ka mbetur tek organi i përkohshëm i ndërmarrjes.

Aktgjykim i datës 2 prill 2015 – AC-I.-14-0169 (Shkalla e parë: Aktvendimi i datës 15 prill 2014 – SCC-05-0113)

Rrethanat procedurale dhe faktike: Më 11 prill 2005, paditësi “S” SH.A. parashtrroi padi kundër të paditurës AKM-së. Sipas padisë, Kompania “S”, është pronarja e vetme e “F-S” SH.P.K. – ndërmarrje e shitur nga AKM-ja si NSH më 16 shtator 2004. Për ta provuar këtë pretendim, paditësi e prezanton një vendim të lëshuar më 28 tetor 1992 nga Organi Drejtues i Përkohshëm, i NSH “F – Fabrika e Tapetave”, që të bashkohet me “S”, një SHA, e cila kryesisht kishte kapital privat. Më 4 nëntor 1992, Gjykata Ekonomike e N. S. [/Sërbi] e regjistroi kompaninë që i mbijetoi bashkimit dhe rrjedhimisht të gjitha asetet dhe detyrimet e Fabrikës së Tapetave janë transferuar në “S”. Megjithatë, Organi Drejtues i “S” vendosi që ta inkorporojë një Ndërmarrje të Re në Kosovë – që do të thotë “F-S” SHPK. Më 2 dhjetor 1992, Ndërmarrja e re SH.P.K. ishte regjistruar në Gjykatën Ekonomike në P. si “S” SH.A. si e vetmja themeluese. 1

Kjo situatë ligjore ka vazhduar të ekzistojë deri në ardhjen e Forcave Ndërkombëtare në Kosovë. Pastaj e sapoformuara AKM-ja, pas studimit të statusit të “F-S” SH.P.K. vendosi që të mos e përfillë kompaninë që ishte bashkuar dhe ta trajtojë atë si NSH, që ka rezultuar me privatizimin për shumën e përgjithshme prej ... euro. 2

Kërkesa e paditësit është që t’i paguhej shuma prej ... euro me interes, që nga data 16 shtator 2004, deri në pagesën përfundimtare. Përveç kësaj, paditësi gjithashtu kërkoi që t’i jepet shuma prej ... euro, për kompensimin e humbjes së profitit si rezultat i trajtimit të paligjshëm nga ana e AKM-së. 3

Më 26 tetor 2005, AKM-ja parashtrroi në DHPGJS mbrojtjen e saj ndaj padisë. AKM kërkon nga gjykata që të urdhërohet paditësi që të paraqet më shumë prova për padinë. Ndër të tjera, AKM kërkon të provohet nëse aksionarët e kanë miratuar padinë e tanishme, ose janë këshilluar për veprimin e ndërmarrë nga menaxhmenti; se paditësi i vëzhgonte veprimtaritë e vartësit të saj të pohuar “F” dhe se i ka paguar aksionarët e saj; se paditësi kishte bërë ndonjë investim në vartësin e saj të pohuar “F” dhe kërkon prova se si ishte llogaritur humbja financiare e pretenduar nga paditësi. 4

Në vijim të mbrojtjes së AKM-së, thekson se kjo shkrirje nuk ishte e bazuar në LN (i miratuar në vitin 1988 dhe i publikuar në Gazetën 5

Zyrtare nr. 77/88, më vonë i ndryshuar në vitin 1989 dhe dy herë në vitin 1990), që mund të përbënë ligj të zbatueshëm, sepse dispozitat e rëndësishme të këtij ligji nuk ishin zbatuar gjatë shkrirjes.

- 6 Ndryshe, e paditura pretendon se baza e kësaj shkrirje gjendet në Masat e Përkohshme për Mbrojtjen e të Drejtave të Vetë-Menaxhimit dhe Mbrojtjen Shoqërore të *F* të miratuara nga Kuvendi i Serbisë më 6 nëntor 1990. Për më tepër, e paditura pohon se ky ligj i fundit nuk nënkupton ligjin e zbatueshëm sipas Rreg. së UNMIK-ut 1999/24, së pari sepse nuk e plotëson hendekun legjislativ brenda kuptimit të nenit 1.2 të Rreg. së UNMIK-ut 1999/24. AKM-ja pretendon gjithashtu se neni 1.2 të Rreg. së UNMIK-ut [1999/24] paraqet një presupozim se ligjet e kaluara nga data 22 mars 1989, normalisht se nuk janë të zbatueshme dhe se barra e provave i mbetet paditësit që një ligj pas datës 22 mars 1989 nuk ishte diskriminues.
- 7 Në seancën dëgjimore të mbajtur më datën 20 qershor 2013, Trupi Gjykses e ftoi në cilësinë e të paditurës AKP-në si ex lege pasardhëse e ish- AKM-së. Në të njëjtën seancë dëgjimore, paditësi sqaroi se kompania paditëse (*S*) ishte shkrirë me kompaninë e quajtur “*T*” SH.P.K. nga B. P.[/Serbi], dhe si rezultat i kësaj paditësi do të duhej të konsiderohej si “*T*” SH.P.K. nga B. . [/Serbi].
- 8 Të dyja palët në këtë lëndë (paditësi dhe e paditura) konfirmuan se ato mbesin prapa padisë, përkatësisht, e paditura prapa mbrojtjes së parashtruar ndaj padisë së AKM-së më 26 tetor 2005.
- 9 Në seancën dëgjimore të mbajtur më 22 janar 2014, çështja kryesore ishte pranueshmëria dhe lidhja e dëshmisë së kërkuar. Pas seancës dëgjimore, kolegji vendosi se pranueshmëria dhe lidhja e dëshmimeve me shkrim, do të vendosej gjatë seancës vendimmarrëse për merita.
- 10 Seanca e fundit dëgjimore për këtë lëndë ishte zhvilluar më 13 mars 2014. Që të dyja palët deklaruan se [ata] nuk kanë propozime të reja për prova të tjera, andaj gjykata vendosi që ta mbyllë procedurën e provave për këtë lëndë dhe ua dha fjalën palëve për deklaratat përfundimtare.
- 11 Është e rëndësishme që të nënvizohet se të dyja palët i mbrojtën qëndrimet e tyre të mëparshme.

Pasi që të dyja palët i kërkuan shpenzimet, Gjyqtari Kryesues u dha atyre 5 ditë që ta specifikojnë shumën e shpenzimeve të kërkuara. 12

Më 14 mars 2014 (brenda afatit), AKP-ja iu përgjigj urdhrin të gjykatës dhe i kërkoj shpenzimet në shumën e përgjithshme prej ... euro (... euro). 13

Më 25 mars 2014 (pas afatit), përfaqësuesi i paditësit, iu përgjigj urdhrin të gjykatës dhe i kërkoj shpenzimet në shumën e përgjithshme prej ... euro (... euro). 14

Më 15 prill 2014, Kolegji i Specializuar ka marrë Aktgjykimin SCC-05-0113, me të cilin padia e parashtruar për kompensimin e tjetërsimit të pronës në shumën prej ... euro dhe humbjes së profitit në shumën prej ... euro, refuzohet tërësisht si e pabazuar. 15

Paditësi duhet t'ia paguajë AKP-së ... euro për shpenzimet procedurale. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi Kolegji i Specializuar thekson se pjesa kryesore e kësaj çështje gjyqësore qëndron në gjetjet e gjykatës lidhur me dy çështjet kryesore: 16

(1) Cilat ligje ishin të zbatueshme në shkrirjen e vitit 1992 dhe a ishin zbatuar ato ashtu siç duhet.

(2) A ishte thjeshtë fakti se në emër të "F" vendimi për shkrirje ishte lëshuar nga i ashtuquajtimi Organ i Brendshëm, i mjaftueshëm për ta konsideruar transformimin diskriminues.

Sipas paditësit, Ligji për Kompanitë do të zbatohet vetëm në vitin 1988 dhe shkrirja e kundërshtuar ishte bazuar në nenin e tij 187-a. Sipas pikëpamjes së të paditurës, tërësia e ligjeve të privatizimit, të miratuara kah fundi i viteve të 1980-ta dhe të njohura botërisht si "Ligjet e Markovicit", (sipas kryeministrit të fundit të RSFJ-së Ante Markovic) do të duhej të zbatoheshin. Prandaj shkrirja e bazuar në vetëm njërin nga ato, nuk ka efekt. 17

Sa i përket çështjes së dytë, paditësi e paraqet mendimin se edhe pse imponimi nga ana e Organit të Përkohshëm në NSH-në "F" ishte bazuar në ligje diskriminuese, kjo si e vetme nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar shkrirjen diskriminuese. Ajo çfarë është e rëndësishme sipas paditësit është, mënyra se si ishte bërë transformimi (në këtë rast 18

shkrirja). Fakti se shumica e punëtorëve të “F – S” SH.P.K. të cilëve u ishin dhënë aksionet falas ishin të origjinës shqiptare, dëshmon se procesi ishte zhvilluar në një mënyrë jo-diskriminuese, pretendon paditësi.

19 Sipas vlerësimit të gjykatës në shkallë të parë, përderisa privatizimi i pronës në fjalë ishte bërë në vitin 2004, do të zbatohet Rreg. e UNMIK-ut 2002/12. Sipas asaj Rregulloreje, neni 5.4, çfarëdo shkrirje që ka ndodhur pas datës 22 mars 1989 është e vlefshme vetëm nëse bazohet në ligjet e zbatueshme, dhe të jetë [e saktë: nëse është] ekzekutuar në mënyrë jo-diskriminuese. Shkrirja në fjalë kishte ndodhur në vitin 1992 dhe prandaj i përmbush të dyja kërkesat. Shkrirja ishte e tipit “marrje përsipër” – NSH “F” ishte absorbuar tërësisht nga SH.A. “S” dhe e kishte humbur personalitetin e saj ligjor. Kapitali në pronësi shoqërore i “F” ishte bërë pjesë e kapitalit kryesisht në pronësi private të kompanisë absorbuese. Prandaj, shkrirja e vitit 1992 ishte vetë shembulli klasik i privatizimit – një pjesë e kapitalit shoqëror ishte transferuar për t’u bërë pjesë e kompanisë kryesisht private. Rrjedhimisht–ligjet përkatëse të privatizimit do të zbatoheshin.

20 Gjykata gjeti se në kohën e shkrirjes, Ligji për Qarkullimin dhe Shitjen [e saktë; Disponimin] me Kapitalin Shoqëror (LQDKSH) i vitit 1990 ofronte rregulla lidhur me çështjet e privatizimit. Në të vërtetë, ky ligj – edhe në versionin e tij të parë të vitit 1989 – ishte miratuar pas afatit të parashikuar në Rreg. e UNMIK-ut 1999/24 (22 mars 1989). Megjithatë, ligji që ishte rregullorja e parë për privatizimin, nuk ishte vetë diskriminues dhe andaj duhet të zbatohet në përputhshmëri me nenin 1.2 të Rreg. së UNMIK-ut 1999/24. Sipas nenit 2.1 të LQDKSH-së, një ndërmarrje mund të shitet tërësisht ose pjesërisht dhe fondet e siguruar nga kjo i takojnë Fondit për Zhvillim – një organ i veçantë i themeluar në secilën prej anëtarëve përbërës të RSFJ-së. Kontrata për shitjen/privatizimin e entiteteve në pronësi shoqërore dhe kapital do të përmbylej nga Fondi për Zhvillim siç thotë neni 2-b [i LQDKSH-së]. Në pajtim me nenin 4 të të njëjtit ligj, agjenci të veçanta do të ofronin vlerësime mbi vlerën e kapitalit shoqëror për shitje. Shkrirja në mes të SH.A. “S” dhe N.SH. “F” e kishte efektin e shitjes për një Ndërmarrje Shoqërore të tërë dhe rregullat për privatizim do të zbatoheshin. Ndryshe, SH.A. “S” praktikisht e fitoi ndërmarrjen falas. Fakti se më vonë Menaxhmenti i Kompanisë u dha aksione falas punëtorëve të “F” është i parëndësishëm – punëtorët nuk ishin pronarët e kapitalit në pronësi shoqërore. Për sa kohë që kompania që i mbijetoi bashkimit fillestarë

kishte të meta ligjore, inkorporomi i mëvonshëm i SH.P.K.-së “F-S” si dhe të gjitha ndryshimet në regjistrim dhe në statusin e Kompanisë “S”, nuk kanë pasur efekt në kapitalin në pronësi shoqërore në fjalë. Për të tërë periudhën, nga themelimi i saj deri në privatizim në vitin 2004 “F – Fabrika e Tapetave” do të duhej të konsiderohej si NSH.

Kur është fjala për çështjen e diskriminimit përgjatë shkrirjes, gjykatat është e mendimit se në këtë rast nuk ka rëndësi. Duke vendosur për shkrirjen pa e ndjekur procedurën e rregullt të privatizimit, Organi i Përkohshëm i caktuar për NSH-në “F” e lëshoi një vendim të paligjshëm dhe nuk ka rëndësi nëse ky vendim ishte përmbuar në mënyrë jo-diskriminuese. **21**

Prandaj, padia për kompensim të humbjes së pronës dhe humbjes së profitit, do të refuzohet si të pabazuara. **22**

Më 19 maj 2014, ankesë kundër Aktgjykimit SCC-05-0113 të datës 15 prill 2014 të Kolegjit të Specializuar, ka parashtruar “T” Sh.A. nga B. P.- Serbi, për shkak të siç thuhet, shkelje të procedurës, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar të ligjit. **23**

Fillimisht ankuesi e kundërshton vlerësimin e Kolegjit të Specializuar, që kishte konstatuar se, bashkëngjitja-bashkimi i “F” dhe “S”, i cili është bërë 1992, ka paraqitur shembull klasik të privatizimit, duke pasur parasysh se është bërë kalimi i kapitalit shoqërorë, kështu që ajo bëhet kryesisht kompani private, për këtë arsye janë zbatuar ligjet për privatizim, para së gjithash, LQDKSH. Kolegji ka vërtetuar se edhe pse LQDKSH, është aprovuar pas 22 marsit 1989, i njëjti nuk është diskriminues dhe duhet të zbatohet në përputhje me nenin 1.2 të Rreg. nr. 1999/24, të UNMIK-ut. Kolegji ka konstatuar që me vendosjen për bashkangjitjen, pa respektuar procedurat gjegjëse të privatizimit, të cilat organi i përkohshëm ia ka imponuar NSH “F”, është aprovuar Vendimi jo legal, dhe nuk është e rëndësishme se si është sjellë ai Vendim. **24**

Sipas ankuesit, në transaksionin lëndor është zbatuar LN (fleta zyrtare RSFJ nr. 77/88, 40/89). Ligji është i vlefshëm së bashku me pjesën 1.1 të Rreg. nr. 1999/24 të UNMIK-ut, duke pasur parasysh se ka hyrë në fuqi më 1 janar 1989, që do të thotë para 22 marsit 1989. Neni 187.1 i LN, parasheh që vendimet për ndryshimin statusor të ndërmarrjes **25**

(ndarja ose bashkëngjitja), i merr Organi Administrativ i ndërmarrjes. Në nenin nr. 187a.3 [i LN], parasheh që marrëdhëniet reciproke të ndërmarrjeve, të cilat kanë rrjedhur nga ndryshimi statusor, do të rregullohen me kontratë. Për këtë arsye, menaxhmenti i ndërmarrjes “F” - Organi i përkohshëm, ka marrë Vendimin për bashkangjijtjen-bashkimin, gjegjësisht integrimin e ndërmarrjes “F” me ndërmarrjen “S”, më 28 tetor 1992. Në përputhje me këtë shihet se është zbatuar procedura e cila është paraparë me nenin 187a.1 i LN. Përveç kësaj, ndërmarrjet “F” dhe “S”, më 28 tetor 1992, kanë nënshkruar Protokolin, me të cilin kanë rregulluar marrëdhëniet reciproke, në përputhje me nenin 187a.3 të LN. Neni 27 i LN, parasheh që ndërmarrjet e cekura në paragrafin (1) deri (4) të këtij neni, (ndërmarrjet në pronësi shoqërore, ndërmarrjet e kooperativave, ndërmarrjet në pronësi të përzier, si dhe ndërmarrjet në pronësi private), kanë status të njëjtë, por edhe të drejta dhe obligime në treg. Duke pasur parasysh këtë dispozitë, është e qartë që ndërmarrjet në pronësi shoqërore, po ashtu kanë pasur të drejtë dhe obligime në procedurën e bashkimit me ndërmarrjen në pronësi private, në përputhje me nenin 187 a, të LN. Nuk ekziston asnjë dispozitë me të cilën do të ndalohej bashkimi i cekur, thekson ankuesi. Sipas tij, arsyetimi i Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së Parë, është i gabuar, duke pasur parasysh që kapitali shoqëror i “F”, bëhet pjesë e ndërmarrjes në pronësi private. Në transaksionin ekzistues duhet të zbatohet LQDKSH. Në atë kohë kanë qenë në fuqi, gjegjësisht kanë qenë të vlefshme LQDKSH dhe LN, dhe nuk ka patur dispozita të cilat do t’ a kishin obliguar “F” dhe “S”, të zbatojnë LQDKSH në vend të LN. F dhe S kanë zgjedhur t’ a zbatojnë LN, për arsye se kjo ka qenë në interesin e përbashkët të këtyre ndërmarrjeve, duke marrë parasysh se kjo ka qenë mënyra më efikase që të fillohet bashkëpunimi afarist. Përveç kësaj, ligjshmëria e këtyre transaksioneve po ashtu vërtetohen edhe me faktin që ai transaksion (bashkimi dhe ndarja) kanë qenë të regjistruara te organi kompetent i pushtetit, d.m.th. në Gjykatën Ekonomike në P. dhe në gjykatën Ekonomike në N. S./[Serbi].

26 Po ashtu, duhet të kihet [kushtohet] vëmendja që Rreg. e UN-MIK-ut 2002/12, parasheh që bashkangjijtja-bashkimi, mund të bëhet në rastet kur janë në pyetje ndërmarrjet në pronësi shoqërore, në mënyrën si është përkohshëm në nenin 5.4 të kësaj Rregullore parasheh si vijon:

Ri-regjistrimi ose bashkimi i ndërmarrjeve në pronësi publike ose shoqërore, pas 22 marsit 1989, do të ketë ndikim në statusin e asaj ndërmarrje, si ndërmarrje publike, ose ndërmarrje në pronësi shoqërore, vetëm nëse ai ri-regjistrim ose

bashkim ka qenë: E kryer në bazë të ligjit në fuqi dhe nëse është zbatuar në mënyrë jodiskriminuese.

Pa marrë parasysh në atë që u cek më lart, mbi cilën do bazë që është mbështetur për transaksionin lëndorë qoftë të ketë qenë edhe LN ose LQDKSH, transaksioni ka qenë i lejuar sipas ligjit në fuqi. 27

Bashkangjitja dhe ndarja e NSH-ve, është e lejuar sipas LN (i cili vlen në përputhje me Rreg. e UNMIK-ut nr. 1999/12 [e saktë 24], duke pasur parasysh se është aprovuar më 22 mars 1989. Po ashtu transformimi i kapitalit shoqëror në kapital privat është i lejuar në përputhje me LQDKSH (i cili i është vlefshëm duke pasur parasysh se nuk është diskriminues, në përputhje me pjesën 1.2 të Rreg. së UNMIK-ut 1999/12 [e saktë 24]. Baza e transaksionit të caktuar, është ajo që është e vlefshme për zbatimin e nenit 5.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2002/12, jo hapat të cilët është dashur të ndërmerren gjatë procesit të implementimit të këtij transaksioni. Duke pasur parasysh të gjitha ato që u cekën më parë, bashkimi dhe ndarja e “F, ka qene i bazuar në ligj të vlefshëm. Prandaj, kushti i parë sipas nenit 5.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2002/12 ka qen i plotësuar. Kushti i dytë se transaksioni është implementuar në mënyrë jodiskriminuese, po ashtu ka qen i plotësuar, sikur që do të sqarohet në paragrafin vijues. 28

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 22 janar 2014, i padituri ka vërtetuar se e vetmja pyetje e cila mbetet kontestuese në mes të palëve është çështja, nëse masat e përkohshme kanë qenë diskriminuese ose jo. E paditura, nuk e përmend mënyrën jodiskriminuese të bashkimit, si kontestues. Kjo është e mjaftueshme që Gjykata të konstatoj se është plotësuar kushti i dytë nga neni 5.4 të Rreg. së UNMIK-ut 2002/12. Kjo, sipas ankuesit vërtetohet para së gjithash me faktin se gjatë procesit nuk ka pasur të përjashtuar nga puna të të punësuarve shqiptar. Në këtë kuptim, duhet të ceket se i padituri ka siguruar prova në raport me përjashtimin e punëtorëve, gjë që ka ndodhur para bashkimit të “F”. Megjithatë, shkarkimi i z. *Sa Sa*, që ka ndodhur në dhjetorë 1990, kurse përjashtimi i z. *R Z*, në tetor të vitit 1991. Bashkimi i “F” është bërë në tetor 1992, kurse këto përjashtime nuk mund të kenë qenë pengesë për bashkim dhe nuk vërtetojnë të thëniet e të paditurës, se është në pyetje mënyra diskriminuese e bashkimit të “F”. I paditura nuk ka ofruar asnjë provë se ka pasur përjashtime pas bashkimit (sepse nuk ka pasur përjashtime të punëtorëve). 29

30 Në lidhje me Raportin mbi Përcaktimin e Statusit (SDR) me të cilën e paditura, po ashtu ka dëshiruar të tregoi që pas bashkimit të “F”, kanë pasuar veprimet diskriminuese. Padiësi konstaton që SDR, përmban gabime. Për shembull, nën pikën b 2.4 [të] SDR, gabimisht është cekur që shefi i shërbimit juridik, është përfshirë për shkaqe politike më 1993. Për më tepër zonj. So Gj, shefe e njësisë juridike ka vazhduar të punoj në “F”, deri më 1999. Nën pikën B [e saktë: b] 8.2 [të SDR], ceket se regjistrimi i shoqërisë si “F-S”, argument që Serbia e konsideron kompaninë si shoqërore, deri sa ekstrakti i bashkangjitur, nga regjistri gjyqësor, tregon që kompania është në pronësi private. Është shumë e qartë që qëllimi i SDR-s ka qenë, jo që të tregoj mënyrën në të cilën është kryer bashkimi i “F”, por që të paditurës t’i ofroi bazë për të anuluar bashkimin, dhe pastaj që “F” të shitet, kinse bashkimi kurrë nuk ka ndodhur.

31 Ankuesi përsëritë [e saktë: përgjigjet] dhe citon nenin 5.4, të Rreg. së UNMIK-ut nr. 2002/12 i cili rregullon:

Riregjistrimi ose bashkëngjitja e ndërmarrjes shoqërore ose publike pas 22 mars 1989, ndikon në statusin e saj, si ndërmarrje shoqërore ose publike, vetëm nëse ky riregjistrim ose bashkëngjitje: Është e bazuar në ligjin në fuqi, dhe e bërë në mënyrë jo diskriminuese.

Fakti që Organi i përkohshëm ka administruar me “F”, në kohën e bashkimit të “S”, nuk mund të konsiderohet diskriminim në vetëvete, për arsyet si vijon: (i) shumica e të punësuarve ende ka qenë të nacionalitetit shqiptar, (ii), asnjë nga të punësuarit shqiptar nuk është larguar nga puna, (iii) shqiptarët e punësuar kanë pasur të njëjtin status si para bashkimit, kanë fituar aksione pa pagesë në “S”, gjë e cila nuk është kontestuese në mes të palëve.

32 Nga të gjitha këto fakte e argumente, ankuesi propozon që Kolegji i Apelit në tërësi ta ndryshoj [e saktë: prish] Aktgjykimin e ankimuar SCC-05-0113, të datës 16 prill 2014, dhe që të pranohet kërkesa e padiësit dhe të obligohet e paditura që padiësit t’i paguaj shumën prej ...euro, me kamatë nga 16 shtator 2004, deri në pagesën e fundit, si dhe të paguaj padiësit shumën prej ... euro, me kamatë, dhe t’ia kompensoj padiësit shumën prej ... euro, për shpenzimet procedurale, ose ta anuloj në tërësi Aktgjykimin e ankimuar.

33 Më 29 maj 2014, AKP ka parashtruar përgjigje në këtë ankesë, e në të cilën thuhet ndër të tjera se, AKP në tërësi e kundërshton ankesën,

duke e konsideruar si të pabazuar në ligj. Përfaqësuesit e ankuesit vetëm se kanë përsëritur deklaratimet e tyre të pabazuara të paraqitura më herët në procedurë, dhe nuk kanë dëshmuar se ka pasur ndonjë shkelje të pretenduar. Për këtë arsye, AKP e mbështet Aktgjykimin e kundërshtuar dhe e konsideron atë si të drejtë dhe të ligjshëm.

AKP propozon që të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet Aktgjykimi i kundërshtuar. **34**

Arsyetimi ligjor: Ankesa është e pabazuar. **35**

Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës. **36**

Kolegji i Apelit, pasi që trajtoi në mënyrë të kujdesshme të gjitha pretendimet ankimore, Aktgjykimin e ankimuar dhe të gjitha provat që janë të parashtruara në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se ankesa është e pabazuar. **37**

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e Kolegjit të Apelit

Ankuesi e ka kundërshtuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në të gjitha pikat e arsyetimit të tij. **38**

Ankuesi parafrazon nenin 27 të LN, që sipas tij, parasheh që ndërmarrjet e cekura në paragrafin 1 deri 4 të këtij neni, (ndërmarrjet në pronësi shoqërore, ndërmarrjet e kooperativave, ndërmarrjet në pronësi të përzier, si dhe ndërmarrjet në pronësi private), kanë status të njëjtë, por edhe të drejta dhe obligime në treg. Sipas ankuesit, duke pasur parasysh këtë dispozitë, është e qartë që NSH-të, po ashtu kanë pasur të drejtë dhe obligime në procedurën e bashkimit me ndërmarrjen në pronësi private, në përputhje me nenin 187(a), të LN, dhe nuk ekziston asnjë dispozitë me të cilën do të ndalohej bashkimi i cekur, thekson ankuesi. **39**

Duke u bazuar në këto pretendime të ankuesit, Kolegji i Apelit ka gjetur se paragrafi një dhe katër, i nenit 27 të LN, të cilit i referohet ankuesi, parasheh decidivisht se për vendimin mbi bashkangjiteten e një ndërmarrjeje tjetër nga ndërmarrja që bashkangjitet [e saktë: bashkimi i një ndërmarrjeje me tjetrën], është i domosdoshëm pëlqimi i Këshillit të **40**

Punëtorëve të asaj ndërmarrjeje. Nga faktet e prezantuara në shkresat e lëndës del që këtë vendim, përmes një Protokolli, të nënshkruar nga anëtarët e organit të përkohshëm të “F”, i instaluar nga Serbia, dhe një përfaqësuesi të SHA “S”, e kanë marrë pa asnjë pjesëtar të nacionalitetit shqiptar, dhe me këtë është lejuar bashkimi i NSH “F” me SHA “S” nga B. P.- Serbi. Me këtë rast, është marrë një vendim jo legal, sepse është marrë nga organi i përkohshëm, pa lejen e Këshillit të Punëtorëve, i cili përfaqëson interesin dhe vullnetin e punëtorëve [të NSH-së].

- 41 Kolegji i Ankesave gjithashtu gjeti se konform nenit 14 të LN (Gazeta Zyrtare nr. 77, [e datës] 31 dhjetor 1988) *për organizimin e organizatës themelore të punës së bashkuar, vendosin punëtorët në përputhje me Statutin e ndërmarrjes.*
- 42 Ndërkohë, Statuti i kësaj NSH-je këtë çështje e ka rregulluar në nenin 13, ku thuhet se *punëtorët mund të bëjnë ndryshime në organizimin e ndërmarrjes, ashtu që mundtë bashkohen, t'i bashkëngjitet një ndërmarrjeje tjetër, apo të ndahet në dy e më shumë ndërmarrje. Lidhur me ndryshimet dhe organizimin e ndërmarrjes, punëtorët vendosin me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të punëtorëve përmes referendumit.*
- 43 Nga kjo që u citua më lartë, është e qartë se në rastin konkret, ndryshimet në ndërmarrje janë bërë në kundërshtim të plotë me nenin 13 të LN, dhe në kundërshtim me nenin 13 të Statutit të Ndërmarrjes.
- 44 Sipas ankuesit, neni 187(1), i LN, parasheh që vendimet për ndryshimin statusor të ndërmarrjes (ndarja ose bashkëngjitja), i merr Organi Udhëheqës i ndërmarrjes. Ankuesi gjithashtu citon nenin 187a.3, të LN, i cili parasheh që marrëdhëniet reciproke të ndërmarrjeve të cilat kanë rrjedhur nga ndryshimi statusor, do të rregullohen me kontratë.
- 45 Kolegji i Apelit ka gjetur se neni 187 i LN, nga 29 dhjetori 1988, të cilit i referohet ankuesi, me Plotësimet dhe Ndryshimet këtij Ligji më 8 gusht 1990, ky nen (187) ishte fshirë, duke u shtuar neni 187a, që fliste për ndryshimet statutare. Ky ndryshim i Ligjit bazik, në bazë të të cilit edhe është marrë vendimi, ka ndodhur pas periudhës së paraparë me nenin 1.1 dhe 2 të Rreg. së UNMIK-ut, nr. 1999/24, për ligjet diskriminuese, sepse ndryshimi i këtij ligji ka ndodhur më 8 gusht 1990. Për këto arsye, edhe këto pretendime ankimore janë të pabazuara.

Kolegji i Apelit gjenë se fillimisht, Vendimi ishte marrë nga një organ i përkohshëm, në kohën e futjes së masave të dhunshme në të gjitha ndërmarrjet e Kosovës, fakte këto të njohura botërisht, dhe vendimet e këtij organi kanë qenë arbitrare dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore. Pra, vendimi është marrë nga një organ jo kompetente, andaj vendimi i tillë ishte i paligjshëm që nga fillimi. 46

Në anën tjetër, sa i përket kërkesës tjetër ligjore të nenit 187a(3), i cili parasheh që “marrëdhëniet reciproke të ndërmarrjeve të cilat kanë rrjedhur nga ndryshimi statusor do të rregullohen me kontratë”. 47

Në këtë rast nuk kemi asnjë marrëdhënie të tillë reciprociteti, sepse këtu kapitali shoqëror i “F” është falur tek një kompani private. Kjo është edhe në kundërshtim me LQDKSH, i cili në nenin 2 flet për shitjen e këtij kapitali, dhe për organin i cili mund të marrë një vendim për këtë shitje, e që është Këshilli i Punëtorëve. Përkundrazi, në rastin konkret kemi falje, apo shkrimje të kapitalit shoqëror të NSH “F”, tek një SHA në Serbi, që paraqet një shembull tipik të vendimeve arbitrare dhe jo legale. 48

Kolegji i Apelit ka gjetur se vërtetë, siç ka theksuar edhe ankuesi, një numër i madh i punëtorëve shqiptarë kishin mbetur në punë, madje edhe iu kishin shpërndarë aksione. Megjithatë problemi qëndron në faktin se a mbeti në punë ndonjëri prej udhëheqësve shqiptarë të NSH-së. Nëse shikohet në procesverbalin e datës 28 tetor 1992, ku është diskutuar procedura e këtij bashkimi dhe për arsyet e këtij transformimi të “F”, shihet se prej 6 anëtarëve të Organit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrjeje, asnjëri prej tyre nuk ishte shqiptar. 49

Kjo e vërteton momentin tjetër shumë të rëndësishëm, se të gjitha procedurat e transformimit i kishte marrë organi i dhunshëm, apo i përkohshëm, i instaluar nga pushteti në Beograd, pa asnjë udhëheqës të deriatëhershëm shqiptarë, por edhe pa asnjë leje nga Këshilli i punëtorëve. Edhe pse një numër prej këtyre punëtorëve ende ishin në punë, udhëheqësit [të gjithë shqiptarë] e kësaj NSH-je ishin pushuar nga puna, sepse ata ishin zëvendësuar me udhëheqje të dhunshëm, ndërsa fuqia punëtore e cila u duhej për vazhdimësinë e prodhimit, kishte mbetur ende të punoj. 50

Për të gjitha arsyet e lartcekura, Kolegji i Apelit konstaton se pretendimet ankimore të paditësit, nuk janë të bazuara, andaj ankesa refuzohet 51

si e pabazuar, ndërsa rrjedhimisht vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

52 Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, dhe konform nenit 10.10 të LDHP, Kolegji i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

⌚⌚⌚

Detyra e Gjykatës të Vërtetojë Interesin Ligjorë të Padiçës /E Drejta Subjektive për Inicimin e Procedurës

Juridiksioni; Dërgimi në rigjykim; Mos-Referimi

LMTHPJ neni 29; LPK neni 354.2, 14, 2.4, 391, 114, 194, 2.4(e), 182.2(k), 137.2 dhe (3), 362, 357.2, 183; Shtojca e LDHP neni 28.2.2; 28.2, 42; LDHP neni 5.1, 4.4

1. Është detyrë e gjykatës që të vërtetojë interesin juridik të padiçës.
2. Interesi ligjorë është një kusht absolut për pranueshmërinë e padiçës.
3. Vetëm mbajtësi i një të drejte subjektive apo pasardhësi ligjorë me të drejtë subjektive e cila është mohuar apo shkelur nga personi i tretë mund të iniciojë procedurat për njohjen apo rivendosjen e një të drejte.

Aktvendimi i datës 14 maj 2015 – AC-II-12-0029 (Shkalla e parë: Aktvendimi i datës 11 maj 2011 i Gjykatës Komunale në K – C.nr.148/07)

Rrethanat faktike dhe procedurale: Më 5 prill 2007 padiçesi parash-troi një padi në DHPGJS me të cilën kërkon vërtetimin e pronësisë për parcelat kadastrale nr. ..., ..., ..., ..., ..., ..., ... dhe ... në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha (tani si ngastra kadastrale ... , Fleta Poseduese nr. ... te evidentuar ne emër të PSh. Kooperativa Sh. nga Sh. të regjistruara në certifikatën nr ... të datës 21 nëntor 2003.

Padia regjistrohet me nr. SCC-07-0143.

Padiçesi i kërkon gjykatës të detyrojë të padituritë të njohë të drejtën e pronësisë për parcelat e cekura më sipër dhe të lejojë që të njëjtat të

regjistruhen në librat kadastral në emër të paditësit. Ai kërkon gjithashtu kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Ai pohon se është dhe ka qenë vazhdimisht posedues dhe shfrytëzues i parcelave të lartpërmendur.

- 4 Më tej, ai pohon se pas procesit të fotografimit ajror të vitit 1958, ato ishin të regjistruar në pronësinë e tij, por më pas në vitin 1964, të njëjtat parcela u shfaqën në emrin e KBI nga P. Ndërsa në vitin 1992 KBI-ja ia transferoi të drejtat e saj pronësore tek i padituri i dytë, P B, Sh. Paditësi ka paraqitur si provë në mbështetje të pretendimeve të tij midis të tjerave Çertifikatën, ... nga Departamenti Kadastral i Komunës së K. Aktvendimin nr. ..., ... dhe ..., Aktvendimin ..., Fletën poseduese nr. ..., Aktvendimin mbi Trashëgiminë O.[br]. ..., kopja e planit, të dhënat nga Drejtoria për urbanizëm dhe kadastrë e Komunës si dhe Raportin e Eksperit – Gjeometër.
- 5 Më 8 gusht 2007 me Aktvendim SCC-07-0143, DHPGJS e referon lëndën në Gjykatën Komunale, K. për shqyrtim.
- 6 Më 11 maj 2011, Gjykata Komunale në K. me Aktgjykim C. nr. 148/07 ka refuzuar kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar me arsyetim se kjo pronë, asnjëherë nuk ka qenë në pronësi të paditësit. Ketë konstatim Gjykata e nxjerre nga Aktvendimi nr. ... i Komisionit Komunale sipas të cilit paditësi që nga viti 1958 ka qenë uzurpatorë i kësaj prone. Gjithashtu Gjykata refuzoi edhe kërkesën e paditësit për njohjen e të drejtës së pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues duke arsyetuar se sipas nenit 29 të LMTHPJ prona shoqërore nuk mund të fitohet me parashkrim fitues.
- 7 Më 5 gusht 2011 paditësi (ankuesi) ka parashtruar ankesë kundër këtij Aktgjykimi për shkak të, siç thuhet, shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, verifikimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Sipas tij ky Aktgjykim duhet prishur për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354.2, pika 14 e LPK për shkak se faktet mbi të cilat mbështetet Aktgjykimi nuk janë të arsyetuara fare dhe në mes tyre ekzistojnë kontradikta. Për më tepër disa deklarata në seancën dëgjimore nuk janë evidentuar në procesverbal. Gjykata nuk morri fare për bazë kërkesën e paditësit lidhur me sigurimin e shkresave të lëndës C.nr. ... me të cilat vërtetohet se paraardhësi i paditësve B K ka iniciuar kontest civil lidhur me pronën në fjalë që në

vitin 1972 si dhe shkresat nga lënda OV. nr. ... në procedurën administrative, mungesa e të cilave ka bërë që të nxirret Aktgjykim refuzues.

8

Shkelje tjetër e esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore paditësi pohon edhe mos përpilimin e procesverbalit me rastin e daljes në vend ngjarje me prezencën e ekspertit të gjeodezisë Gjykata në këtë situatë vetëm ka konstatuar se ka marrë mendimin e ekspertit.

Më tej ai pohon se me këtë Aktgjykim nuk janë vërtetuar mirë dhe në mënyrë të drejtë edhe gjendja faktike. Sipas tij Gjykata nuk ka marrë parasysh faktin se paraardhësi i paditësi, tani i ndjeri *B K* që nga viti 1928 e ka pasur në pronësi këtë patundshmëri në shfrytëzim dhe posedim të ndërgjegjshëm.

Vërtetimi i gjendjes faktike vetëm në bazë të fletëparaqitjes së Komisionit për shqyrtimin e marrëdhënieve pronësore juridike nr. ... i datës 9 maj 1962 sipas të cilit paraardhësi është shpallur uzurpator është një konstatim i gabuar. Sepse i ndjeri ka kontestuar këtë Aktvendim dhe ka iniciuar procedurën administrative para atij Komisioni. Me datën 15 nëntor 1971 me Aktvendimin nr. ... i siguruar vetëm pas nxjerrjes së Aktgjykimit për shkak se Komuna e K. e kishte në posedim dhe në Gjykatë nuk dëshironte ta parashtronte, vërehet se janë hedhur poshtë, fletë paraqitjet për uzurpimin e tokës ndërsa në arsyetim të këtij Vendimi konstatohet se paraardhësi i paditësi është pronare i këtyre patundshmërive që nga vitit 1928. Me këtë Aktvendim Kuvendi Komunal ka qenë i obliguar që këtë patundshmëri ta bart në emër të paditësit. Megjithatë, me Vendime arbitrare nr. ... i datës 11 nëntor 1963 dhe nr. ... i datës 23 nëntor 1963 në mënyrë arbitrare patundshmërinë e paditësi e barte tek Kooperativa Bujqësore (KB) "*R A*", K. e cila me një Kontratë për transferimin e të drejtës në shfrytëzim, patundshmërinë e barte tek (KBI) "*K E*" P. ndërsa më vonë një pjesë e kësaj patundshmërive i është dhënë në shfrytëzim KB "*P B*", Sh.

Gjykata nuk mori për bazë thëniet e paditësit si dhe deklaratën e dëshmitarit se këtë patundshmëri e ka në posedim të ndërgjegjshëm. Ajo nuk mori në konsiderim faktin se deri më 1958 kur është kryer aeroincizimi, patundshmëritë ishin të evidentuar në emër të paditësit. Këtë e vërteton Certifikata ... e datës 21 nëntor 2003 si dhe kopja e planit.

Nga të cekurat më lartë paditësi[/ankuesi] kërkon nga Kolegji i Ankesave që ankesën e paditësit të aprovoi si të bazuar të prish Aktgjykimin e Gjykatës Komunale K. C.nr.148/07 i datës 11 maj 2011 dhe lëndën të kthej në Gjykatën Komunale për rishqyrtim dhe rivendosje.

- 9 Më 24 nëntor 2014 ,përgjigje ndaj ankesës parashtrori e paditura e parë komuna e K. Ajo deklaroi se Vendimi i Këshillit popullor nr. ... i datës dhjetor 1962 saktësisht vërtetoi se paraardhësi i paditësve ishte uzurpator. Ndërsa as edhe deri me sot ankuesi/paditësi nuk ka arritur të vërtetojë pronësinë mbi patundshmërinë kontestuese. Andaj ankesa e paditësit duhet refuzuar si e pa bazuar.
- 10 Ndërsa e paditura e dytë AKP-ja në përgjigjen e vetë të datës dhjetor 2014 i hedh poshtë të gjitha pretendimet e ankuesit si të pa bazuara duke e konsideruar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale si të drejtë dhe të bazuar në Ligj. Për më tepër sipas AKP-së, ankuesi as në ankese nuk ka arritur të paraqes ndonjë fakt relevant i cili do mund të ndryshonte gjendjen faktike të konstatuar nga Gjykata Komunale. Andaj kërkon nga Kolegji i Ankesave që ankesën të refuzoj si të pa bazuar.
- 11 **Arsyetimi ligjor:** Ankesa është e bazuar.
- 12 Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.
- 13 Kolegji i Ankesave duke u bazuar në pretendimet ankimore, Aktvendimin e ankimuar dhe në provat nga shkresat e lëndës gjënë se ankesa është e bazuar, ndërsa Aktvendimi i ankimuar është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj.
- 14 Paditësi kërkon vërtetimin e pronësisë. Ai pohon se paraardhësi të tij tani i ndjere *B K* i është marrë prona në mënyrë të kundërligjshme. Në bazë të padisë por edhe të dokumenteve valide, paraardhësi i tij ka qene pronare i këtyre pronave që nga viti 1928, ndërsa pas aerofotografimit të vitit 1958, me Vendimin e datës 9 maj 1962 ngastrat kadastrale nr. ..., ..., ..., ..., ..., ... dhe ... në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha, tani si ngastra kadastrale ..., Fleta Poseduese nr. ... janë transformuar si pronë shoqërore.
- 15 Ai në asnjë rast nuk sqaron marrëdhëniet e tij me të ndjerin, *B K*. Aktvendimi mbi trashëgimin *O.br.* ... i datës 15 janar 1964 i parashtruar ne seancën dëgjimore para Gjykatës Komunale është nxjerre për trashëgimlënësin *A K* sipas të cilit trashëgimtar të patundshmërisë së tij caktohen nipërit *B, F* dhe mbesa *M*.

Prandaj Kolegji i Apelit konsideron se Aktvendimi mbi trashëgiminë, O.br. ... i konsideruar nga Gjykata Komunale si vlefshëm nuk mund të konsiderohet si dëshmi me të cilin vërtetohet përfundimisht legjitimiteti i paditësit. Kjo, edhe për faktin se Aktvendimi ... për marrjen e patundshmërisë i referohet *B K* madje edhe vete paditësi në padi kërkon pronën e cila ishte në emër të *B K*. Për më tepër edhe Aktvendimi Komisionit për shqyrtimin e marrëdhënieve pronësore të personave të vetëquajtur pronarë, ... prona e kërkuar nga paditësi i është kthyer *B K*. Të njëjtën e vërtetojnë edhe shkresa e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Urbanizëm dhe kadastrë se këto prona sipas kadastrit përshkruet ish-in në emër të *B K*. **16**

Është detyrë e gjykatës që të vërtetojë interesin juridik të paditësit. Padia mund të ngrihet nga pala të cilit i cenohen interesat dhe të drejtat e tij subjektive, aktuale dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Neni 2.4 dhe 391(e) i LPK sipas nenit 114 i LPK-së (i cili Ligj nga DHP mund të zbatohet kurdo që është e nevojshme për të zgjedhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me LDHP), kusht për pranueshmërinë e padisë është edhe, ekzistimi i interesit juridik të paditësit. Po ashtu është detyrë e Gjykatës së ankimit që brenda kufijve të saktësuara me nenin 194 të LPK-së të ekzaminojë Aktgjykimin e shkallës së parë duke u kujdesur zyrtarisht për zbatimin e së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2(k) [e LPK-së]. **17**

Nga te cekurat me larte Kolegji i Apelit vjen në përfundim se padia ngrihet vetëm kur personi ka interes të ligjshëm në njohjen ose rrëzimin e një pretendimi. Që të iniciohet kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, duhet të behet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta subjektive e mohuar ose e shkelur prej një të treti. **18**

Interesi juridik është një nga kushtet kryesore objektive për të ngritur padi që është ekzistenca e interesit të ligjshëm, prandaj, padia mund të ngritet vetëm prej atij që sipas ligjit i përket e drejta subjektive e shkelur ose e mohuar. **19**

Gjithashtu neni 28.2.2 i Shtojcës së LDHP, kërkon që kërkesa apo ankesa duhet të paraqitet kundër një pale që ka të drejtë të nis procedurat para DHPGJS në mbështetje të nenit 5.1 të LDHP. **20**

- 21 Në bazë të këtyre të dhënave Kolegji i Apelit konsideron se Gjykata Komunale në K. nuk e ka vërtetuar interesin juridik të paditësit në këtë padi. Me këtë rast ajo ka bërë shkelje të dispozitave kontestimore përkatësisht nenit 391(e) i LPK-së si dhe nenit 28.2 të Shtojcës së LDHP.
- 22 Prandaj i mbetet Kolegjit të Specializuar të vërtetojë ekzistimin e interesit juridik të paditësit apo se kush mund të jetë parashtrues i kërkesës para DHPGJS.
- 23 Sa i përket pretendimeve të ankuesit [se] në procesverbalin e seancës dëgjimore nuk janë evidentuar disa deklaratat, kolegji i Apelit i kujton Ankuesit se sipas nenit 137.2 dhe (3) të LPK-së ka pasur të drejtën të kërkojë nga Gjykata që t'i lexohet procesverbali dhe më pas t'i paraqes kundërshtimet e tija lidhur me përmbajtjen e këtij dokumenti të cilën Ankuesi nuk e ka bërë. Prandaj pretendimet ankimore në këtë pikë janë të pa bazuara. Gjithashtu i pa bazuar është edhe pretendimi për mos përpilimin e procesverbalit me rastin e daljes në vend ngjarje me prezencën e ekspertit të gjeodezisë. Kolegji i Apelit konstaton se në shkresat e lëndës gjendet procesverbali i vend shikimit i datës 29 tetor 2010 me prezencën edhe të ekspertit-gjeometër dhe përfaqësuesin e paditësit. Kolegji i Apelit vëren se raporti i ekspertit nuk është shqyrtuar në seancën dëgjimore madje as eksperti nuk është ftuar me këtë rast është shkelje neni 362 i LPK-së për faktin se Gjykata nuk i ka dhënë palëve mundësi të deklarohej lidhur me Raportin e Ekspertit neni 357.2 i LPK-së. Për pasojë nuk është konstatuar se një ngastër kadastrale nr. ... dhe ... nga fleta poseduese ... ish parcela nr. ... është shpronësuar në interes të magjistrales H. i E.- M.
- 24 Gjykata Komunale në K. me Aktgjykimin e vetë nuk e ka trajtuar fare edhe Aktvendimin e plotfuqishëm nr. ... të datës ... me të cilin B K i lejohet revizioni kthehet patundshmëria e marre me Aktvendimin ... të datës 9 maj 1962. Ky Aktvendim nga Kolegji i Apelit është gjetur edhe në dosjen e Gjykatës Komunale. Me këtë Aktgjykim, Gjykata Komunale ka bërë shkelje të nenit 183 të LPK-së.
- 25 Lidhur me pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të posedimit të ndërgjegjshëm, Kolegji i Apelit vëren se Gjykata Komunale pas kërkesës së palës do të duhej që vetë të sig-

uroj dëshminë e gjegjësisht shkresat e Lëndës C.nr. ... të viti... , këtë e kërkon edhe neni 42 i Shtojcës së LDHP parashih se gjykata mund të kërkoj një dokument nëse për këtë kërkohet nga pala e cila dëshmon se përkundër përpjekjeve nuk ka arritur ta siguroj. Nga te dhëna e ofruara në dosje vërehet se lënda ... është ne Gjykatën Komunale në K. dhe kjo Gjykatë ka mundur të vërtetoj ekzistimin apo mos ekzistimin e kësaj prove.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, është e qartë se Gjykata Komunale [në K.] me rastin e marrjes së Aktgjykimit të kundërshtuar, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave dhe në këtë mënyrë ka nxjerr një Aktgjykim jo të drejtë dhe jo të bazuar në ligj, andaj si i tillë duhet të anulohet. **26**

Pasi që në pajtim me nenin 4.4 të LDHP, as DHPGJS, e as kolegjet apo gjyqtarët e saj, nuk do të kenë asnjë autoritet për t'i referuar ndonjë kërkesë, lëndë, procedurë apo rast specifik që është kompetencë primare e tyre tek gjykatat tjera të Kosovës, kjo çështje nuk mund të kthehet në Gjykatën e që ka lëshuar Aktvendim të ankimuar, Kolegji i Ankesave vendos që ajo do të dërgohen për gjykim të mëtejshëm Kolegjit përkatës të Specializuara të DHPGJS-së . **27**

Rrjedhimisht, lënda dërgohet në rigjykim në meritat e saj në Kolegjin përkatës të Specializuar. Ky kolegji duhet t'i merr parasysh vërejtjet e Kolegjit të Apelit, duke e gjykuar në meritat e saj këtë padi, dhe duke trajtuar në mënyrë të duhur palët në procedurë, për të pasur një gjykim të drejtë.

Andaj me sa u tha, e në bazë të nenit 10.10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme është vendosur si në dispozitiv. **28**

⌚⌚⌚

Zgjedhja e AKP-së lidhur me anulimin e tenderit nuk është pa kufizime

Masë e përkohshme; Pozita e ofertuesit më të lartë; Anulimi i procedurës së tenderit nga AKP-ja; Obligimi i AKP-së për të informuar në mënyrë të duhur ofertuesin përkatës lidhur me anulimin e procedurës së tenderit

UA e UNMIK-ut 2008/6 neni 55 (Prej 1 janarit 2012: Shtojca e LD-HP-së, neni 55); Rregullat e Përgjithshme të Tenderit të AKP-së, neni 10.4, 11, 17, 17.2(c), 17.1

1. Pozita e ofertuesit më të lartë si edhe pozita e fituesit të përkohshëm përkon me interesin e arsyeshëm dhe të paanshëm për të garantuar mbrojtjen.
2. AKP-ja nuk ka të drejtë që të anulojë tenderin bazuar në zgjedhjen që iu është dhënë Bordit të Drejtorëve të AKP-së, përmes dispozitave të nenit 17 të Rregullave të Tenderit për të shtyrë apo anuluar tenderin në çfarëdo kohe ose për çfarëdo arsye. Kjo zgjedhje nuk është pa kufizime.
3. Vendimi i AKP-së për të shtyrë ose anuluar tenderin duhet të jetë eksplicit, të jetë i arsyetuar dhe t'i dorëzohet ofertuesit përkatës. Përndryshe kjo mund të shkaktojë që një vendim i tillë të konsiderohet i pavlefshëm.

Aktvendimi i datës 10 shtator 2015 – AC-I-14-0257 (Shkalla e Parë: Aktvendimi i datës 19 gusht 2014 – C-IV-14-5624)

- 1 **Rrethanat procedurale dhe faktike:** Më 30 korrik 2014, paditësi parashtrroi padi në DHPGJS ku kërkoi anulimin e vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) Nr. ... të datës ... me të cilin ishte anuluar tenderi Nr. .../... Paditësi morri pjesë në tenderin publik të shpallur nga Agjencia dhe ishte shpallur si ofertuesi më i lartë më 24

mars 2014. Megjithatë, më ..., AKP-ja e njoftoi paditësin se në bazë të neneve 17.1 dhe 17.2(c) të Rregullave të Tenderit, Bordi i AKP-së në takimin e mbajtur më ... e anuloi tenderin për pronën e kontestuar. Paditësi ishte shpallur nga AKP-ja si ofertuesi më i lartë për të njëjtin aset (vala ... e privatizimit dhe shtija përmes likuidimit nr. ...) edhe më parë dhe Bordi i AKP-së e anuloi tenderin pa ndonjë arsytim për herë të dytë.

2
Bashkë me padinë paditësi parashtrori kërkesë për masë të përkohshme me të cilën ai kërkon që t'i ndalohej AKP-së shitja apo tjetërsimi i lokalit objekt i padisë deri në vendosjen përfundimtare të padisë kryesore. Paditësi argumentoi se nëse nuk do të lëshohet masa e përkohshme ekziston rreziku i menjëhershëm i humbjes së riparueshme për të pasi që AKP-ja mund t'a ri-tenderojë pronën e kontestuar.

3
Më 19 gusht 2014, Kolegji i Specializuar e miratoi masën e përkohshme të kërkuar. Kolegji konsideroi të jenë përmbushur kërkesat e nenit 55.1 të Shtojcës së LDHP për lëshimin e masës së përkohshme. Kolegji i Specializuar konstatoi se AKP-ja e kishte identifikuar paditësin si fitues të përkohshëm të tenderit në dy shitjet e njëpasnjëshme për të njëjtën Njësi. Kolegji vërtetoi se në të dyja rastet Bordi i AKP-së e anuloi tenderin jo për arsye se paditësi nuk arriti të plotësojë ndonjërin prej kriterëve të përcaktuara në rregullat e AKP-së për pjesëmarrje në tender, por sepse çmimi i ofruar nga paditësi, sipas AKP-së, nuk kishte lidhje racionale me çmimin e tregut. Kolegji konsideroi se shpallja e një tenderi tjetër për privatizimin e lokalit që është objekt i kontestit dhe konkludoi se finalizimi i shitjes do të shkaktonte dëm të menjëhershëm dhe të riparueshëm për paditësin. E para, paditësi nuk do të bëhej pronar i pronës së kontestuar edhe nëse padia e tij do të miratohej nga gjykata, dhe e dyta, ai nuk do të kompensohej tërësisht sepse nuk do të ishte në pozitën e kreditorit të siguruar të NSH-së në likuidim.

4
Më 28 gusht 2014, AKP-ja parashtrori ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar. Në ankesën e vet AKP-ja pretendon shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të të drejtës materiale. Ajo i propozoi Kolegjit të Apelit që t'a anulojë Aktvendimin e ankimuar ose t'a ndryshojë atë duke e refuzuar kërkesën si të papabazuar.

- 5 AKP-ja pohoi se Kolegji i Specializuar e vërtetoi në mënyrë të gabuar gjendjen faktike kur konstatoi se paditësi ishte shpallur dy herë si fitues i përkohshëm. AKP-ja kritikon që Kolegji i Specializuar nuk ka bërë dallimin në mes të termeve “ofertuesi më i lartë” dhe “fitues i përkohshëm” dhe shpjegon se identifikimi i “ofertuesit më të lartë” ka të bëjë vetëm me ofertën më të lartë të ofertuar, ndërsa “fitues i përkohshëm” i referohet njoftimit për vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së mbi shpalljen e fituesit të përkohshëm. Për më tepër, AKP-ja pohon se në lëndën në fjalë nuk janë përmbushur kushtet e parapara në nenin 55.1 të Shtojcës së LDHP. Konstatimet e Kolegjit të Specializuar që paditësi do të pësojë dëm të riparueshëm nëse nuk miratohet ndalesa janë të pasakta. Dëmi konsiderohet të jetë “i riparueshëm” vetëm nëse nuk mund të kompensohet në mënyrë të arsyeshme me mjete financiare.
- 6 Më 10 korrik 2012, paditësi dorëzoi përgjigje në ankesë. Ai është i mendimit se po të lejohet Agjencia që të lëshojë vendime të tilla për anulime të tenderëve pa dhënë arsye dhe të pajtohet që të ri-tenderojë lokalet që janë objekt i kësaj lënde do ta dëmtonte atë, drejtësinë dhe në veçanti praktikën gjyqësore.
- 7 **Arsyetimi ligjor:** Ankesa është e pranueshme por e pabazuar.
- 8 Kolegji i Apelit vendosi që të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 64. 1 të Shtojcës së LDHP.
- 9 Kolegji i Apelit konsideron se Kolegji i Specializuar ka arsyetuar saktë kur ka miratuar masën e përkohshme. Kërkesat e nenit 55.1 të Shtojcës së LDHP janë përmbushur prandaj e refuzon ankesën si të pabazuar.
- 10 Kriteret se kur duhet të lëshohet masa e përkohshme janë të parapara në nenin 55.1 të Shtojcës së LDHP:
pala duhet të japë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e përkohshme. Këto kritere janë të përcaktuara në atë mënyrë që nëse ndonjëra prej të mësipërmeve mungon kërkesa do të refuzohet.

Edhe pse AKP-ja ka të drejtë kur thekson se paditësi asnjëherë nuk është shpallur si ofertuesi fitues i përkohshëm i tenderit për shitjen e asetit në fjalë, paditësi megjithatë është shpallur dy herë ofertuesi më i lartë. Kolegji i Apelit konstaton se jo vetëm pozicioni i fituesit të përkohshëm por edhe pozicioni i ofertuesit më të lartë nënkupton sigurimin e mbrojtjes të arsyetuar dhe të drejtë të interesave.

11

Sipas nenit 10.4 të Rregullave të Tenderit të AKP-së, Agjencia do të bëjë shitjen e objektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë. Nga atëherë e tutje mbetet vetëm në sferën e ofertuesit më të lartë që të përmblushë kërkesat për t'u shpallur si fitues i përkohshëm. AKP-ja duhet të shpallë ofertuesin më të lartë si fitues të përkohshëm nëse ai e kalon verifikimin e historikut sipas nenit 11 të Rregullave të Tenderit. Në lëndën në fjalë nuk ka ndonjë të dhënë se paditësi nuk do të kishte verifikimin e historikut. Kështu AKP-ja ka shpërfillur interesin ligjor relevant të paditësit që hapat e mëtejme të AKP-së në tender do të merren në pajtim me procesin e duhur ligjor dhe do të rezultojë përfundimisht në bartjen e asetit në fjalë në pronësi të paditësit, duke marrë vendimin për të anuluar tenderin, duke i përmendur vetëm nenet 17.1 dhe 17.2(c) të Rregullave të Tenderit. AKP-ja nuk ka të drejtë të anulojë një tender në bazë të zgjedhjes së Bordit të Drejtorëve të AKP-së sipas dispozitave të nenit 17 të Rregullave të Tenderit të shtyjë apo të anulojë një tender në çfarëdo kohe ose për çfarëdo arsye. Kjo liri e veprimit nuk është e pa kufizuar. Neni 17.7 [e saktë: 17.1] i Rregullave të Tenderit nuk lejon anulimin pa arsye dhe zgjedhja e Bordit të drejtorëve mund të ushtrohet vetëm në kuadër të kërkesave të trajtimit të drejtë të ofertuesve përkatës interesat legjitime të të cilëve duhet të merren parasysh nga AKP-ja para se të anulohet një tender.

12

Procedura e drejtë në këtë kuptim kërkon si vijon:

13

Vendimi për shtyrje apo anulim të tenderit duhet të jetë eksplicit, të jetë i arsyetuar dhe t'i dërgohet ofertuesit përkatës. Përndryshe, ai mund të shpie që një vendim i tillë të konsiderohet si i pavlefshëm.

Duhet të jetë një arsye e vlefshme që arsyeton anulimin e tenderit, pas së cilës arsye e vlefshme është vetëm ajo që është në pajtim me obligimin e AKP-së që të veprojë brenda synimeve dhe qëllimeve të përcaktuara me Ligjin mbi AKP-në dhe në bazë të mirëbesimit dhe praktikës së arsyeshme.

Nëse AKP-ja vlerëson se procesi i tenderit ka të meta apo oferta respektivisht ofertuesi nuk i plotëson kushtet e domosdoshme, jo që duhet vetëm të cekë se cilat janë të metat por edhe të arsyetojë pse këto të meta janë marrë parasysh si të tilla p.sh. nëse oferta konsiderohet të jetë shumë e ulët, AKP-ja duhet të nxjerrë çmimin minimal për pronën në fjalë dhe se si është kalkuluar ky çmim.

- 14 Deri më tani AKP-ja nuk ka dhënë ndonjë arsye të vlefshme për të anuluar tenderin që do ta arsyetonte vendimin e Bordit. Humbja është veçanërisht çdo shpjegim se përse çmimi i ofertës nuk ka lidhje racionale me vlerën e perceptuar të artikullit të tenderuar.
- 15 Duhet të vihet në pah se qëndrimi i AKP-së siç paraqitet në këtë lëndë nuk është në pajtim me synimet dhe qëllimet e përcaktuara me Ligjin për AKP-në 2011 dhe në bazë të mirëbesimit dhe praktikës së arsyeshme dhe mund të ketë ndikim negativ tek investitorët e mundshëm.
- 16 Kolegji i Apelit gjithashtu pajtohet me konstatimin e Kolegjit të Specializuar që dëmi është i menjëhershëm sepse pa masën e përkohshme të kërkuar AKP-ja do të jetë në gjendje të rishpallë asetin në fjalë [për tenderim] në çfarëdo kohe.
- 17 Dëmi i parashikuar do të ishte i pariparueshëm. Pritja ligjore e vlefshme e paditësit që AKP-ja do të bashkëpunojë tërësisht lidhur me hapat e nevojshëm për të përfunduar shitjen dhe për të bartë asetin e tenderuar në pronësi të paditësit nuk do të zhdëmtohej në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar për shkak të natyrës së tij dhe llogaritjes së vështirë.
- 18 Për arsyet e mësipërme dhe në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së u vendos si në dispozitiv.
- 19 Ky Aktvendim nuk krijon asnjë pengesë në shqyrtimin përfundimtarë në meritat e padisë.

⚖️

Forma e kontratës mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme

Kontrata mbi shitjen dhe transferimin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme; Forma me shkrim; Nënshkrimet; Vërtetimi nga Gjykata; Oferta; Oferta e shkruar me dorë; Dëshmi; Dëshmitarë; Shkëmbim i tokës; Pasuri e paluajtshme; Ligji i aplikueshëm

Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore neni 31.1, 32.1 dhe 2, 73; Ligji për Qarkullimin e Patundshmërive neni 4, 4.4; LPK neni 181, 181.1(b), 182, 183; Ligji për Qarkullimin e Tokës dhe Ndërtesave neni 9, 9.12, 12, 47; Ligji për Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore neni 53-67

1. **Kontrata mbi shitjen dhe transferimin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme duhet të lidhet me shkrim dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen nga Gjykata e kompetencës teritoriale.**
2. **Ofertat e shkruara me dorë/propozimet për lidhjen e një kontrate i pranuar nga komisioni i NSH-së për shkëmbimin e tokës nuk përbën kontratë me shkrim nëse nuk është pranuar nga Drejtori i NSH-së në formë të shkruar.**
3. **Kur kontrata me shkrim nuk është lidhur fare atëherë dëshmia e dëshmitarëve rreth shitjes dhe transferimit të pronësisë mbi pronën e paluajtshme është irelevante.**

Aktgjykimi i datës 10 dhjetor 2015 – AC-II.-12-0203 (Shkalla e parë: Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në F. i datës 26 nëntor 2009 – C.no.323/06)

Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike: Më 30 maj 2002 në Gjykatën Komunale, F., paditësit parashtruan një padi për vërtetimin e pronësisë në bazë të posedimit.

- 2 Gjykata Komunale në F. me Aktvendimin C... të datës 30 nëntor 2005 është shpallur inkomptente në pikëpamje lëndore ndërsa paditësit udhëzohen që të drejtat e veta me padi t'i kërkojnë në DHPGJS.
- 3 Me 19 janar 2006 paditësit të cilët mes vete janë bashkëshort, kanë parashtruar një padi tjetër DHPGJS e regjistruar me nr. SCC-06-0028 me të cilën kërkojnë vërtetimin e pronësisë mbi bazën Kontratës mbi ndërrimin e patundshmërive dhe posedimit mbi pronën, ngastrën kadastrale (me tutje NK) nr. ..., sipërfaqja prej ... ha, zona kadastrale P. i J e regjistruar në emër të paditurës. Ndërsa NSH *P B*, F. kërkohej të pranojë pronësinë mbi nk. nr. ...; ... dhe ... dhe nr. ... , sipërfaqja e gjithmbarshme, ... tani e regjistruar në emër të paditësve.
- 4 Paditësit pretendojnë se në vitin 1970, mes tyre dhe të paditurës Kombinati Bujqësor "*P B*" është bërë një shkëmbim i ngastrave. Ky shkëmbim thuhet të jetë bërë me shkrim, por paditësit nuk kanë qenë në gjendje që këtë pronë ta regjistrojnë në zyrën kadastrale përkundër faktit se janë në posedim të papenguar.
- 5 Paditësit kanë ofruar provë: fletën poseduese nr. ..., ... dhe nr. ... nga Gjykata.
- 6 Me 7 prill 2006 DHPGJS me Aktvendim në shkallë të parë, e referon lëndën në Gjykatën Komunale në F.
- 7 Më 9 janar 2008, nëpërmjet një parashtrëse paditësi beri precizimin e padisë në kuptimin subjektiv. Për shkak të vdekjes së paditëses se dytë tani si paditës të vetëm paraqitet trashëgimtari i saj, paditësi i parë.
- 8 Me 26 nëntor 09 Gjykata Komunale në F. me Aktgjykimin C.nr.323/06 aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit *V Z* si të bazuar, dhe është vërtetuar se paditësi është pronar i patundshmërisë nr. ... në v.q 'A e B' me kulturë arë e klasës së pestë në sipërfaqe prej ... ha, dhe arë e klasës së katërt në sipërfaqe prej ... ha, të shënuar në fletën poseduese (me tutje FP) nr. ...-ZK-P. i J., në emër të Kombinatit Bujqësor Industrial *F*., në sipërfaqe prej ... ha, në bazë të ndërrimit. Me Aktgjykim detyrohet e paditura Kombinati Bujqësor - NSH "*P B*" që paditësit t'i lejoj regjistrimin e të njëjtës në librat kadastral në Drejtorinë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi në F., në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

- Gjithashtu vërtetohet se e paditura Kombinati Bujqësor - NSH “*P B*” në F., është pronar i patundshmërisë NK. nr. ... në v.q. ‘U’ arë i klasës së katërt në sipërfaqe ... ha, të shënuar në fp. nr. ... ZK-P i J Nk. nr. ... në vendin e quajtur ‘U te sh’ arë e klasit të pestë në sipërfaqe ... ha, arë e klasit të pestë në sipërfaqe ... ha, NK. nr. ... në vendin e quajtur “U te sh” arë e klasit të katërt në sipërfaqe ... ari të shënuara në FP nr. ... ZK-P në emër të paditësit *VZ*, në bazë të ndërrimit. Me Aktgjykim detyrohet paditësi që të paditurës t’i lejoj regjistrimin e të njëjtës në librat kadastral në Drejtorinë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi në F., në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit. **9**
- Ndërsa refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit për vërtetimin e pronësisë në bazë të ndërrimit për sipërfaqen prej ... ari të NK. nr. ... në vendin e quajtur ‘A. e B.’ e shënuar në FP. nr. ... KK P i J si dhe vërtetimi se ka ekzistuar ndërrimi i kësaj pjese të patundshmërisë me NK nr. ... në v.q ‘F’ në sipërfaqe ... ari të shënuar në FP. nr. ... ZK P i J. **10**
- Me Aktgjykim detyrohet e paditura që paditësit t’i paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej ... euro. **11**
- Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet se e paditura në seancën përgatitore dhe në seancat e shqyrtimit kryesor përmes përfaqësuesit të saj kishte deklaruar se e kontestojnë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për vërtetimin e pronësisë në bazë të ndërrimit, meqë paditësi nuk kishte prezantuar prova materiale. **12**
- Gjykata Komunale për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë administrimin e këtyre provave: shikimin e FP nr ... ZK-P i J, në emër të *VZ*, Fp nr ..., ZK-P i J në emër të *NZ*, FP. nr. ... ZK-P i J në emër të Kombinatit Bujqësor Industrial “*PSb*” për ng.kad..., leximin e kërkesës së paditësit *VZ*, shikimin dhe leximin e ekspertizës së ekspertit gjyqësor-gjeometrik *AH*, shikimin e kopjes së planit, për NK nr. ..., shikimin e CDPP-UL. ... ZK-P i J në emër të *VZ*, për NK nr. ... dhe NK. nr. ..., plotësimin e ekspertizës të ekspertit *AH*, leximin dhe dëgjimin e deklaratave të dëshmitarëve *MM* dhe *SH*, leximin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në F., leximin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në P., si dhe shikimin e kopjes së planit për NK. nr. ... dhe ... **13**

- 14 Bazuar në provat e administruara dhe në vlerësimin e tyre në kup-tim të nenit 8.1 dhe 8.2 të LPK-së, kjo Gjykatë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit pjesërisht është e bazuar ashtu siç është aprovuar në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit.
- 15 Gjykata në tërësi ua kishte falur besimin dëshmive të dëshmitarëve sepse siç thuhet, ato ishin bindëse dhe objektive, dhe kishte vërtetuar se ishte bërë ndërrimi fizik i patundshmërive në mes të paditësit dhe të paditurës, madje për këtë çështje ishte formuar edhe një komision prej 3 anëtarësh.
- 16 Gjithashtu në arsyetim thuhet se bazë e mjaftueshme për aprovimin e kërkesëpadiës dhe njohjen e veprimit juridik ishte edhe kërkesa (ofer-ta) e cila i ishte dorëzuar të paditurës me datën 10 tetor 1973, e cila ishte pranuar, dhe i përmban të gjitha pjesët esenciale të kontratës konform nenit 32. 1 dhe 2 të LMD.
- 17 Paditësi të drejtën e pronësisë e kishte fituar në bazë të ndërrimit dhe mbajtjes, dhe se marrëveshja ishte përmbushur në tërësi, konform nenit 4.4 të Ligjit për Qarkullimin e Patundshmërive të RSS nr. 43/81,28/87 dhe 40/89, i cili ligj është i aplikueshëm në bazë të Rregullores së UN-MIK-ut 1999/24.
- 18 Kundër këtij Aktgjykimi me 20 maj 2010 AKP-ja parashtroj ankesë në DHPGJS e cila evidentohet me nr. SCA-10-0045.
- 19 AKP-ja e kundërshton Aktgjykimin e atakuar për faktin se përmban mangësi që ia pamundësojnë vlerësimin e tij, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare dhe kontadiktave në mes arsyetimit të Aktgjykimi-t dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor, e që në fakt paraqesin shkelje esenciale të dispozitës së nenit 181 dhe 182 të LPK-së.
- 20 Ankuesi pohon se arsyetimi nuk e ka shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe reale gjendjen faktike duke aprovuar kërkesën në bazë të një shkrese jo formale, e cila nuk është dokument zyrtar dhe i besueshëm.
- 21 Më tej ankuesi pohon se sipas LMD kontrata e ndërrimit duhet të jetë në formë të shkruar dhe e vërtetuar pranë gjykatës, ndërsa në arsy-etim shihet se gjykata ia ka falur besimin vetëm kërkesës për ndërrim e cila është një akt për fillimin e kësaj procedure.

- AKP pretendon se ndërrimi i paluejtshmërisë është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi, dhe në mungesë të dokumenteve juridike sepse kërkesa e datës 10 tetor 1973 as për nga përmbajtja e as për nga forma nuk i plotëson kushtet ligjore për t'u pranuar si punë juridike. **22**
- Shkelje tjetër konsideron edhe shkeljen e dispozitave të ligjit material sepse gjykata nuk kishte kërkuar nga paditësi bazën ligjore mbi të cilën e mbështet kërkesëpadinë, dhe gabimisht Aktgjykimin e kishte bazuar në dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Patundshmërisë të vitit 1989 dhe nenit 31.1 të LMD. **23**
- Më tej [AKP-ja] shton se puna e tillë juridike është lidhur në kundërshtim me dispozitat e nenit 9.12, 12 dhe 47 të Ligjit për Qarkullimin e Tokës dhe Ndërtesave, si dhe dispozitave 53-67 të Ligjit për Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore 43/1959. **24**
- Andaj [AKP-ja] kërkon nga Gjykata që ta aprovoj ankesën e saj si të bazuar, ta ndryshoj Aktgjykimin, ose lëndën ta kthej në rigjykim. **25**
- Me 31 maj 2010 përfaqësuesi i paditësit av. *HI* parashtrij përgjigje në ankesë me të cilën i kundërshton pretendimet e të paditurës se Aktgjykimi përmban mangësi, kontradikta dhe shkelje. **26**
- Përkundrazi Aktgjykimi ka arsye të bollshme dhe logjike për të gjitha faktet vendimtare.
- Ai pohon se ankuesi nuk përmend asnjë dispozitë ligjore e cila nuk është zbatuar ose është zbatuar gabimisht e cila ka pasur ndikim në nxjerrjen e Aktgjykimit. Gjykata ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike (neni 183 [i LPK] lidhur me nenin 181[.1 (b) të LPK].
- Gjykata nuk e ka dhënë vlerësimin vetëm në bazë të dokumentit, por edhe ekspertizës, shikimit në vend, dëshmisë së dëshmitarëve.
- Pastaj janë të pa bazuara thëniet se kontrata e ndërrimit duhet të jetë në formë të shkruar, sepse qysh në vitin 1973 kontrata ishte përm-bushur në tërësi konform nenit 73 të LMD.
- Po ashtu nuk qëndrojnë thëniet se kjo kontratë nuk ishte lidhur sipas nenit 9 të Ligjit për Qarkullimin e Tokave dhe Ndërtesave (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 43/65, 57/65 dhe 17/67).
- Përkundrazi në favor të asaj se kjo kontratë është e ligjshme është edhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Jugosllavisë GZ.nr.49/06 lidhur me dispozitat e nenit 9.

- 27 Me 20 nëntor 2012 nëpërmjet urdhrit të brendshëm lënda dërgohet tek Kolegji i Apelit dhe evidentohet me nr. AC-II-12-0203.
- 28 Më 17 tetor 2013, Kolegji i Apelit kërkesën e paditësve për caktimin e masës së përkohshme e ka hedhur poshtë si të pa pranueshme.
- 29 Më 24 gusht 2015 përfaqësuesi i paditësit me një parashtrësë informoi DHPGJS se paditësi i pare ka vdekur ndërsa sipas Aktvendimit mbi trashëgimin nr. ... të parashtruar në Gjykatë trashëgimtar i vetëm i tij është i biri S V Z i cili autorizon me autorizim av. që t`i marrë për-sipër procedurën dhe kërkon që të ndermirën të gjitha veprimet tjera procedurale deri ne përfundimin çështjes juridike.
- 30 **Arsyetimi ligjor:** Ankesa është e bazuar.
- 31 Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Ankesave ka vendosur që të mos vazhdojë me pjesën gojore të procedurës gjyqësore.
- 32 Gjykata e shkallës së parë më Aktgjykimin e ankimuar nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht edhe gabimisht ka aplikuar dispozitat materiale, kur ka aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të bazuar.
- 33 Gjykata gabimisht ka konstatuar se oferta e datës 10 tetor 1973 është një prove e mjaftueshme materiale dhe në pajtim me nenin 32.1 dhe 2 të LMD me të cilin palët kanë bërë ndërrimin e patundshmërive. Oferta është një propozim për lidhjen e Kontratës e cila domosdoshmërisht nuk do të mund të rezultonte me lidhjen e Kontratës
- 34 Sipas nenit 4 të Ligjit mbi Qarkullimin e Paturisë së Paluajtshme në fuqi më 16 korrik 1992, paragrafi 2, kontrata e bartjes së të drejtës lidhur me patundshmëritë në mes të bartësve të së drejtës pronësore, e tjetërsimit të patundshmërisë nga prona shoqërore dhe e shkëmbimit të pronës shoqërore duhet të lidhet me shkrim dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen nga gjykata. Është e përcaktuar në paragrafin 3 të njëjtit nen se kontrata e cila nuk është bërë sipas paragrafit 1 dhe 2 të njëjtit nen nuk do të krijojë ndonjë efekt ligjor.

- Prandaj Kolegji i Apelit konsideron se Gjykata Komunale gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka trajtuar ofertën si punë të vlefshme juridike nëpërmes së cilës mund të behet bartja apo transferimi e patundshmërive. **35**
- Për më tepër edhe kjo Oferte është e shkruar me dorë e pa nënshkruar nga Drejtori apo personi përgjegjës në NSH dhe në të shumtën e faqes së saj është e pa lexueshme dhe si e tillë ajo nuk mund të konsiderohet as si ofertë aq më pak si kontratë e vlefshme. **36**
- Në mungese të një kontrate të vlefshme, Kolegji i Apelit nuk mund t`i konsiderojë si kruciale as deklaratat e dëshmitarëve të cilat do të mund të shërbenin vetëm për plotësimin apo forcimin e një dokumenti, Kontratës por që rasti në fjalë nuk është i tillë. **37**
- Në bazë të këtyre arsyrave, ankesa e ankuesit është e bazuar, Aktgjykimi i ankimuar, pika -I-, -II- dhe -IV- e dispozitivit, anulohet dhe kërkesë-padia e përfshirë në 3 pikat e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar refuzohet si e pa bazuar. **38**
- Meqenëse edhe një pjesë e padisë është e përfshirë në pikën -III- të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar është refuzuar si e pa bazuar nga Gjykata Komunale, F., Kolegji i Apelit tani më konstaton se e tërë padia është refuzuar si e pa bazuar. **39**
- Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv. **40**



24.

Kushtet e marrjes së Aktgjykimit pa seancë dëgjimore

Seancë dëgjimore; Mbledhja e provave

Shtojca e LDHP neni 34, 34.3, 43.1, 46

1. E vetmja mundësi për shkallën e parë që të mbyllë rastin me Aktgjykim pa mbajtur seancë dëgjimore është e paraparë me nenin 34 të Shtojcës së LDHP.
2. Mos lëshimi i urdhrorit dhe mos kompletimi i procedurës siç është e paraparë me nenin 34 të Shtojcës së LDHP, shkalla e parë shkel të drejtën e palëve për t'u dëgjuar para gjykatës që përbën shkelje thelbësore të procedurës së përcaktuar.

Aktvendimi i datës 10 shkurt 2016 – AC-I.-15-0233 (shkalla e parë: Aktgjykimi i datës 2 tetor 2015 – C-IV.-15-1015)

- 1 **Rrethanat faktike dhe procedurale:** Më 9 qershor 2015 paditësit/punëtorët e KAI “A” SH.A –Shërbimet e Përbashkëta Administrative në P., parashtruan padi në DHPGJS, duke kërkuar që të vërtetohet se NSH BVI “M K B” është pjesë përbërëse e KAI “A” SH.A –Shërbimet e përbashkëta administrative në P., dhe të detyrohet e paditura – AKP-ja që paditësve t’ua njohë statusin e aksionarëve të KAI “A” SH.A –Shërbimet e përbashkëta administrative në P.
- 2 Paditësit kanë theksuar se Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit (BVI) për “M K B” ka filluar punën qysh në vitin 1970 në disa zona të Kosovës. Që nga vitin 1978 BVI M K B ka qenë e vendosur në lokalitetin afarist në lagjen “D.” ... , obj. ..., ndërsa nga vitin 1988 e deri më sot është shfrytëzuar nga KAI “A” SH.A, një ndërmarrje e cila me kapitalin e saj e ka themeluar këtë BVI.

Paditësit theksojnë se ata janë aksionarë sipas Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore pasi që ata e kanë në posedim faktik dhe janë shfrytëzues të përhershëm të pronës prej vitit 1988 pa u penguar nga askush. Më tej kanë shtuar se BVI-ja është përkrahur financiarisht nga KAI “A”, me kapitalin fillestar themeltar me një shumë të atëhershme prej ... dinarë apo të konvertuar në DM ... e barabartë me ... euro. 3

Në të njëjtën datë me padinë, paditësit kanë paraqitur edhe kërkesë për urdhër paraprak gjyqësor duke theksuar të njëjtat pretendime sikur në padi. Me këtë kërkesë kanë theksuar se me qëllim të mbrojtjes së drejtës së tyre dhe ruajtjes së gjendjes ekzistuese së paluajtshmërisë së pretenduar i kanë propozuar gjykatës që të caktohet masa e përkohshme, në mënyrë që AKP-ja të mos e tjetërsojë lokalitetin i cili është objekt i këtij kontesti. 4

Më 12 qershor 2015 DHPGJS-ja ka lëshuar një urdhër përmes së cilit ka kërkuar nga paditësit që të sqarojnë dëmin e menjëhershëm dhe të riparueshëm të cilin do ta pësojnë paditësit nëse nuk lëshohet masa e përkohshme sipas nenit 55 të Shtojcës së LDHP; të dorëzojnë autorizimin për përfaqësuesin e tyre juridik dhe të ofrojnë dëshmi në mbështetje të padisë. Të njëjtën ditë padia e paditësit dhe kërkesa për masë të përkohshme iu janë dërguar të paditurës. 5

Më 29 qershor 2015 përfaqësuesi i paditësve iu është përgjigjur urdhrin të DHPGJS-së të datës 12 qershor 2015, duke dhënë sqarime shtesë lidhur me kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor. Përfaqësuesi i paditësve ka shtuar se me faktin e hyrjes së NSH-së në likuidim mund të rrezikohet kërkesa e paditësve për realizimin e të drejtave të tyre lidhur me objektin kontestit, pasi që AKP-ja mund ta rrënojë, ndërrojë destinimin, të prishë [e saktë: pjesë të ndryshme] pajisjet e ndryshme etj. Ka propozuar aprovimin e masës së përkohshme. 6

Më 30 qershor 2015, AKP-ja ka paraqitur përgjigjen e saj lidhur me urdhrin e DHPGJS-së. AKP-ja e kontestoi kërkesën për caktimin e urdhrin paraprak gjyqësor (masës së përkohshme), duke kërkuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar mbi bazën se paditësit nuk kanë prezantuar asnjë provë në lidhje me të drejtën e [tyre të] pronësisë së pretenduar dhe se nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 55.1, të Shtojcës së LDHP. AKP-ja ka theksuar se paditësit kanë dështuar t'i ofrojnë DHPGJS-së dëshmi të besueshme. 7

- 8 Më 8 shtator 2015 e paditura paraqiti përgjigje duke i kundërshtuar pretendimet e paditësve, me arsyetim se ankesit/paditësit propozimin për aprovimin e ankesës nuk e kishin mbështetur me prova të besueshme dhe relevante. E paditura me tej ka shtuar se AKP-ja është i vetmi institucion që është kompetent sipas ligjit për ta përcaktuar statusin juridik e të gjitha NSH, përfshirë edhe rastin e kësaj NSH-je. AKP-ja më tej ka shtuar se NSH-ja është themeluar si subjekt juridik e cila ka kryer punët me interes shoqëror dhe ka pasur kapital shoqëror, dhe i ka propozuar DHPGJS-së që të refuzojë propozimin e paditësve si të pabazuar në ligj.
- 9 Më 11 shtator 2015 deklarata e AKP-së iu është transferuar paditësve.
- 10 Më 25 shtator 2015, paditësit dorëzuan përgjigje ndaj parashtrësës së të paditurës të datës 8 shtator 2015 duke theksuar se argumentet e të paditurës janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme dhe se ato nuk duhet të merren parasysh. Paditësit edhe me tutje përsërisin pretendimet e tyre siç i kanë paraqitur në padinë e datës 9 qershor 2015, dhe i kanë propozuar DHPGJS-së që të aprovojë ankesën e tyre si të bazuar.
- 11 Më 2 tetor 2015 Kolegji i Specializuar lëshoi Aktgjykimin C-IV.-15-1015 dhe refuzoi padinë e paditësve dhe kërkesën për masë të përkohshme si të pabazuar. Sipas DHPGJS-së pretendimet e paditësve se prej vitit 1988 e tutje kanë pasur në posedim dhe shfrytëzim lokalet afariste, nuk janë të mjaftueshme sepse përmes këtyre pretendimeve nuk dëshmohet pronësia e paditësve. Shfrytëzimi i lokaleve afariste nga ana e paditësit nuk mund të qojë në fitim të [të drejtës së] pronësisë pa kurrfarë marrëdhënie kontraktuale të lidhura në mes paditësve dhe NSH-së për blerje të lokaleve afariste bazuar në ligj. Paditësit gjithashtu nuk kanë dëshmuar këto fakte me kurrfarë provash.
- 12 Më 28 tetor 2015 paditësit kanë parashtruar ankesë duke pretenduar se Kolegji i Specializuar ka vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë rrethanat faktike, ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe ka shkelur dispozitat e LDHP. Paditësit gjithashtu kanë theksuar se DHPGJS-ja kurrë nuk ka kërkuar nga e paditura që të dëshmojë se është pronare e lokaleve afariste në fjalë, dhe se ka dështuar që të vlerësojë dëshmitë lidhur me pretendimet e së drejtës së paditësve mbi shfrytëzimin e përhershëm të lokaleve të kontestuara. Përfundimisht Kolegji i Specializuar ka shkelur nenin 43.1 dhe nenin 46 të Shtojcës së

LDHP, sepse ka nxjerrë Aktgjykim pa mbajtje të seancës dëgjimore dhe pa njoftim paraprak mbi procedurën me shkrim.

Më 23 nëntor 2015 AKP-ja ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës dhe ka kërkuar nga DHPGJS-ja që të refuzojë ankesën e paditësve si të pabazuar për shkak të faktit se ata nuk i kanë dëshmuar pretendimet e tyre. 13

Arsyetimi ligjor: Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës, në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP. 14

Ankesa është e bazuar. Shkalla e parë ka nxjerrë Aktgjykim në mungesë të sqarimit sa i përket përmbajtjes së kërkesës dhe bazat, si dhe në mungesë të qartësisimit të legjitimitetit aktiv dhe pasiv. Gjykata do të duhej të konstatonte se nëse kërkesa ka të bëjë me përcaktimin e statusit e që për rastin në fjalë ‘punëtorët’ e ndërmarrjes nuk kanë legjitimitet aktiv, sepse cilado kompani mund të përfaqësohet vetëm nga menaxhmenti përkatës. Veç kësaj, kërkesa [pacia] për të verifikuar statusin e aksionarit është e papranueshme kundër AKP-së, sepse AKP-ja nuk ka kompetenca mbi ndërmarrjet private. 15

Vet kërkesa është shumë e paqartë – për të njohur statusin e aksionarëve punonjësve të KAI “A” SH.A – Shërbimet e Përbashkëta Administrative në P., sepse ata janë posedues bona fide aktual dhe kanë të drejtë të zbatojnë nenin 18.1.1.4 e Ligjit për AKP-në2011. Neni 18 i këtij ligji nuk ka të bëjë fare me çfarëdo të drejtash të punëtorëve apo aksionarëve. Shkalla e parë duhet të qartësojë esencën e kërkesës dhe kështu-pranueshmërinë e padisë. 16

Duhet të theksohet gjithashtu se Shkalla e Parë gabimisht e ka mbyllur rastin me Aktgjykim mbi meritat pa mbajtur seancë dëgjimore. As me Aktvendim e as përmes shkresave të lëndës nuk është dhënë shpjegim pse dhe mbi çfarë baza ligjore Kolegji i Specializuar ka vendosur të mos mbajë fare seancë dëgjimore. E vetmja mundësi për shkallën e parë që të mbyllë rastin me Aktgjykim pa mbajtur seancë dëgjimore është e paraparë me nenin 34 të Shtojcës së LDHP. Nëse pas dorëzimit të raportit nga ana e gjyqtarit raportues, kolegji konstaton se nuk ekziston një kontest i vërtetë për prova të rëndësishme materiale, kolegji mund të lëshojë urdhër sipas nenit 34.3 [të Shtojcës së LDHP] për 17

të mos mbajtur seancë dëgjimore dhe për mbledhje të dëshmimeve. Megjithatë, para lëshimit të një urdhri të tillë, kolegji duhet të njoftojë palët se urdhri i një lloji të tillë është në shqyrtim e sipër dhe duhet të ftojë palët që të sjellin parashtrësia të reja brenda afatit të paraparë kohor. Vetëm nëse palët dështojnë që të paraqesin parashtrësit ose kur dorëzojnë parashtrësia irelevante, atëherë kolegji në shkallë të parë mund të lëshojë urdhër për të mos mbajtur seancë dëgjimore. Duke mos e lëshuar urdhrin dhe duke mos e kompletuar procedurën siç është e paraparë me nenin 34 të Shtojcës së LDHP, Shkalla e Parë ka shkelur të drejtën e palëve për t'u dëgjuar para gjykatës që përbën shkelje thelbësore të procedurës së përcaktuar.

18 Përmes nxjerrjes së Aktgjykimit për një padi të paqartë dhe të pa-përcaktuar dhe duke shkelur të drejtën e palëve për seancë dëgjimore, gjykata ka shkelur që të përfillë detyrat [e saja] ex officio për të vërtetuar pranueshmërinë e të gjitha padive dhe të sigurojë se palët i kanë shfrytëzuar të drejtat e tyre procedurale.

19 Prandaj Aktgjykimi duhet të hedhet poshtë [e saktë: prishet], padia dhe kërkesa për masë të përkohshme duhet të kthehen në rigjykim.

⌚⌚⌚

25.

Pronësia fitohet vetëm me një titull të vlefshëm pronësorë

Padi pronësore; Posedim; Shënimet kadastrale; Toka e Konfiskuar; Tenderimi; Proceura e Likuidimit; Privatizimi

Ligji mbi Reformat Agrare neni 29; Ligji mbi Konfiskimin e Pasurisë neni 10; LMTHPJ neni 28.4

Pa Aktvendim të formës së prerë të lëshuar nga autoriteti publik kompetent që anulon aktin e konfiskimit, paditësi nuk mundet me sukses ta kërkojë pronësinë mbi pronën e konfiskuar.

*Aktgjykimi i datës 10 shkurt 2016 – AC-I.15-0249 (Shkalla e Parë:
Aktgjykimi i datës 26 tetor 2015 – SCL-11-0012)*

Rrethanat procedurale dhe faktike: Më 23 prill të vitit 1946 pasi që *K B* ishte ekzekutuar si një Armik i Popullit, Këshilli Popullor i Komunës së I. kishte vendosur në pajtim me nenin 29 të Ligjit mbi Reformat Agrare që të konfiskonte ... ha të tokës, e cila i kishte takuar *K B*, me lokacion në vendin e quajtur “Q.” dhe kjo tokë iu ishte ndarë Këshillit Krahinor të Sindikatës si fushë sportive. **1**

Më 21 dhjetor 1955 toka e konfiskuar iu ishte dhënë Kooperativës Bujqësore *D* në I. për shfrytëzim të përkohshëm. Këshilli Popullor i Komunës së I. gjatë asaj kohe nuk ka lëshuar ndonjë vendim të përherëshëm në lidhje me atë tokë. **2**

Padia e parë
Më 7 tetor 1967, i ati i ankuesit, *B B*, kishte parashtruar një kërkesë për njohjen/konfirmimin e të drejtave të tij pronësore (nr. ...), Komisionit për shqyrtim të pronës shoqërore të Kuvendit Komunal në I., pa specifikuar numrin kadastral të parcelës, por nuk ka dëshmi si ka përfunduar procedura lidhur me kërkesën. **3**

- 4 Më 29 prill 1981 pas marrëveshjes së arritur të Këshillit të Punëtorëve të KB D më 27 prill 1981, Kuvendi Komunal i I. kishte vendosur që Organizata Punuese “S”, d.m.th. pasardhësja e NSH-së të ketë të drejtë e përdorimit të tokës së caktuar, përfshirë edhe ngastrat kadastrale ... dhe ..., me fletë poseduese ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha dhe ngastrat kadastrale nr. ... dhe ... me fletë poseduese nr. ... (në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha). Megjithatë, vendimi nuk përmend askund se një tokë e tillë është konfiskuar dhe se fillimisht i ka takuar *KB B*.
- 5 Më 1 qershor 1981 Drejtoria për Ekonomi dhe Financa të Kuvendit Komunal të I. lëshoi një Vendim me nr. ... në mënyrë që t’i caktohet Organizatës Punuese “S”, e drejta e shfrytëzimit (pa kompensim) [mbi] ngastrat kadastrale ... dhe ..., me fletë poseduese ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha dhe ngastrat kadastrale nr. ... dhe ... me fletë poseduese nr. ... (në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha). Ky Vendim për ndarjen e parcelave në mënyrë shprehimore përshkruan tokën në fjalë si “të konfiskuar” dhe vë në pah se toka fillimisht ka qenë nën posedim të KB “D”.
- Padia e dytë
- 6 Më 23 dhjetor 2004 Padiësi/ankuesi parashtroi një padi pranë DHPGJS, duke kërkuar kthimin nga NSH-ja të ngastrave kadastrale nr. ..., ..., ... dhe ... me fletë poseduese nr. ... të Kuvendit Komunal të I, në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha.
- 7 Më 20 janar 2006, DHPGJS e referoi lëndën në Gjykatën Komunale të I. Në pajtim me vendimin e Gjykatës Komunale të I. C.nr. ... të datës 29 tetor 2006, procedurat gjyqësore ishin pezulluar për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit kundër të paditurës NSH.
- 8 Sipas ankesës së padiësit të dorëzuar në Gjykatën Komunale në I. me datë 12 nëntor 2007, DHPGJS-ja me Aktvendimin e saj SCA-07-0067 të datës 13 dhjetor 2007, e kishte refuzuar ankesën si të pabazuar dhe kishte vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Komunale.
- 9 Më 27 prill 2007 NSH-ja ishte privatizuar nëpërmjet një tenderi të hapur publik dhe shitjes pasuese të Ndërmarrjes së re “S” SHPK (“Ndër e Re”), ndërsa NSH-ja ishte vendosur në likuidim më 18 shtator 2007.

Padia e tretë pranë Komisionit të Likuidimit

Më 2 korrik 2010 ankuesi parashtrroi një padi pronësore pranë Komisionit të Likuidimit të NSH-së, duke kërkuar kthimin dhe kompensimin e tokës në sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha, me lokacion në vendin e quajtur “Q”, në Komunën e I. (“toka e pretenduar”). Ankuesi e identifikon tokën e pretenduar si në vijim: ngastrat kadastrale nr. ..., ..., ... dhe ... me fletë poseduese nr. ... (recitus, ...) në Kuvendin Komunal I. Ky Komision vëren se për shkak të mungesës së identifikimit kadastral të Tokës së Konfiskuar në Vendimin për konfiskim dhe dokumentacionin përcjellës, nuk ka asnjë dëshmi para këtij Komisioni se toka e pretenduar korrespondon me Tokën e Konfiskuar.

10

Vendimi i Komisionit të Likuidimit

Më 9 nëntor 2010, Komisioni i Likuidimit refuzoi në tërësi padinë si të pabazuar për arsyet në vijim:

11

- 1) Neni 20.2 i LMTHPJ përcakton se “e drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”. Në pajtim me nenin 10 të Ligjit mbi Konfiskimin e Pronës, i datës 12 qershor 1945 (“toka e konfiskuar”) [e saktë (Ligji mbi Konfiskimin)]; “shteti kërkon të drejtën mbi pronën e konfiskuar në pajtim me vendimin e formës së prerë me anë të së cilit shpallet konfiskimi i pronës së konfiskuar”. Pasi që toka e pretenduar është konfiskuar në pajtim me Ligjin mbi Konfiskimin, Komisioni i Likuidimit konsideron se NSH-ja është pronare legjitime e tokës së pretenduar,
- 2) Vendimi mbi konfiskimin ishte adoptuar në pajtim me Ligjin mbi Konfiskimin dhe nuk ka asnjë dispozitë ligjore që lejon Komisionin e Likuidimit të shqyrtojë këtë vendim. Komisioni i Likuidimit prandaj duhet që të njeh dhe të pranojë rezultatin që rrjedh nga procedura e konfiskimit, ashtu siç është bërë nga ana e Komunës së I.
- 3) Nuk ka asnjë dëshmi pranë Komisionit të Likuidimit që provon se ankuesi (apo trashëgimtarët e tjerë me titull të pronarëve të mëparshëm të tokës së pretenduar) ka ndërmarrë ndonjë akt juridik pranë Këshillit Popullor Komunal apo ndonjë gjykatë kompetente në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit mbi Konfiskimin për qëllim të kthimit të tokës së pretenduar.

- 4) Në pajtim me nenin 28.4 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore, mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh. NSH-ja është pronare legjitime e ngastrës së pretenduar.

Kërkesa për rishikim të vendimit të Komisionit të Likuidimit

- 12 Më 18 janar 2011 ankuesi parashtrroi një kërkesë me shkrim pranë këtij Komisioni, duke kërkuar që Vendimi i Komisionit të Likuidimit të rishqyrtohej. U kërkuar nga Komisioni që në merita ta aprovojë padinë pronësore të ankuesit në lidhje me tokën e pretenduar, dhe në veçanti të kthejë tokën në fjalë apo të kompensojë ankuesin me kompensim monetar.

Vendimi i Komisionit të Likuidimit lidhur me Kërkesën për rishikim

- 13 Me Vendimin e datës 28 mars 2011, ..., Komisioni i Likuidimit për Shqyrtim të Ankesave ka refuzuar kërkesën për rishikim dhe ka arritur në përfundimin si më poshtë:

- 1) Numrat e fletëve poseduese nën të cilat janë regjistruar parcelat ..., ..., ... dhe ..., të regjistruara në kadastër, kanë ndryshuar (disa herë dhe në disa raste) përgjatë rrjedhës së kohës. Në veçanti, ngastrat kadastrale nr. ... dhe ... (më parë të referuara në fletën poseduese nr. ... apo fletën poseduese nr. ...) aktualisht janë të regjistruara në fletën poseduese nr. ... (Zona Kadastrale nr. ...), ndërsa ngastrat kadastrale nr. ... dhe ... (fillimisht e referuar në fletën poseduese nr. ...) tani shfaqen në fletë poseduese të ndara, respektivisht d.m.th. fleta poseduese nr.
- 2) Parcelat ... dhe ... vazhdojnë të jenë të regjistruara si toka në pronësi shoqërore në emër të NSH-së, të evidentuara në fletët poseduese në vijim, të lëshuara nga Departamenti i Gjeodezisë dhe Pronës i Komunës së I.: 1) fleta poseduese nr. ... (Zona Kadastrale nr. ...) datë 23 maj 2003 (nr. ref. ...) (e disponueshme në Bazën e të Dhënave të AKP-së dhe një kopje e saj është përfshirë edhe në dokumentacionin e shitjes të Ndërmarrjes së Re), Fleta poseduese nr. ... datë 15 Shtator 2004.

Ankesa kundër vendimit të Komisionit të Likuidimit

Më 5 maj 2011 ankuesi, në cilësinë e trashëgimtarit të gjyshit të tij *K K B*, parashtrroi në DHPGJS një Kundërshtim/Ankesë kundër Vendimit të Komisionit të Likuidimit të AKP-së, nr. i referencës ... të datës 28 mars 2011, duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së pronësisë apo kompensim për pronën e patundshme – tokën e konfiskuar. **14**

Paditësi kërkoj njohjen edhe të ngastrës kadastrale ... (e cila u transformuar dhe tani është parcela me nr. ... dhe ...) në sipërfaqe prej ... ha duke deklaruar se kjo ngastrë kadastrale duke u konsideruar si “rrugë” i është kthyer gjyshes së tij dhe si e tillë akoma është nën pronësinë e tij, por e posedon e paditura. **15**

Paditësi deklaron në ankesën e tij se e tërë sipërfaqja e ngastrave kadastrale në këtë kontest përbëjnë një sipërfaqe të përgjithshme prej ... ha, sipërfaqe që përputhet me Përfundimin e Vendimit të Kuvendit Komunal të I. të lëshuar në vitin 1981. **16**

Paditësi i ka paraqitur para Gjykatës faktet në vijim: **17**

- 1) Paditësi deklaron se padia-ankesa e parë ishte parashtruar pranë DHPGJS më 23 dhjetor 2004. Më 20 janar 2006 lënda u referua në Gjykatën Komunale të I. në kompetencë të më tutjeme. Më 29 tetor 2007, Gjykata Komunale e I. pezulloi procedurat gjyqësore për shkak se në ndërkohë kishte filluar procesi i likuidimit për NSH-në. Kundër këtij vendimi më 12 nëntor 2007 paditësi kishte parashtruar një ankesë pranë DHPGJS. Ankesa ishte refuzuar nga DHPGJS më 13 dhjetor 2007. Në bazë të masave ligjore, paditësi më 19 dhjetor 2009 parashtrroi një ankesë pranë Komisionit të Likuidimit të AKP-së, në Zyrën Regjionale të P. Komisioni i Likuidimit i AKP-së – Zyra Regjionale e Pejës lëshoi një vendim më 11 nëntor 2010 duke e refuzuar ankesën. Në ndërkohë, më 27 prill 2007, NSH “S” është privatizuar nëpërmjet tenderit publik dhe për më tepër më 18 shtator 2007, NSH-ja është futur në likuidim.
- 2) Paditësi deklaroi në ankesë se padia/kërkesa për njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrat kadastrale kontestuese është ngritur para 2 deri 4 viteve para privatizimit të NSH-së, dhe se në bazë të parimeve dhe praktikës gjyqësore, si dhe ligjeve pozitive

kombëtare dhe ndërkombëtare, AKP-ja dhe DHPGJS nuk është dashur që të jenë në gjendje të veprojnë apo të lejojnë privatizimin e këtyre asetëve.

Seanca dëgjimore

18 Më 30 qershor 2015 përfaqësuesi i paditësit në seancën dëgjimore, specifikoi padinë e tij. Padia e paditësit tani ndërlihet me: “ parcela Nr. ... dhe ... në sipërfaqe prej ... m2, të cilat ishin shitur gjatë procedurës së likuidimit”.

19 Sa i përket ngastrës kadastrale nr. ... përfaqësuesi i paditësit në seancën dëgjimore ka deklaruar se ajo nuk ndërlihet me padinë e këtij paditësi. Sipas avokatit të paditësit, baza ligjore e padisë nuk është konstatuese, por çështja e gjetjes së mënyrës plotësimit të kërkesës së paditësit – ose me anë të kthimit së pronës ose me anë të kompensimit. Sipas ankuesit ekziston edhe një situatë ligjore në lidhje me shitjen e kryer në lidhje me parcelën ... dhe ..., që situata ligjore është e sigurt jo i panjohur për të paditurin. Sipas ankuesit ka dy opsione për të plotësuar kërkesën e paditësit: ose për të siguruar një kthim adekuat të pronës me të njëjtën cilësi, ose të caktohet kompensim në përputhje me çmimin aktual të tregut.

Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar

20 Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktgjykimin SCL-11-0012, të datës 26 tetor 2015 vendos që:

1) E paditura-AKP obligohet që të transferojë tek paditësi të drejtën e posedimit mbi parcelat ... dhe ... të cilat janë në emër të paditësit me të drejtën pronësore, të vërtetuar nga Agjencia kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale Komunale në I,

2) Ankesa kundër Vendimit të Komisionit të Likuidimit për shqyrtim të ankesave nr. ... i datës 28 mars 2011, i cili tejkalon fushën e gjykimit të pikës I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, refuzohet.

21 Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se lidhur me pjesën e parë të padisë që ndërlihet me njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrat kadastrale ... dhe ..., Gjykata është e mendimit se pa një Aktgjykim të formës së prerë të lëshuar nga organi kompetent për anulimin e Aktit

të konfiskimit të kryer në vitin 1946, vendimi mbi konfiskimin është formalisht akoma në fuqi andaj është detyrues. Kolegji i Specializuar gjithashtu ka arsyetuar se nuk ka asnjë dëshmi që qon drejtë konkluzionit që vendimet dhe aktet historike mbi transferimin e asaj prone janë kundërshtuar ndonjëherë në mënyrë të suksesshme nga ndonjë prej trashëgimtarëve të *K B*, përfshirë këtu edhe paditësin.

Sa i përket pjesës së dytë të padisë e cila ndërlidhet me njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën kadastrale ... e cila ngastër më vonë është ndarë në dy pjesë, ... dhe ..., Gjykata është e mendimit se paditësit i takon e drejta që të ketë mbrojtjen e Gjykatës në lidhje me padinë e tij. [N]ë lidhje me këto dy ngastra e drejta pronësore nuk është kontestuese, pasi që ajo është e regjistruar në emër të paditësit. Andaj Gjykata ka obliguar të paditurën AKP-në që t'ia transferojë paditësit të drejtën e posedimit të parcelave ... dhe ... të cilat janë në emër të paditësit gjë që është vërtetuar nga Agjencia kadastrale e Kosovës, Zyra Komunale Kadastrale në I. Prandaj AKP duhet ta lirojë pronën dhe t'ia jap në posedim paditësit i cili është i vetmi pronar ligjor i saj.

22

Ankesa e të paditurës

Me datë 16 nëntor 2015, e paditura ka parashtuar ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCL-11-0012 të datës 12 tetor 2015 për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe ka kërkuar që Aktgjykimi të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim ose kërkesë padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar. Për më tepër në ankesë e paditura konsideron se është i gabuar konstatimi i Gjykatës së Shkallës së I-rë në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit për faktin se Kolegji i Specializuar e obligon AKP-në që të transferojë tek paditësi të drejtën e posedimit i cili është në kundërshtim me nenin 5.1 të Ligjit për AKP-në 2011. E paditura pohon se Agjencia nuk është pronare por vetëm administruese e pronës shoqërore. E paditura në ankesë pohon se Gjykata e Shkallës së I-rë nuk e konstaton fare se paditësi është në posedim të ngastrave kurse me pikën e I të dispozitivit e obligon AKP-në e cila është administruese e jo pronare e ngastrave që paditëses t'ia transferojë të drejtën në posedim të pronave. Aktgjykimi sipas të paditurës nuk përmban fare arsyetim lidhur me posedimin. Gjykata e shkallës së I-rë nuk e ka vërtetuar faktin se paditësi a i pose-

23

don pronat kontestuese, dhe sa kohë i posedon pronat. Gjithashtu në ankesë e paditura pohon se Gjykata e Shkallës së I-rë nuk e ka vërtetuar faktin se mbi çfarë baze juridike paditësi është bërë pronar i pronave. Gjithashtu në këtë lëndë nuk është vërtetuar legjitimiteti pasiv i të paditurës. Rrjedhimisht sipas të paditurës është [janë] aplikuar gabimisht dhe në mënyrë arbitrare dispozitat materiale.

Ankesa e paditësit

24

Me datë 20 nëntor 2015, paditësi parashtron një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar SCL-11-0012 të datës 26 tetor 2015 dhe atë vetëm ndaj pikës II të dispozitivit të Aktgjykimit për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe kërkon që të priset Aktgjykimi i ankimuar në pikën II të dispozitivit dhe të aprovohet kërkesë padia për ngastrat kadastrale ... dhe ... dhe të obligohet e paditura t'ia kthej në posedim faktik ngastrat e poseduara, apo t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar sipas vlerës reale dhe çmimit të tregut në rast se nuk mund të kthehen këto dy ngastra. Për më tepër në ankesë paditësi konsideron se refuzimi i kërkesë padisë lidhur me ngastrat ... dhe ... është e [i] gabuar pasi që nuk është vërtetuar saktë gjendja faktike dhe gabimisht është aplikuar e drejta materiale. Sipas paditësit pranimi i faktit të konfiskimit të pronave dhe vlerësimi objektiv i provave ka qenë bazë e mjaftueshme për të konstatuar se e paditura pa bazë juridike i mbanë ngastrat kadastrale ... dhe ... të cilat janë kërkuar ti kthehen paditësit. Sipas paditësit fakti se një pjesë e pronave të konfiskuara është kthyer kjo paraqet argument shumë të rëndësishëm për kthimin edhe të dy ngastrave të cekura të cilat e paditura i mbanë pa asnjë bazë juridike, të cilat gjatë procedurës së likuidimit janë shitur dhe ka mbetur opsioni i kompensimit të tyre. Më tej në ankesë paditësi pohon se nuk mund të pajtohet me vlerësimin e Kolegjit të Specializuar se njohja e të drejtës së pronësisë për ngastrat kadastrale ... dhe ... do të ndodhë vetëm pasi të vendoset në mënyrë meritore lidhur me aktin e konfiskimit të pronave të kryera në vitin 1946 të cilin akt Gjykata e shkallës së I-rë e konsideron ende në fuqi. Këtij vlerësimi të Gjykatës sipas paditësit i mungon argumentimi relevant.

Përgjigja e të paditurës në ankesën e paditësit

25

Me datë 3 dhjetor 2015, e paditura dorëzon në DHPGJS përgjigje në ankesën e paditësit me të cilën kërkon që të refuzohet kjo ankesë

dhe të vërtetohet pika e II-të e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër e paditura në përgjigjen në ankesë pohon se vendimi administrativ për konfiskimin e pronave në procedurën gjyqësore, atakohet vetëm atëherë kur ekziston një Aktvendim apo Aktgjykim i formës së prerë i lëshuar nga organi kompetent për anulimin e Aktit të konfiskimit i kryer në vitin 1946. Sipas të paditurës vendimi mbi konfiskimin e pronave është akoma në fuqi dhe çdo veprim i ndërmarrë ndaj këtyre ngastrave nuk mund të prodhojë efekte juridike. Sipas të paditurës DHPGJS-ja lidhur me këtë padi nuk ka as juridiksion lëndor pasi që nuk ka një vendim të formës së prerë për anulimin e Aktit të konfiskimit të pronave, andaj nuk janë shtjerr mjetet ligjore në procedurë administrative dhe kjo është në linjën me qëndrimin ligjor që e ka marrë DHPGJS-ja në rastin SCC-08-0224. Sipas të paditurës paditësi duhet të dëshmojë dhe të provojë të drejtën e pretenduar pronësore në pronat e cekura në bazë të një titulli juridik dhe ta kthejë të drejtën pronësore. Sipas të paditurës paditësi ka dështuar të provojë nëse deri më tani i ka kontestuar aktet administrative përfshirë edhe aktin e konfiskimit, dhe ai ka qenë pasiv dhe i pa interesuar deri më tani për ngastrat kontestuese. Andaj sipas të paditurës vendimi i Gjykatës së Shkallës së I-rë i dhënë në pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar është i drejtë, i bazuar në fakte vendimtare dhe në prova dhe ai duhet të vërtetohet ndërsa ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Përgjigjja e paditësit në ankesën e të paditurës

Me datë 25 nëntor 2015, Kolegji i Apelit ka lëshuar Urdhër me të cilën ankesën e të paditurës ia ka dërguar paditësit për të dhënë përgjigje në ankesë. Paditësi urdhrin e ka pranuar me 2 dhjetor 2015, dhe deri më tani nuk është dorëzuar përgjigjja në ankesën e të paditurës. 26

Arsyetimi ligjor: Ankesat janë të pranueshme por të pa bazuara. 27

Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së LDHP, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet të vërtetohet. 28

- 29 Nga historiku dhe rrjedha procedurale e lëndës shihet se paditësi ka kërkuar ngastra të ndryshme, për tokën e cila i ishte konfiskuar gjyshit të tij *K K B*, i ekzekutuar në vitin 1946.
- 30 Në seancën dëgjimore të mbajtur me 30 qershor 2015, paditësi ka specifikuar se cila është kërkesa e padisë së tij, dhe në bazë të procesverbalit të seancës që është në dosje vërehet se paditësi i kërkon ngastrat ... , ... dheNdërsa për ngastrën kadastrale ...,përfaqësuesi i paditësit në seancë deklorohet se kjo ngastër nuk ndërlihet me padinë e tij.
- 31 Ngastrat kadastrale ... dhe ... në bazë të procesverbalit të seancës është vërtetuar se ato janë shitur gjatë procedurës së likuidimit të NSH-së, andaj ato ngastra tashmë janë në emër të personave të tretë. Duke ditur këtë fakt paditësi për këto dy ngastra ka kërkuar edhe kompensimin monetar në vlerën e çmimit të tregut. Ngastra kadastrale ... e cila po kërkohet nga paditësi është vërtetuar se është ndarë në dy pjesë si ngastra ... dhe Këto dy ngastra sipas procesverbalit të seancës dëgjimore dhe pohimit të paditësit si dhe certifikatës pronësore të Zyrës së kadastrit në I. janë të regjistruara në regjistrat kadastrale si pronë e paditësit, mirëpo paditësi nuk i ka në posedim dhe ato shfrytëzohen nga e paditura.
- 32 Është fakt i pa kontestuar se akti i konfiskimit të pronave i vitit 1946 nuk është provuar nga ana e paditësit dhe as më herët nga paraardhësit e tij, se ndonjëherë ai akt është anuluar me ndonjë vendim nga ndonjë autoritet publik. Rrjedhimisht është i saktë konkluzioni i Kolegjit të Specializuar se akti i konfiskimit të pronave të paraardhësit të paditësit ende formalisht është në fuqi, pasi që nuk ka një vendim të formës së prerë që dëshmon se ai akt është anuluar në rrugë administrative apo në rrugë gjyqësore. Rrjedhimisht akti i konfiskimit të këtyre pronave është ende detyrues dhe me efekt veprues.
- 33 Nga ana tjetër paditësi ka dështuar të provojë me prova lidhëmerinë e ngastrave të pronës së konfiskuar me aktin e konfiskimit, dhe të ngastrave të pronave të pretenduara me padi. Andaj në këtë aspekt është i saktë konkluzioni ligjor i Komisionit të likuidimit të AKP-së i dhënë në vendimin e ankimuar nga paditësi.
- 34 Përderisa nuk ka një vendim të formës së prerë të një autoriteti publik i cili dëshmon anulimin e aktit të konfiskimit të pronave të paraard-

hësit të paditësit, është e qartë se paditësi nuk mund të pretendon se ka një titull ligjor për të kërkuar mundësinë e kthimit të pronave të pretenduara, lidhur me ngastrën nr. ... dhe ... që është kërkesa e fundit e kërkesë padisë e specifikuar gjatë seancës dëgjimore të datës 30 qershor 2015.

Lidhur me ngastrën kadastrale ... e cila më vonë është ndarë në dy pjesë ... dhe ..., certifikata pronësore e Zyrës së Kadastrit dëshmon se për këtë ngastër e ndarë në dysh, është e regjistruar e drejta pronësore e paditësit në regjistrat kadastral. **35**

Është e paqartë se sipas cilës bazë ligjore kjo ngastër është e regjistruar në emër të paditësit në regjistrat kadastral. E paditura aktin e regjistrimit në emër të paditësit të ngastrave nr. ... dhe ... në regjistrat kadastral, nuk ka dëshmi në dosje që e ka kontestuar ndonjëherë në procedurë administrative para një autoriteti publik. Rrjedhimisht mund të konkludohet se e paditura ka dështuar të provojë faktin e pretenduar se pa bazë ligjore paditësi i mbanë këto dy ngastra në emër të tij në regjistrat kadastral. Ajo çka është e evidente dhe saktë e vërtetuar, është se këto dy ngastra janë të regjistruara në regjistrat kadastral në emër të paditësit, ndërsa ato shfrytëzohen nga e paditura. Rrjedhimisht mund të nxirret konkluzioni se paditësi ka interes ligjor të kërkojë nga gjykata mbrojtje për pronën e vet, përkatësisht kthimin e të drejtës së shfrytëzimit të saj. **36**

Paditësi për ngastrat nr. ... dhe ... i cili e din se ato janë shitur ka kërkuar edhe kompensim monetar. Gjykata e Shkallës së I-rë saktë ka vepruar kur nuk ka shqyrtuar dhe vendosur për kërkesën alternative monetare të padisë. Paditësi siç u tha më sipër ka dështuar të provojë me prova se ndonjëherë është anuluar Akti i konfiskimit të pronave të pretenduara, dhe pa një titull pronësorë që paditësi nuk e ka, ai nuk ka bazë ligjore të kërkojë as kompensimin monetar për pronat që tashmë janë në emër të personave të tretë. **37**

E paditura në ankesë e ka ngritur çështjen e mungesës së legjitimitetit të palës së paditur. Ky pohim i saj nuk është i saktë. Paditësi e ka kontestuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij pronësore, andaj ai nuk ka pas alternativë tjetër, që për veç që ta padisë Autoritetin e Likuidimit, i cili duke ushtruar procedurat e **38**

likuidimit të NSH-së, në emër së cilës evidentohen pronat kontestuese, e ka refuzuar kërkesën e tij.

39 Paditësi në ankesën e tij pohon se gjykata e shkallës së parë e ka pranuar faktin e konfiskimit të pronave, andaj kjo rrethanë sipas tij është bazë e mjaftuar që të kthehen pronat e konfiskuara. Kjo deklaratë e tij nuk mund të jetë me ndikim, pasi që pronësia fitohet vetëm në bazë të një titulli të vlefshëm pronësor. Siç u tha më lartë paditësi ka dësh-tuar ta sjellë këtë titull pronësor. Gjithashtu deklarata e tij se kthimi i ngastrave nr. ... dhe ..., është rrethanë me ndikim që mundëson kthimin edhe të dy ngastrave tjera nr. ... dhe ..., nuk është e saktë dhe nuk përkon me gjendjen dhe rrethanat e këtyre ngastrave. Te ngastrat nr. ... dhe ..., paditësi siç u tha më sipër e kishte të drejtën pronësore të regjistruar në regjistrat kadastral, por nuk e kishte posedimin, andaj gjykata vendosi ti a kthej posedimin e tyre e jo pronësinë që tashmë e kishte, për dallim nga ngastrat nr. ... dhe ... të evidentuara si pronë sho-qërore, ku paditësi nuk arriti që me titull pronësor të dëshmoj të drejtën e pronësisë, andaj gjykata nuk ka pas bazë ligjore të i a njëhë të drejtën pronësore në këto ngastra.

40 Nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se në këtë lëndë rezultati i dhënë nga Gjykata e Shkallës së I-rë nuk ka mundur të ndryshohet as në favor të paditurës lidhur me pikën I të goditur të dispozitivit siç ka kërkuar e paditura në ankesën e saj, dhe as në favor të paditësit lidhur me pikën II të goditur të dispozitivit, siç ka kërkuar paditësi në ankesën e tij, të paraqitura ndaj Aktgjykimit të ankimuar.

41 Andaj ankesat e paditësit dhe të paditurës në bazë të këtyre arsyeve është dashur të refuzohen si të pabazuara dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejt dhe i bazuar në ligj.

42 Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së është ven-dosur si në dispozitiv.



Sbënime

Shënime